



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

PANDËSHKUESHMËRIA E KORRUPSIONIT, **RREZIK** PËR SHOQËRINË DHE SHTETIN



ZGJIDHJA: INTEGRITET, TRANSPARENCË, LLOGARIDHËNIE



PRISHTINË, MARS 2019

Autorë: Betim Musliu dhe Ehat Miftaraj

Hulumtimi, analiza dhe përgatitja e raportit të monitorimit është përkrahur nga:
Hyrije Mehmeti dhe Yll Zekaj

Juristët dhe monitoruesit që kanë kontribuar në këto tri vite në monitorim:

Adem Krasniqi, Alban Mehmetaj, Albulena Bajraktari, Albulena Huçaj, Amir Jakupi, Amir Bunjaku, Arbelina Dedushaj, Arbenita Imeri, Arbër Guta, Arrita Reznici, Avni Berisha, Belkise Berisha, Belkize Loshaj, Blerim Jakupi, Bukurezë Surdulli, Dardan Ukaj, Delvina Rexhepi, Dhurata Ramoja, Diana Berisha, Driton Nocaj, Edmond Marleku, Erestina Buja, Erlina Tafa, Fitore Sadiku, Fjolla Gaxha, Fjorda Villasolli, Gita Lushi, Gzim Shala, Gzime Hashani, Hajrije Krasniqi, Kaltrina Ajvazi, Lavdim Bajraktari, Leotrim Gashi, Lirie Aliu, Lutfi Morina, Martin Komani, Medina Kadriu, Mentor Uka, Mirjeta Plakiqi, Mirvet Thaqi, Naim Sadiku, Nora Kelmendi, Ramiz Veliu, Rifadije Palloshi, Rita Gacaferri, Rita Mazrekaj, Sabina Pergega, Senad Lokaj, Shkelzen Selmanaj, Skender Govori, Syzana Rexhepi, Valdet Hajdini, Valentina Shahini Grajçevci, Verona Kadriu dhe Vjollca Qeriqi.

Projekti “Fuqizimi i sundimit të ligjit”, përkrahet financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës së saj në Prishtinë dhe NED.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës së saj në Prishtinë dhe NED-it.

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

IKD falënderon të gjithë stafin e monitoruesve, hulumtuesve, editorëve, bashkëpunëtorëve profesional, policët, prokurorët, gjykatësit, avokatët dhe të gjitha burimet që kanë bashkëpunuar dhe kanë ndikuar që kualiteti i hulumtimeve të jetë në nivel. IKD falënderon në mënyrë të veçantë përkrahjen e Ambasadës Britanike në Kosovë. Poashtu, një falënderim i veçantë për Ambasadën Amerikane në Kosovë dhe NED, të cilat kanë përkrahur vazhdimisht projektet që kanë krijuar sinergji për ta fuqizuar monitorimin e sistemit të drejtësisë në trajtimin e rasteve të korrupsionit.



KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

përkrahur nga:



Mars 2019
Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

I.	Përmbledhje ekzekutive	7
II.	Metodologjia	11
III.	Monitorimi i zbatimit të politikave të sistemit të drejtësisë në luftimin e korrupsionit.....	13
	a) Monitorimi i zbatimit të politikave të Këshillit Prokurorial të Kosovës në luftimin e korrupsionit.....	13
	b) Monitorimi i zbatimit të politikave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në luftimin e korrupsionit ...	16
	c) Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit gjyqësor dhe prokurorial	17
IV.	Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga sistemi prokurorial	20
	a. Hetimet preliminare të korrupsionit nga sistemi prokurorial.....	20
	b. Hetimet në rastet e korrupsionit nga sistemi prokurorial.....	20
	c. Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit në fazën e hetimeve.....	22
	d. Ngritja e aktakuzave për korrupsion dhe profili i të akuzuarve sipas njoftimeve të PSh-së	26
	e. Efikasiteti i Prokurorëve në Departamentin e Krimeve të Rënda.....	26
V.	Trajtimi i rasteve të korrupsionit në sistemin gjyqësor.....	28
	a. Vendimet e gjykatave në rastet e korrupsionit sipas Mekanizmit Përcjellës të KPK.....	28
	b. Vendimet e gjykatave në rastet e korrupsionit sipas Mekanizmit Përcjellës të KGJK.....	29
	c. Efikasiteti i Gjykatave në Departamentin e Krimeve të Rënda	31
VI.	Monitorimi i IKD-së në proceset gjyqësore në rastet e korrupsionit.....	33
	a. Seancat gjyqësore të korrupsionit të monitoruara nga IKD përgjatë tri viteve.....	33
	b. Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit	35
	c. Profili i personave të gjykuar për korrupsion nga gjykatat gjatë tri viteve (2016, 2017,2018)	43
	d. Politika e dënimeve në rastet e profilit të lartë të korrupsionit në tri vitet e fundit	44
	e. Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në rastet e korrupsionit	47
VII.	Shkeljet ligjore të prokurorëve dhe gjykatësve në trajtimin e rasteve të korrupsionit.....	50
VIII.	Performanca e prokurorëve dhe gjykatësve në trajtimin e korrupsionit të profilit në lartë	56
IX.	Konfiskimi i pasurisë prej veprave penale të korrupsionit	63
X.	Gjetjet e veçanta të IKD-së në monitorimin tre vjeçar të rasteve gjyqësore të korrupsionit	63
	a. Lufta e Këshillave për shfajësim në publik rreth dështimeve në luftimin e korrupsionit.....	63
	1. Konflikti KGJK-KPK lidhur me dështimet në luftimin e korrupsionit	64
	2. Tendenca e Këshillave që me rekomandime ta luftojë korrupsionin.....	66
	b. Kontrolli, ndërhyrjet dhe ndikimet politike në sistemin prokurorial	67
	1. Centralizimi i hetimeve ndaj profilit të lartë, kontroll i kundërligjshëm i Kryeprokurorit.....	67
	2. Ndërhyrjet e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit në hetimin e rasteve të korrupsionit.....	69
	3. Ndërhyrjet politike dhe të Kryeprokurorit në rastin e veteranëve dhe rastin pronto	71

c.	Ndërhyrjet dhe kërcënimet e Kryeprokurorit të Shtetit ndaj pavarësisë së gjykatësve	74
1.	Dukuria e tërheqjes së prokurorëve nga aktakuzat për korrupsion pa arsye të adekuata	75
2.	Trajtimi i KGJK-së dhe KPK-së si “departamente” të MD-së	77
d.	Luftimi i korrupsionit pa kontroll të gjyqësorit	79
e.	Dështimet në respektimin e Mekanizmit Përcjellës.....	81
f.	Vonesat në procedimin e aktakuzave të korrupsionit nga prokurorët.....	81
g.	Ngritja e aktakuzave jo-profesionale dhe dështimi i prokurorëve në gjykatë	82
h.	Parashkrimi i rasteve të korrupsionit	86
i.	Dështimet në ndjekje të rasteve të publikuara nga media dhe shoqëria civile.....	87
j.	Dosja e manipuluar e provimit të jurisprudencës së Kryeprokurorit të Shtetit.....	88
k.	Integriteti i kontestuar i prokurorëve dhe gjykatësve lidhur me përfitimin nga rritja e pagave	91
XI.	Llogaridhënia e prokurorëve dhe gjykatësve pas raportimeve të IKD-së.....	93
XII.	Rekomandimet e IKD-së.....	96

SHKURTESAT:

AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AKP	Agjencioni Kosovar i Pronës
Dogana	Dogana e Kosovës
EULEX	Misioni i Sundimit të Ligjit
BE	Bashkimi Evropian
GJTh	Gjykatë Themelore
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
IKP	Inspektorati Policor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KKLKE	Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KPPRK	Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
MD	Ministria e Drejtësisë
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PTh	Prokurori Themelore
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PA	Prokuroria e Apelit
PK	Policia e Kosovës
PTK	Posta dhe Telekomu i Kosovës
PP	Lëndë të Prokurorisë me kallëzime penale
PPN	Lëndë të Prokurorisë në fazën e grumbullimit të informatave
UA	Udhëzime Administrative
ZPD	Zyra e Prokurorit Disiplinor
ZKPSH	Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

I. Përmbledhje ekzekutive

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka hyrë në vitin e gjashtë të monitorimit sistematik të sistemit të drejtësisë në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Gjetjet e këtij raporti përfshijnë veprimet e institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë në hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit, përfshirë monitorimin e miratimit dhe zbatimit të ligjeve, politikave dhe strategjive në nivel institucional në adresimin e luftës kundër korrupsionit gjatë tri viteve (2016, 2017, 2018).

Gjetjet e IKD-së në këto vite, dëshmojnë se korrupsioni në Kosovë është endemik. Në Kosovë nuk mungojnë ligjet dhe politikat për luftimin e korrupsionit. Mungon vullneti politik. Politika dhe grupet e interesit, kanë prodhuar një sistem të drejtësisë, i cili në vend që të prodhojë drejtësi dhe siguri juridike, është shndërruar në mekanizëm persekutimi për individë të caktuar, në emër të luftës kundër korrupsionit dhe mjet efikas për të ofruar pandëshkueshmëri dhe amnisti për zyrtarë të caktuar brenda sistemit të drejtësisë, politikës dhe grupeve të interesit. Luftimi i korrupsionit të nivelit të lartë në Kosovë, fillon dhe mbaron me deklarata politike për të raportuar korrupsionin në Prokurori apo Polici. Mungon transparenca dhe llogaridhënia e bartësve të funksioneve në sistemin e drejtësisë për t'i dhënë përgjigje luftës kundër fenomenit të korrupsionit, i cili po e rrezikon sundimin e ligjit dhe integritimin evropian. Kosova në raporte të mekanizmave të caktuar të Bashkimit Evropian tashmë ka filluar të quhet si shtet i kapur.

Në tri vitet e fundit, IKD ka argumentuar se luftimi i korrupsionit ka filluar dhe ka mbaruar kryesisht në hartimin e politikave. Në emër të luftimit të korrupsionit sistemi i drejtësisë, ka miratuar politika të kundërligjshme, përmes të cilave ka centralizuar hetimin dhe ndjekjen e profilit të lartë të korrupsionit, duke ndërhyrë rëndë në pavarësinë individuale të prokurorëve. Një strategji e tillë e institucioneve të drejtësisë është treguar jashtëzakonisht efikase në ndërtimin e kulturës së pandëshkueshmërisë për zyrtarë të lartë shtetërorë dhe në uljen e besimit të qytetarëve në këtë sistem.

IKD është organizata e vetme, e cila monitoron sistematikisht sistemin e drejtësisë në trajtimin e rasteve të korrupsionit, në këto tri vite (2016, 2017, 2018) ka monitoruar dhe raportuar për 518 aktgjykime që kanë shpallur Gjykatat Themelore, ku janë përfshirë 996 persona të akuzuar për korrupsion. Prej këtyre aktgjykimeve, rezulton se Gjykatat ndaj 176 personave (17.7%) kanë dënuar me burg efektiv, ndaj 178 personave (17.9%) kanë shqiptuar dënime me kusht, ndaj 98 personave (9.8%) kanë shqiptuar dënime me gjobë, ndërsa janë liruar 544 persona (54.6%) të akuzuar për korrupsion. Prej këtyre 996 të akuzurëve për korrupsion, 442 persona i takojnë profilit të ulët, 516 persona profilit të mesëm dhe 38 persona i takojnë të profilit të lartë.

Nga analiza e tri viteve të fundit të trajtimit të korrupsionit të profilit të lartë, rezulton se ende nuk ekziston një zyrtarë i profilit të lartë, i cili është dënuar për korrupsion me aktgjykim të formës së prerë me burgim efektiv. Gjetjet e IKD-së dëshmojnë se për tri vjet (2016, 2017, 2018), gjykatat kanë trajtuar 59 aktakuza ndaj 68 personave të profilit të lartë, të cilat janë ngritur më herët apo gjatë kësaj periudhe. Në mesin e tyre janë 13 zyrtarë të lartë që janë akuzuar më shumë se njëherë. Vlen të theksohet se vetëm ndaj ish-Kryetarit të Klllokotit, Sasha Mirkoviq, janë ngritur 7 aktakuza.

Nga 68 zyrtarët e profilit të lartë të akuzuar, Gjykatat Themelore si shkallë e parë për 9 zyrtarë të lartë kanë hudhur aktakuzat, për 16 zyrtarë kanë marrë aktgjykime liruese, për 5 zyrtarë kanë marrë aktgjykime refuzuese, ndërsa ndaj 11 zyrtarëve të profilit të lartë gjykatat kanë shqiptuar dënime. Ndaj 27 zyrtarëve të profilit të lartë ende janë duke vazhduar procedurat gjyqësore në shkallë të parë.

Prej 11 zyrtarëve të dënuar, gjykatat për 8 zyrtarë të lartë kanë shqiptuar dënime me burgim me kusht, ndërsa ndaj një zyrtari është shqiptuar dënim me gjobë. Ndërsa vetëm dy dënime janë shqiptuar me burgim efektiv, të dyja nga tri vjet burgim efektiv, njëri ndaj ish-Kryetarit të OShP-së, Hysni Hoxha dhe tjetri ndaj ish-Kryetarit të Lipjanit, Shukri Buja. Hoxha është liruar nga Gjykata e Apelit, ndërsa rasti i Shukri Bujës gjendet në procedurë të ankesave në Apel.

IKD bazuar në gjetjet e monitorimit si në aspektin ligjor ashtu dhe atë procedural, vlerëson se prokurorët dhe gjykatësit ballafaqohen me probleme sistematike në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Sipas të dhënave zyrtare të sistemit prokurorial, rezulton se prokurorët për tri vite kanë zgjidhur raste ndaj 2838 personave të dyshuar për korrupsion. Gjetjet tregojnë se prej tyre, ndaj 1809 personave apo 64% të tyre, rastet e korrupsionit mbyllen në Prokurori, pa kaluar përmes kontrollit gjyqësor. Ndaj 981 personave apo 34% të tyre janë ngritur aktakuza, ndërsa për 48 persona apo më pak se 1% të tyre rastet janë zgjidhur në mënyrë tjetër. Rastet e mbyllura në prokurori në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm nuk janë të qasshme për publikun apo organizatat jo-qeveritare që monitorojnë këtë sistem. Mundësitë e keqpërdorimit në këto raste nga ana e prokurorisë janë jazhtëzakonisht të mëdha. Disa prej këtyre rasteve i ka argumentuar IKD përmes monitorimit sistematik dhe hulumtimeve të veçanta, të cilat janë bërë publike. Sistemi prokurorial përjashtimisht, publikon raste individuale që mbyllen në këtë fazë të procedurës kur ndërlidhet me individë të politikës apo brenda sistemit prokurorial, dhe që për qëllim kanë rehabilitimin e këtyre personave në publik.

Mesatarja e kohëzgjatjes së procedurave penale në rastet e korrupsionit, sipas analizës së IKD-së, rezulton se në tri vitet e fundit është afërsisht e njëjtë. Trajtimi i një rasti të korrupsionit prej momentit të paraqitjes së kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit ka zgjatur rreth tri vite apo 1054 ditë. Kjo dëshmon se prokurorët dhe gjykatësit, vazhdimisht shkelin ligjin dhe nuk i respektojnë politikat e sistemit prokurorial dhe gjyqësor për t'i trajtuar me prioritet lëndët e korrupsionit.

Sipas të dhënave zyrtare të sistemit gjyqësor, gjatë këtyre tri viteve, gjykatësit kanë shpallur aktgjykime ndaj 740 personave të akuzuar për korrupsion. Gjetjet tregojnë se prej këtij numri, 101 persona (13.6%) janë dënuar me burgim efektiv, 128 persona (17.2%) janë dënuar me gjobë, 145 persona (19.5%) janë dënuar me kusht, ndërsa 252 persona (34%) persona janë liruar. 6 persona kanë marrë dënime të tjera, ndërsa ndaj 108 personave të tjerë lëndët janë zgjidhur në mënyrë tjetër. IKD vazhdimisht ka gjetur se gjykatësit në praktikë ballafaqohen me probleme serioze në administrimin e proceseve gjyqësore në rastet e korrupsionit. Për tri vite, prej 3994 seancave të korrupsionit të monitoruara nga IKD, 1134 (29%) seanca janë shtyrë për shkak të mungesës së palëve në procedurë. Rreth 50% e seancave janë shtyrë për shkak të mungesës së prokurorit apo gjykatësit.

Gjetjet e IKD-së, po ashtu dëshmojnë se si rezultat i uljes së besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë, ka rënie në paraqitjen e kallëzimeve penale nga qytetarët dhe subjektet e dëmtuara. Edhe përkundër faktit se sistemi gjyqësor dhe prokurorial, në vazhdimësi proklamojnë transparencën, praktika e dëshmon të kundërtën. IKD gjatë tri viteve, ka adresuar 837 kërkesa për qasje në dokumente publike dhe ka marrë përgjigje pozitive në 391 (47%) kërkesa, përgjigje negative ka marrë në 92 (11%) kërkesa, ndërsa nuk ka marrë fare përgjigje në 354 (42%) kërkesa.

Gjetjet e IKD-së vazhdimisht kanë ndikuar në ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies së prokurorëve dhe gjykatësve në trajtimin e lëndëve të korrupsionit. Si rezultat i gjetjeve të publikuara në raportet e IKD-së, Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD) deri më tash ka përfshirë mbi 850 raste në hetime preliminare ndaj prokurorëve dhe gjykatësve. Gjatë këtyre tri viteve, ZPD ka angazhuar në mënyrë të veçantë stafin e inspektorëve në trajtimin e gjetjeve të raporteve periodike të IKD-së. Rreth trajtimit të këtyre rasteve, ZPD nuk ka sistemuar të dhëna të veçanta, por deri në fund të vitit 2017, ka njoftuar se ndaj një numri të prokurorëve kanë konstatuar shkeljet e evidentuara nga IKD dhe të njëjtit janë dërguar për masa disiplinore. Gjithashtu, për një numër të madh të prokurorëve dhe gjykatësve janë konstatuar shkeljet e evidentuara nga IKD, të cilat janë dërguar në Komision të Vlerësimit të Performancës për secilin prej tyre.

IKD në bazë të gjetjeve gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit të trajtimit të luftës kundër korrupsionit, në vazhdimësi në këto tri vite, në kuadër të projektit tre vjeçar “Fuqizimi i sundimit të ligjit” të mbështetur nga Ambasada Britanike në Kosovë ka ofruar rekomandime konkrete se si të zbatohen obligimet ligjore dhe politikat në trajtimin e luftës kundër korrupsionit. Në vazhdim janë paraqitur rekomandimet kryesore të adresuara për institucionet e drejtësisë në këto tri vite (*janë larguar rekomandimet e njëjta të përsëritura, të cilat nuk janë zbatuar*). Në këtë tabelë janë paraqitur 117 rekomandime, prej të cilave 37 janë zbatuar, 49 janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 31 rekomandime nuk janë zbatuar.

Gjatë tri viteve, IKD ka publikuar mbi 20 raporte hulumtuese dhe analiza rreth trajtimit të luftës kundër korrupsionit. Në këtë raport, janë analizuar temat e veçanta në luftimin e korrupsionit përfshi: “luftën” e akuzave të ndërsjella të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial për dështimet në luftimin e korrupsionit, tendencën që këta Këshilla ta luftojnë korrupsionin përmes rekomandimeve, kontrolli, ndërhyrjet, ndikimet politike, centralizimi i luftimit të korrupsionit nga Kryeprokurori i Shtetit, Alekandër Lumezi dhe ndërhyrjet e tij në raste konkrete, luftimi i korrupsionit pa kontroll të gjyqësorit, dështimet në mekanizmin përcjellës, ngritja e aktakuzave joprofesionale dhe dështimet për t’i mbrojtur në gjykatë, parashkrimi i rasteve të korrupsionit, dosja e manipuluar e provimit të jurisprudencës së Kryeprokurorit Lumezi dhe integriteti i kontestuar i sistemit të drejtësisë për shkak të përfitimit nga vendimi për rritjen e pagave.

Sundimi i ligjit edhe në vitin 2019, mbetet sfidë e pakalueshme, dhe me institucione dhe me individ të caktuar që udhëheqin me këto institucione me integritet dhe kredibilitet të cenueshëm. Edhe përkundër kërkesës së qytetarëve dhe partnerëve ndërkombëtarë për të fuqizuar sektorin e sundimit të ligjit, gjetjet e IKD-së konstatojnë se Kosova nga faza e gjendjes fillestare në sundimin e ligjit ka shënuar regres, duke u kthyer në një shtet të kapur,

ku drejtësia amnistion zyrtarët e korruptuar dhe nuk i zbaton obligimet kushtetuese e ligjore në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe të pavarur.

Me këtë integritet të kontestuar të sistemit të drejtësisë, nuk mund të shënohet progres. IKD përsëritë rekomandimin që të fillohet me inicimin e ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore për ta përgatitur procesin e vetingut të thellë në sistem gjyqësor, prokurorial dhe polici, për të ndërtuar një sistem me integritet, transparent dhe llogaridhënës para qytetarit.

II. Metodologjia

IKD me qëllim që të përpiloj një raport sa më gjithëpërfshirëse dhe analitik, në lidhje me trajtimin e rasteve të korrupsionit nga sistemi prokurorial dhe gjyqësor, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit. Kjo për shkak se sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor ende përballen me probleme në unifikimin e të dhënave. Prandaj, hulumtimi trajtimit të rasteve të korrupsionit nga sistemi prokurorial dhe gjyqësor bazohet në monitorimin e drejtpërdrejtë të performancës së prokurorive dhe gjykatave në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit për trajtimin e rasteve të korrupsionit me prioritet.

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe planet e veprimit ka krijuar indikator të qartë për matjen e progresit në zbatimin e tyre nga sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor. Hulumtimi përfshinë monitorimin e rasteve të korrupsionit në shtatë Prokuroritë Themelore, Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, shtatë Gjykatat Themelore dhe Degët e tyre si dhe Gjykatën e Apelit në Prishtinë. IKD ka siguruar të dhënat statistikore nga Njësi të Shqyrtimit të Performancës së Prokurorive dhe Departamenti i Statistikës në Këshillin Gjyqësor si dhe ka mbledhë të dhënat individualisht përgjatë procesit të monitorimit nëpër të gjitha prokuroritë dhe gjykatat.

Raportet e siguruar nga IKD janë përmbledhë në një bazë të të dhënave, e cila ka përfshirë të gjitha rastet e korrupsionit dhe personat e përfshirë në këto raste në të gjitha fazat e procedurës penale në sistemin prokurorial dhe sistemin gjyqësor.

Baza e të dhënave është shfrytëzuar për të evidentuar çështjet më shqetësuese që ndërlidhen me zbatimin e obligimeve ligjore dhe obligimet e planeve të veprimit, përkatësisht lidhur me zgjidhjen, mënyrën e zgjidhjes dhe moszgjidhjen e rasteve të korrupsionit nga prokurorët dhe gjykatësit. Përmes statistikave, IKD ka analizuar disa aspekte të cilat janë paraqitur dhe komentuar përmes tabelave dhe grafikave, duke përfshirë të gjitha specifikat e rasteve të korrupsionit për secilën prokurori dhe gjykatë, për secilin parashtrues të rastit të korrupsionit dhe për mënyrën e zgjidhjes së rasteve.

Hulumtuesit e IKD-së, prej 1 janarit 2016 deri më 31 dhjetor 2018 kanë monitoruar 3994 seanca gjyqësore. IKD ka krijuar indikatorë të qartë për të analizuar trajtimin e rasteve të korrupsionit nëpër të gjitha fazat e procedurës penale, duke përfshi prej ngritjes së kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit në shkallë të parë nga gjykatat.

IKD ka monitoruar vazhdimisht aktivitetet e Komisioneve Mbikëqyrëse për lëndët e korrupsionit të KPK-së dhe KGJK-së, Prokurorive Themelore, Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Gjykatave Themelore, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Me të gjithë bartësit e funksioneve prokuroriale dhe gjyqësore, gjatë tri viteve IKD ka zhvilluar intervista të thella, të bazuara në indikatorët e përcaktuar në përputhje me obligimet ligjore dhe obligimet e planeve të veprimit. Intervistat e zhvilluara janë kodifikuar ashtu që çështjet dhe informatat e dala nga to janë përfshirë në raport.

Si zakonisht, për të qenë sa më të saktë në identifikimin e problemeve si dhe propozimin e rekomandimeve për zgjidhje të problemeve në luftimin e korrupsionit, përkatësisht në zbatimin sa më efikas dhe efektiv të obligimeve ligjore dhe obligimeve të planeve të veprimit, IKD ka analizuar bazën ligjore, si dhe ka analizuar në detaje dokumente relevante vendore dhe ndërkombëtare, të cilat ndërlidhen me luftën kundër korrupsionit në Kosovë.

III. Monitorimi i zbatimit të politikave të sistemit të drejtësisë në luftimin e korrupsionit

IKD është organizata e vetme në Kosovë, e cila prej nëntorit 2013 ka monitoruar sistematikisht sistemin gjyqësor dhe sistemin prokurorial në zbatimin e kornizës ligjore dhe politikave në trajtimin e rasteve të korrupsionit. IKD vazhdimisht ka vlerësuar si pozitive politikave formale të sistemit prokurorial dhe sistemit gjyqësor në luftimin e korrupsionit, me përjashtim të rasteve të caktuara kur janë hartuar në kundërshtim me ligjin.¹ KPK² dhe KGJK³ kanë miratuar Planin e Veprimit për të trajtuar me prioritet absolut lëndët e korrupsionit. Problem shqetësues mbetet moszbatimi i këtyre politikave në praktikë. Pavarësisht disa lëvizjeve pozitive, rezultatet konkrete në luftimin e korrupsionit, sidomos kundrejt profilit të lartë vazhdojnë të mungojnë. Kosova, si një shtet i ri dhe marrë për bazë të kaluarën e saj përgjatë historisë, sidomos periudhën e tranzicionit politik dhe social ka reflektuar e “dobët në përballjen me fenomenin e korrupsionit. Madje, sipas shumë studimeve të bëra, rezulton se Kosova radhitet ndër vendet me përmasa të larta të korrupsionit. Korrupsioni në Kosovë vazhdon të vlerësohet si endemik.⁴

a) Monitorimi i zbatimit të politikave të Këshillit Prokurorial të Kosovës në luftimin e korrupsionit

KPK më 1 dhjetor 2015, ka miratuar Planin Strategjik (2016-2018) dhe Planin e Veprimit për Ngritjen e Efektivitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, përfshirë Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme (në vazhdim: *Plani i Veprimit*). Ky Plan Strategjik ka përcaktuar disa qëllime si: zvogëlimi i lëndëve të pazgjidhura, rritja e efektivitetit në zgjidhjen e lëndëve të reja, rritja e nivelit të bashkëpunimit me institucione, rritja e kapaciteteve përmes trajnimeve të specializuara, llogaridhënia dhe

¹ *Shënim:* IKD ka reaguar ndaj disa dispozitave të kundërligjshme të Planit Strategjik (2016-2018) dhe Planit të Veprimit për Ngritjen e Efektivitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, përfshirë Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme të miratuar nga KPK më 1 dhjetor 2015. Këshilli Prokurorial i Kosovës. 1 dhjetor 2015.

² *Shënim:* KPK për herë të parë në kuadër të zbatimit të Planit Strategjik për Bashkëpunim ndër-institucional në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, më 4 nëntor 2013, ka nxjerr Planin e Veprimit për rritjen e efektivitetit të sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit. Ky Plan i Veprimit ka paraqitur në detaje obligimet e prokurorive dhe pritjet e KPK-së sa i përket ngritjes së efektivitetit për zgjidhjen e rasteve të korrupsionit. Më 27 dhjetor 2013, KPK ka lidhur Memorandum Bashkëpunimi me Institutin e Kosovës për Drejtësi për monitorimin e zbatimit të këtij plani. KPK gjithashtu më 1 dhjetor 2015, ka miratuar Planin Strategjik (2016-2018) dhe Planin e Veprimit për Ngritjen e Efektivitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, përfshirë Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme. Këshilli Prokurorial i Kosovës. 1 dhjetor 2015.

³ *Shënim:* Me iniciativë të IKD-së për zbatimin e rekomandimeve të publikuara në raportet analitike që ndërlihen me trajtimin efikas dhe efektiv të rasteve të korrupsionit nga sistemi gjyqësor dhe prokurorial, IKD ka mbajtur takime me Kryesin e KGJK-së, z. Enver Peci, i cili ka shprehur vullnetin për bashkëpunim për hartimin e Planit të Veprimit për Zgjidhjen e Rasteve të Korrupsionit. IKD ka hartuar draftin e këtij Plani, i cili me ndryshimet dhe plotësimet e KGJK-së është miratuar më 25 shtator 2015. “Plani i Veprimit për Zgjidhjen e Rasteve të Korrupsionit”. Këshilli Gjyqësor i Kosovës. 25 shtator 2015.

⁴ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian dhe Raporti i Departamentit të Shtetit Amerikan lidhur me të Drejtat e Njeriut në Kosovë vazhdimisht ka theksuar se shkalla e korrupsionit në Kosovë është e lartë, përfshi ndikimin politik në sistemin e drejtësisë.

transparenca.⁵ Ky plan nuk është bërë publik asnjëherë në faqen elektronike të KPK-së.⁶ Sidoqoftë, IKD ka arritur që ta sigurojë kopjen e këtij Plani Strategjik dhe Planit të Veprimit.

Dështimi në zbatimin e obligimeve të Planit të Veprimit nga KPK

Gjetjet e IKD-së tregojnë se KPK ka vazhduar me shprehjen e vullnetit në luftimin e korrupsionit përmes politikave, përderisa në praktikë dëshmohet se të njëjtat politika nuk zbatohen. Mekanizmat e themeluar për të përmbushur obligimet apo monitoruar zbatimin e planeve nuk i kanë marrë seriozisht këto plane dhe obligimet e tyre. Prokurorët, stafi dhe mekanizmat e KPK-së vazhdimisht kanë probleme serioze në respektimin e Mekanizmit Përcjellës, ku vazhdimisht raportohen të dhënat statistikore për trajtimin e rasteve.⁷ Ajo që vihet në pah në vazhdimësi është se KPK nuk ka marrë asnjë veprim ndaj asnjë zyrtari për ta mbajtur përgjegjës apo llogaridhënës lidhur me dështimet në zbatimin e politikave për luftimin e korrupsionit. Paradoks është fakti se vetë KPK disa herë kishte nxjerrë vendime që të mbante përgjegjës zyrtarët e saj për dështimet në Mekanizmin Përcjellës, por që asnjëherë nuk ishin zbatuar ato vendime. Për mos trajtimin efikas dhe efektiv të rasteve të korrupsionit, Kryeprokurorët vazhdimisht janë ankuar në numrin e pamjaftueshëm të prokurorëve dhe faktorëve të tjerë objektiv, të cilët sipas tyre, kanë ndikuar në moszgjidhjen e rasteve të korrupsionit në kohë.⁸ IKD vlerëson se kjo dëshmon kultivimin e kulturës së pandëshkueshmërisë të instaluar qysh prej Planit të vjetër të Veprimit për trajtimin e rasteve të korrupsionit të miratuar më 4 nëntor 2013.

Zgjidhja e rasteve të korrupsionit sipas afateve të planit të veprimit - Neni 3 i Planit të veprimit të miratuar në dhjetor 2015, kishte paraparë që lëndët e pazgjidhura të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme të pranuar nga viti 2001 deri 2010, të përfundoheshin deri më 30 qershor 2016. KPK kishte dështuar që këtë obligim ta zbatojë në praktikë. Ky dështim nga Komisioni Mbikëqyrës⁹ për zbatimin e Planit Strategjik dhe të Veprimit në Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve

⁵ Ky Plan Strategjik përmban pothuajse të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Planin e Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit të miratuar më 4 nëntor 2013 nga KPK. KPK për herë të parë ka miratuar Planin e Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit më 4 nëntor 2013.

⁶IKD ka kërkuar nga KPK dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit qasje në Planin Strategjik të miratuar nga KPK, por ka marrë përgjigje negative lidhur me kërkesën e paraqitur në përputhje me Ligjin mbi Qasjen në Dokumente Publike. Përgjigja e zyrtarit për qasje në dokumente publike i caktuar nga KPK. “*Këshilli Prokurorial me datë 1 dhjetor 2015, ka miratuar Planin Strategjik (2016 - 2018) dhe Planin e Veprimit për ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme, mirëpo ky plan do të plotësohet me rekomandimet e marra nga anëtarët e Këshillit dhe përfaqësuesit ndërkombëtar që mbështetin punën e Këshillit. Pas plotësimit dhe ndryshimit me këto rekomandime Plani do të publikohet në ueb faqet e Prokurorit të Shtetit dhe të Këshillit Prokurorial*”. Ky plan asnjëherë nuk është publikuar në faqen e KPK-së.

⁷ *Shënim:* IKD gjatë monitorimit vazhdimisht ka identifikuar raste të regjistruara me vonesë në Mekanizmin Përcjellës si dhe raste të cilat nuk figurojnë fare në regjistrin e të dhënave në Mekanizmin Përcjellës, edhe pse të njëjtat kanë ekzistuar në regjistrat paraprak.

⁸ IKD intervista me Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Blerim Isufaj dhe me të gjithë Kryeprokurorët e Prokurorive të të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës. 2016, 2017.

⁹ KPK kishte caktuar një Komision Mbikëqyrës për zbatimin e Planit të Veprimit për trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe ekonomike në përbërje të z. Haxhi Dërguti, Kryeprokuror i Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, znj. Laura Pula, Prokurorë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit si dhe z. Lulëzim Sylejmani, Prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Ekonomike ishte raportuar si sukses në KPK. Sipas raportit të Komisionit, ishin zgjidhur të gjitha lëndët e korrupsionit deri në vitin 2010 me përjashtim të tri lëndëve.¹⁰ IKD ka gjetur se kjo nuk është e vërtetë për shkak se deri më 31 dhjetor 2016, PSh i kishte pasur ende në punë 17 raste të pazgjidhura të korrupsionit me 51 persona të përfshirë, që i takonin periudhës nga vitet 2002 deri në 2010 dhe jo 3 raste siç ishte raportuar nga Komisioni në KPK. Vazhdimisht afatet për përfundimin e lëndëve janë shkelur nga bartësit e funksioneve prokuroriale dhe përkundër masave që janë përcaktuar në plan të veprimit për t'u ndërmarrë ndaj përgjegjësve dhe Kryeprokurorëve, asnjëherë nuk ka pasur veprime konkrete për zbatim në praktikë. Rrjedhimisht, vazhdimisht është kultivuar kultura e pandëshkueshmërisë.

Raportimi çdo tre muaj në KPK - Neni 4 i Planit të veprimit kishte paraparë themelimin e Komisionit Mbikëqyrës lidhur me trajtimin e lëndëve të korrupsionit nga prokuroritë, monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe raportimit në KPK në baza tre mujore. Ky Komision në vitin 2016 ka dështuar të përmbushë obligimin për të raportuar sipas Planit të veprimit. Gjatë vitit 2016 Komisioni ka raportuar vetëm njëherë para KPK-së, më 16 shtator 2016.¹¹ Dështimet në raportimin e rregullt sipas Planit të veprimit kanë vazhduar edhe në vitin 2017, në të cilin Komisioni ka raportuar vetëm tri herë para KPK-së, më 1 shkurt, 16 maj dhe 25 shtator 2017.¹² Pas kritikave të vazhdueshme të IKD-së për këto dështime dhe rekomandimit për raportim të rregullt, Komisioni gjatë vitit 2018, ka raportuar në baza të rregullta tre mujore. Gjatë vitit 2018, Komisioni ka raportuar katër herë.¹³

Raportimi për pasuri të sekuestruar dhe konfiskuar për veprat penale kundër korrupsionit - Plani i Veprimit ka përcaktuar se Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike (KKLKE) do të monitorojë rastet që ndërlidhen me krimet ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme. Vlen të theksohet se KKLKE ka përmbushur obligimet për raportuar para KPK-së lidhur me aktivitetet e tij lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme. Sidoqoftë, KKLKE ka dështuar të ofrojë informacion para KPK-së lidhur me kërkesat për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar përmes veprave penale kundër korrupsionit. Ende as pas tri vitesh nuk ka informacion nëse nga pasuritë e sekuestruara apo konfiskuara, ka pasuri që i takojnë veprave penale kundër korrupsionit.

¹⁰ Komisioni Mbikëqyrës gjatë raportimit para KPK-së për raportin e vitit 2016 ka prezantuar vetëm tri raste të pakryera që i takojnë lëndëve të para vitit 2010. Prokurorja Laura Pula, gjatë prezantimit të raportit, ka thënë se prej këtyre tri lëndëve, dy prej tyre nuk janë zgjidhur me arsytimin se janë pezulluar për shkak të fletëarresteve ndërkombëtare në mungesë të të pandehurve, ndërsa një lëndë është në punë ende në fazën e grumbullimit të informatave. Raporti i Komisionit Mbikëqyrës të KPK-së. 1 shkurt 2017.

¹¹ Komisioni Mbikëqyrës për herë të parë ka raportuar para KPK-së gjatë muajit shtator 2016.

¹² Komisioni Mbikëqyrës për herë të dytë ka raportuar (për periudhën janar-dhjetor 2016) para KPK-së në mbledhjen e 128-të të mbajtur më 1 shkurt 2017; për herë të tretë ka raportuar (për periudhën janar-mars 2017) para KPK-së në mbledhjen e 133-të të mbajtur më 16 maj 2017; ndërsa për herë të katërt ka raportuar (për periudhën janar-qershor 2017) para KPK-së në mbledhjen 138-të të mbajtur 25 shtator 2017.

¹³ Komisioni Mbikëqyrës për herë të pestë ka raportuar (për periudhën janar-dhjetor 2017) para KPK-së në mbledhjen e 148-të të mbajtur më 23 shkurt 2018; për herë të gjashtë ka raportuar (për periudhën janar-mars 2018) para KPK-së në mbledhjen e 152-të të mbajtur 30 maj 2018; për herë të shtatë ka raportuar (për periudhën janar-qershor 2018) para KPK-së në mbledhjen e 156-të të mbajtur 7 shtator 2018; dhe për herë të tetë ka raportuar (për periudhën janar-shtator 2018) para KPK-së në mbledhjen e 159-të të mbajtur 24 dhjetor 2018.

Rishikimi i Planeve dhe harmonizimi i tyre me ligjin - IKD në raportin e publikuar më 27 prill 2016, “Korrupsioni në Kosovë: *Luftimi apo Promovimi i korrupsionit*”, ka gjetur se dispozitat e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit ishin në kundërshtim me ligjet bazike që rregullojnë sistemin prokurorial në Kosovë. IKD i ka rekomanduar KPK-së që këto plane të ndryshohen urgjentisht për t’i harmonizuar në pajtim me ligjet e aplikueshme dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare. IKD ka rekomanduar që kujdes i veçantë duhet kushtuar pavarësisht individuale të prokurorëve dhe Kryeprokurorëve. KPK ka informuar IKD-në se KPK do të bëjë ndryshime dhe plotësime të këtyre planeve me rekomandimet e marra nga anëtarët e Këshillit dhe përfaqësuesit ndërkombëtar që mbështesin punën e Këshillit dhe se më pas ato do të publikohen në faqe. Planeve u ka skaduar afati, ndërsa KPK nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të përmirësuar dispozitat e kundërligjshme të këtyre planeve dhe gjithashtu nuk ka bërë as publikimin e tyre.

b) Monitorimi i zbatimit të politikave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në luftimin e korrupsionit

KGJK në bashkëpunim me IKD-në, për herë të parë me iniciativë të IKD-së kanë hartuar Planin e Veprimit për KGJK-në për të trajtuar me prioritet rastet e korrupsionit. Ky Plan ishte miratuar më 25 shtator 2015 nga KGJK.¹⁴ Zbatimi i këtij plani vazhdon të sfidohet në praktikë, si rezultat i ngarkesës së gjykatësve me lëndë, por edhe si rezultat i mungesës së vullnetit për t’i trajtuar me prioritet absolut rastet e korrupsionit, siç përcaktohet në Planin e Veprimit.

Dështimi në zbatimin e obligimeve të Planit të Veprimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës

IKD ka monitoruar zbatimin e obligimeve që dalin nga planet e lart-përmendura nga Gjykatat, Komisionet dhe KGJK. Gjetjet tregojnë se KGJK ka vazhduar me shprehjen e vullnetit në luftimin e korrupsionit përmes politikave, përderisa në praktikë dëshmohet se të njëjtat politika nuk zbatohen. IKD vlerëson se mekanizmat e themeluar për të përmbushur obligimet apo monitoruar zbatimin e planeve nuk i kanë marr seriozisht këto plane dhe obligimet e tyre. KGJK deri më tani nuk ka ndërmarrur asnjë veprim ndaj askujt për ta mbajtur përgjegjës apo llogaridhënës lidhur me dështimet në zbatimin e politikave për luftimin e korrupsionit. Për mos trajtimin efikas dhe efektiv të rasteve të korrupsionit, Kryetarët e Gjykatave ankohen në numrin e pamjaftueshëm të gjykatësve dhe faktorëve tjerë objektiv, të cilët sipas tyre, kanë ndikuar në moszgjidhjen e këtyre rasteve në kohë.¹⁵

Zgjidhja e rasteve të korrupsionit sipas afateve ligjore – Gjetjet e monitorimit të IKD-së tregojnë se në rastet e monitoruara për vepra penale të korrupsionit, gjykatësit në pjesën dërrmuese të këtyre rasteve nuk i kanë respektuar afatet e procedurës penale. Caktimi i seancës për shqyrtim fillestar, shqyrtim të dytë dhe caktimi i shqyrtimit kryesor në pjesën dërrmuese të rasteve është bërë në kundërshtim me afatet ligjore. Kjo përbën një shqetësim

¹⁴ IKD ka mbështetur KGJK në hartimin e Planit të Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Gjyqësor në trajtimin e lëndëve të korrupsionit. IKD kishte hartuar draftin e Planit të Veprimit për KGJK-në, i cili plan me disa plotësime ishte miratuar nga KGJK më 25 shtator 2015.

¹⁵ IKD intervista me Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Nehat Idrizi dhe me të gjithë Kryetarët e Gjykatave të të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës. 2016, 2017, 2018.

serioz për të drejtat e të pandehurve në procedurë penale dhe rrjedhimisht kjo ndikon drejtpërdrejt në humbjen e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor.

Raportimi sipas afateve të përcaktuara në Planin e Veprimit - Përmes Planit të Veprimit, KGJK ka përcaktuar aktivitete konkrete dhe afate kohore praktike për rritjen e efikasitetit të trajtimit të lëndëve të korrupsionit. Afatet e parapara në plan nuk janë respektuar asnjëherë nga Komisioni dhe KGJK. Raportet e Komisionit Mbikëqyrës edhe pse janë dërguar çdo tre muaj në KGJK, për të njëjtat Komisioni ka raportuar një herë para KGJK-së dhe atë me 6 prill 2016.¹⁶

c) *Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit gjyqësor dhe prokurorial*

KGJK dhe KPK në vazhdimësi proklamojnë ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies në raport me publikun dhe mediat. Të dy Këshillat kanë miratuar rregullore dhe strategji për të ngritur transparencën dhe llogaridhënien dhe për të lehtësuar bashkëpunimin me publikun dhe median.

IKD gjatë monitorimit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial gjatë tri viteve (2016, 2017, 2018), ka adresuar 837 kërkesa për qasje në dokumente publike, lidhur me përmbushjen e obligimeve ligjore, ofrimin e informacioneve, statistikave dhe të dhënave të tjera të disponueshme dhe lejueshme sipas Ligjit mbi Qasje në Dokumente Publike. Prej 837 kërkesave, IKD ka marr përgjigje pozitive në 391 kërkesa apo 47 % të tyre. Përgjigje negative ka marrë në 92 kërkesa apo 11 % të tyre, ndërsa nuk ka marrë fare përgjigje në 354 kërkesa apo 42 % të tyre. Rrjedhimisht, rezulton se sistemi gjyqësor dhe sistemi prokurorial në gjysmën e kërkesave të IKD-së nuk është përgjigjur pozitivisht.

Në vazhdim janë paraqitur numri i kërkesave të adresuara nga IKD në sistemin gjyqësor dhe sistemin prokurorial dhe përgjigjet në këto kërkesa.

¹⁶ Intervistë me z. Agim Maliqi, Kryetar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Lëndëve të Korrupsionit në Gjykata. Mars 2017 dhe mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rastet-e-shenjstruara-liberalizimi-i-vizave-emisioni-i-plote/>)



Grafika 1 – Numri i kërkesave të IKD-së për qasje në dokumentet publike në sistemin gjyqësor dhe prokurorial në tri vitet 2016, 2017 dhe 2018.

Në vazhdim janë paraqitur numri i kërkesave të adresuara nga IKD në sistemin gjyqësor dhe përgjigjet në këto kërkesa në tri vitet 2016, 2017 dhe 2018.

Kërkesat e IKD-së në sistemin gjyqësor për qasje në dokumentet publike në tri vitet (2016,2017,2018)							
Viti	Nr. i kërkesave	Përgjigje pozitive	Përqindja	Përgjigje negative	Përqindja	Pa përgjigje	Përqindja
2016	84	48	57%	0	0%	36	43%
2017	127	88	69%	19	15%	20	16%
2018	266	146	54%	18	6%	102	40%
Total	477	282	59%	37	7%	158	44%

Tabela 1 – Numri i kërkesave të IKD-së për qasje në dokumentet publike në sistemin gjyqësor në tri vitet 2016, 2017 dhe 2018.

Në vazhdim janë paraqitur numri i kërkesave të adresuara nga IKD në sistemin prokurorial dhe përgjigjet në këto kërkesa në tri vitet 2016, 2017 dhe 2018.

Kërkesat e IKD-së në sistemin prokurorial për qasje në dokumentet publike në tri vitet (2016,2017,2018)							
Viti	Nr. i kërkesave	Përgjigje pozitive	Përqindja	Përgjigje negative	Përqindja	Pa përgjigje	Përqindja
2016	111	46	41%	2	2%	63	57%
2017	141	21	15%	42	29%	78	56%
2018	108	42	39%	11	10%	55	51%
Total	360	109	30%	55	15%	196	55%

Tabela 2 – Numri i kërkesave të IKD-së për qasje në dokumentet publike në sistemin prokurorial në tri vitet 2016, 2017 dhe 2018.

Mos zbatimi i obligimeve ligjore dhe politikave të miratuar nga të dy Këshillat, forcon të gjeturat e IKD-së dhe vlerësimet e dala nga raportet ndërkombëtare dhe vendore lidhur me mungesën e vullnetit të sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial për të qenë transparent dhe llogaridhënës para publikut. Mos përmbushja e obligimeve dëshmon se ligji në Kosovë nuk zbatohet njëjtë ndaj të gjithëve. Në rastet kur zyrtarët e lartë nuk përmbushin obligimet dhe përgjegjësitë e tyre, kultura e pandëshkueshmërisë vazhdon të kultivohet.

IV. Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga sistemi prokurorial

a. Hetimet preliminare të korrupsionit nga sistemi prokurorial

Sistemi prokurorial gjatë vitit 2016 ka pranuar në punë 433 lëndë të korrupsionit në procedurë preliminare me 705 persona të përfshirë. Gjatë të njëjtës periudhë kohore, prokuroritë kanë arritur t'i zgjidhin 274 lëndë me 457 persona. Gjatë viteve 2017 dhe 2018, prokuroritë kanë arritur të zgjidhin më shumë lëndë se sa që kanë pranuar në punë. Përderisa në vitin 2017 kanë pranuar në punë 427 lëndë me 680 persona, në të njëjtën periudhë kanë zgjidhur 464 lëndë të viteve paraprake me 760 persona të përfshirë. Në vitin 2018, ky institucion ka zgjidhur 529 lëndë me 913 persona. Përderisa, PSh në fund të vitit 2016, kishte 700 lëndë të korrupsionit në fazën preliminare të mbetura në punë me 1201 persona të përfshirë, në fund të vitit 2018, ky numër ka rënë në 600 lëndë me 1052 persona të përfshirë.

Rastet e korrupsionit në fazën preliminare	Të bartura nga vitet paraprake		Të pranuar në punë		Gjithsejt në punë		Të zgjidhura		Të mbetura në punë	
	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P
2016	541	953	433	705	974	1658	274	457	700	1201
2017	632	1164	427	680	1059	1844	464	760	595	1084
2018	599	1056	443	746	1129	1965	529	913	600	1052

Tabela 3 – Rastet e korrupsionit në fazën parapenale në tri vitet 2016, 2017, 2018.

b. Hetimet në rastet e korrupsionit nga sistemi prokurorial


Në bazë të analizës së statistikave të Mekanizmit Përcjellës të miratuara nga KPK, lidhur me trajtimin e lëndëve të korrupsionit në vitet 2016, 2017 dhe 2018, rezulton se ka rënie të raportimit të veprave penale korruptive si në raport me numrin e rasteve ashtu edhe të personave. Përderisa, në vitin 2016 në PSh ishin parashtruar 438 lëndë të korrupsionit me 849 persona të përfshirë, në vitin 2017 ky numër ka rënë në 402 lëndë dhe 668 persona. Ndërsa, në vitin 2018 janë parashtruar vetëm 325 lëndë kundër 656 personave si të dyshuar për korrupsion.

Efikasiteti i PSh në trajtimin e lëndëve të korrupsionit në vitet 2016, 2017 dhe 2018 ka pasur rënie. Përderisa, gjatë vitit 2016 PSh kishte zgjidhur 468 lëndë të korrupsionit ndaj 1164 personave, efikasiteti në vitin 2017 ka pësuar rënie, ku janë zgjidhur 412 lëndë ndaj 902 personave të dyshuar për korrupsion. Ndërsa, në vitin 2018, PSh ka zgjidhur 408 lëndë me 772 persona të përfshirë.

Përderisa, PSh në fund të vitit 2016, kishte në punë 447 lëndë të pazgjidhura me 1248 persona të përfshirë, në fund të vitit 2018, ky numër ka rënë në 230 lëndë të pazgjidhura me 617 persona të përfshirë si të dyshuar në korrupsion.


Rastet e korrupsionit ndër vite	Të bartura nga vitet paraprake		Të pranuar në punë		Gjithsejt në punë		Të zgjidhura		Të mbetura në punë	
	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P
2016	477	1553	438	849	915	2412	468	1164	447	1248
2017	391	1097	402	668	793	1765	412	902	301	715
2018	303	707	325	656	638	1389	408	772	230	617

Tabela 4 – Rastet e kallëzimeve penale të korrupsionit në tri vitet 2016, 2017, 2018.



Grafika 2 – Krahasim i trajtimit të rasteve në vitet 2016, 2017 dhe 2018

PSh gjatë vitit 2016 ka pasur më së shumti lëndë të korrupsionit në punë, gjithsej 915 lëndë me 2412 persona të përfshirë. Në vitin 2016 edhe është zgjidhur numri më i madh i lëndëve të korrupsionit, gjithsej 468 me 1164 persona. Numri i lëndëve në punë dhe personave të përfshirë në ato raste vazhdimisht ka pësuar rënie në vitet pasuese, por ajo që vërehet është se edhe numri i rasteve të zgjidhura është ulur.



Grafika 3 – Krahasim i numrit të rasteve të zgjidhura të korrupsionit ndër vite.

c. Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit në fazën e hetimeve

Prokurori i Shtetit gjatë viteve 2016-2018 ka zgjidhur rastet e korrupsionit ndaj 2838 personave, ku ndaj 1063 personave kanë hudhur kallëzimet penale, ndaj 746 personave kanë pushuar hetimet, ndërsa ndaj 981 personave kanë ngritur aktakuzë.

Viti	Hudhje e kallëzimit penal	Pushimet e hetimeve	Aktakuzë	Mënyrë tjetër e zgjidhjes	Total
2016	480	257	418	9	1164
2017	335	250	312	5	902
2018	248	239	251	34	772
Total	1063	746	981	48	2838

Tabela 5 – Krahasim i numrit të rasteve të zgjidhura të korrupsionit ndër vite.

Në vazhdim është paraqitur grafika për rastet e korrupsionit të vendosura nga prokurorët në tri vitet 2016, 2017 dhe 2018 ku përfshihen numri i personave ndaj të cilëve janë hudhur kallëzimet penale, janë pushuar hetimet dhe janë ngritur aktakuzat.



Grafika 4 – Numri i personave të dyshuar të përfshirë në korrupsion ndaj të cilëve janë hudhur kallëzimet penale, janë pushuar hetimet dhe janë ngritur aktakuza.

Në bazë të analizës së të dhënave statistikore të mekanizmit përcjellës të KPK-së, del se prokuroritë për tre vite, në 63.8% të rasteve i kanë mbyllur (*ku përfshihen hudhjet dhe pushimet*) ndaj personave të dyshuar për korrupsion, respektivisht duke mbyllur këto raste pa shkuar fare përmes kontrollit gjyqësor. Përderisa, në 34.6% të rasteve kanë ngritur aktakuzë ndaj personave të dyshuar për korrupsion. Prokuroritë ndaj 48 personave i kanë zgjidhur raste në mënyrë tjetër apo në 1.5% të tyre.

Trajtimi i lëndëve të korrupsionit nëpër Prokuroritë Themelore dhe në PSRK

Në fund të vitit 2018, PSh-së i kanë mbetur në punë 230 raste të pazgjidhura të korrupsionit me 617 persona të përfshirë, nga 447 raste me 1248 persona që ky institucion kishte në fund të vitit 2016. Prokurori i Shtetit për tre vite ka arritur që pothuajse të përgjysmojë numrin e lëndëve të korrupsionit, duke marrë për bazë edhe ndihmën dhe mbështetjen e ofruar nga IKD, qoftë përmes hartimit të planeve të veprimit për KPK dhe PTh në Prishtinë lidhur me trajtimin e lëndëve të korrupsionit, monitorimin sistematik të këtyre lëndëve si dhe ofrimin e rekomandimeve konkrete.

Në bazë të analizës së të dhënave statistikore të Mekanizmit Përcjellës paraqitet fakti se një numër i madh i Prokurorive Themelore në fund të vitit 2018, kanë numër të vogël të lëndëve të korrupsionit, ku PTh në Pejë në fund të vitit 2018, i ka mbetur vetëm një lëndë me shtatë persona të përfshirë, Gjilani me 8 lëndë dhe 13 persona të përfshirë, Gjakova me 15 lëndë dhe 23 persona të përfshirë.

Prokuroria		Prishtinë			Prizren			Mitrovicë			Pejë		
Vitet		2016	2017	2018	2016	2017	2018	2016	2017	2018	2016	2017	2018
Lëndët e pranuara	R	159	208	148	39	13	41	33	35	17	61	38	24
	P	280	319	326	80	25	76	91	51	22	92	57	42
Lëndët e zgjidhura	R	207	210	185	33	11	45	23	29	41	63	45	31
	P	553	476	365	71	22	66	60	82	80	99	68	47
Lëndë të mbetura të pazgjidhura	R	223	137	90	27	5	20	82	82	63	21	9	1
	P	655	352	319	69	10	50	192	151	96	40	11	7

Tabela 6 – Gjendja e lëndëve të korrupsionit në këto Prokurori tri vitet 2016, 2017, 2018.

Karakteristikë në trajtimin e lëndëve të korrupsionit paraqet PSRK, e cila prokurori shihet se në krahasim me vitet paraprake, shfrytëzon shumë më pak ushtrimin e kompetencave plotësuese në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Përderisa kjo prokurori, në vitin 2016 kishte pranuar në punë 12 lëndë të korrupsionit, në vitin 2017 ka pranuar vetëm katër lëndë të reja, kurse në vitin 2018, ka pranuar në punë gjashtë lëndë të reja të korrupsionit.

Prokuroria		Gjakovë			Gjilan			Ferizaj			PSRK		
Vitet		2016	2017	2018	2016	2017	2018	2016	2017	2018	2016	2017	2018
Lëndët e pranuara	R	22	31	31	94	47	40	18	26	18	12	4	6
	P	31	44	47	201	80	71	32	75	34	42	17	38
Lëndët e zgjidhura	R	18	34	32	83	48	43	20	21	22	21	14	9
	P	28	53	46	170	80	73	28	66	36	155	55	59
Lëndë të mbetura të pazgjidhura	R	19	15	15	19	12	8	17	22	19	39	19	14
	P	35	21	23	48	25	13	47	57	59	162	88	50

Tabela 7 – Gjendja e lëndëve të korrupsionit në këto Prokurori tri vitet 2016, 2017, 2018.

Po ashtu, efikasiteti dhe performanca e kësaj prokurorie në dy vitet e fundit është e nivelit më të ultë. Përderisa, kjo prokurori në vitin 2016 ka zgjidhur unduar 21 lëndë me 159 persona, në vitin 2018, e njëjta ka zgjidhur vetëm 9 lëndë me 59 persona të përfshirë. Po ashtu, në fund të vitit 2018, kësaj prokurorie i kanë mbetur në punë 14 lëndë me 50 persona, përderisa në fund të vitit 2016, kishte 39 lëndë me 162 persona të përfshirë.

Numri më i madh i lëndëve të pazgjidhura mbetet ende në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, e cila vitin 2019 e ka filluar me 90 lëndë të pazgjidhura të korrupsionit me 319 persona të përfshirë. Po ashtu PTh në Prishtinë, gjatë vitit 2018, ka qenë prokuroria më efikase në trajtimin e lëndëve të kësaj natyre. Kjo prokurori gjatë kësaj periudhe ka zgjidhur 185 lëndë me 365 persona. Edhe kjo prokurori ka arritur që në masë të madhe ta zvogëlojë

numrin e lëndëve të korrupsionit. Përderisa, e nëjta prokurorinë fund të vitit 2016, kishte të papërfunduara 223 lëndë me 655 persona, ky numër në vitin 2018, ka rënë në vetëm 90 lëndë me 319 persona të përfshirë.

Parashtruesit e kallëzimeve penale

Sipas Mekanizmit Përcjellës të KPK-së, gjatë viteve 2016-2018, PSh nga parashtruesit e kallëzimeve penale ka pranuar 1157 lëndë të korrupsionit me 2171 persona të përfshirë. Numri më i madh i kallëzimeve penale është parashtruar nga Policia e Kosovës me 452 kallëzime penale ndaj 934 personave të përfshirë, pasuar nga AKK me 240 kallëzime penale ndaj 273 personave të përfshirë. Subjektet e dëmtuara për tri vitet e fundit kanë parashtruar 161 kallëzime penale ndaj 319 personave të përfshirë, përderisa qytetarët kanë paraqitur në PSh 108 kallëzime penale ndaj 223 personave të përfshirë.

SUBJEKTET PARASHTRUESE		GJITHSEJ:	
		Raste	Persona
1	AKK	240	273
2	AKP	2	2
3	APJ	4	4
4	ATK	4	4
5	Doganat	3	14
6	ID	161	319
7	EPK	88	185
8	IPK	45	126
9	OAK	8	17
10	Policia e Kosovës	452	934
11	PV	27	54
12	Q	108	223
13	TP	11	12
14	AGJ	3	3
15	Avokati komunal	1	1
Totali		1157	2171

Tabela 8 – Parashtruesit e kallëzimeve penale për korrupsion në tri vitet 2016, 2017, 2018.

d. Ngritja e aktakuzave për korrupsion dhe profili i të akuzuarve sipas njoftimeve të PSh-së

IKD vazhdimisht përgjatë tri viteve ka monitoruar dhe analizuar profilin e kryesve të veprave penale të korrupsionit në bazë të informatave të publikuara nga PSh në faqen zyrtare të saj.

Ky institucion e ka informuar publikun dhe ka publikuar në faqe vetëm 65 aktakuza të ngritura ndaj 376 personave.

Profili i pozitave të personave ndaj të cilëve janë ngritur aktakuzat, përfshi: Ministër, ish-Deputet, ish-Kryetar të Gjykatës, Kryetar Komune, ish-Kryetar Komune, Sekretar të Përgjithshëm në Ministri, kryeinspektor, drejtor komunal, asambleist komunal, drejtor shkolle, ish-Drejtor i Krimeve Ekonomike në Policinë e Kosovës, Anëtar i Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së UÇK-së dhe zyrtarë kryesisht të nivelit të mesëm dhe të ulët.

Sipas aktakuzave të ngritura nga Prokuroritë del se me këto vepra penale, dëmi i shkaktuar kap vlerën e mbi **71,000,000 eurove**, ndonëse në shumë prej këtyre aktakuzave nuk ka informacion mbi dëmin e shkaktuar.

Në anën tjetër, në këto aktakuza nuk ka informacion nëse prokuroritë kanë paraqitur kërkesa për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale.

Në faqe të PSh për këtë periudhë kohore, publiku është informuar vetëm për ngritjen e aktakuzave të natyrës së korrupsionit nga PTh-të në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjiilan, PSRK, ZKPSH dhe EULEX.

Prokuroria më efikase gjatë këtyre tri viteve, bazuar në të dhënat e publikuara nga PSh, rezulton të jetë PTh në Prishtinë me 3 aktakuza ndaj 7 personave, PTh në Prizren me 25 aktakuza të ngritura ndaj 69 personave, pastaj PSRK me 22 aktakuza ndaj 203 personave, pasuar nga PTh në Pejë me 8 aktakuza të ngritura ndaj 15 personave, ZKPSH me 1 aktakuzë ndaj 64 personave, EULEX me një aktakuzë ndaj 6 personave dhe PTh në Gjiilan me 5 aktakuzë ndaj 12 personave.

Për më tepër, shih në fund të këtij raporti tabelën në aneksin 1 për të gjitha rastet e aktakuzave të ngritura për të cilat ka njoftuar PSh.¹⁷

e. Efikasiteti i Prokurorëve në Departamentin e Krimeve të Rënda

IKD ka analizuar performancën e prokurorëve në trajtimin e lëndëve të Departamentit të Krimeve të Rënda në tri vitet e fundit 2016, 2017, 2018¹⁸. Arsyeja e kësaj analize të performancës së prokurorëve, ka të bëjë me faktin, se këta prokurorë janë të ngarkuar me

¹⁷ *Shënim:* Në fund të këtij raporti gjeni të bashkangjitur tabelën në aneksin 1 për të gjitha rastet e aktakuzave të ngritura gjatë tri viteve për të cilat ka njoftuar PSh përmes komunikatave për media, ku përfshihen data e njoftimit, profili i personave të akuzuar, vlera e dëmit të shkaktuar, kërkesat për sekuestrim/konfiskim të pasurive, numri i personave të akuzuar dhe nga cila prokurori është ngritur aktakuza.

¹⁸ Burimi: Raportet vjetore të Punës së Prokurorit të Shtetit për tri vitet 2016, 2017, 2018.

lëndë të natyrës korruptive. Kjo nuk do të thotë që këta prokurorë kanë punuar ekskluzivisht vetëm me rastet e korrupsionit, sepse të njëjtit kanë qenë të angazhuar edhe në zgjidhjen e lëndëve të natyrave të tjera. Sidoqoftë, analiza e të dhënave statistikore, tregon se ka rënie të performancës së Prokurorëve, rrjedhimisht prokurorive ndër vite. Në bazë të të dhënave zyrtare, rezulton se disa prokurorë kanë performancë shumë të mirë, duke tejkaluar normat orientuese të prokurorëve për kryerjen e lëndëve të përcaktuara nga KPK përmes Udhëzimit Administrativ, përderisa disa prokurori kanë performancë shumë më të ulët se sa norma orientuese. Udhëzimi Administrativ lidhur me normën orientuese për prokuror në Departament të Krimeve të Rënda ka përcaktuar obligimin që çdo prokuror duhet të përfundoj brenda një viti kalendarik 66 lëndë.

Prokuroritë	2016				2017				2018			
	Numri i rasteve të zgjidhura në 2016	Numri i prokurorëve	Mesatarja e rasteve të zgjidhura nga prokurorët	Performanca në bazë të normës orientuese	Numri i rasteve të zgjidhura në 2017	Numri i prokurorëve	Mesatarja e rasteve të zgjidhura nga prokurorët	Performanca në bazë të normës orientuese	Numri i rasteve të zgjidhura në 2018	Numri i prokurorëve	Mesatarja e rasteve të zgjidhura nga prokurorët	Performanca në bazë të normës orientuese
Prishtinë	1371	16	86	130%	888	18	49	75%	527	16	33	50%
Prizren	400	6	67	102%	241	5	48	75%	173	4	43	65%
Mitrovicë	424	2	212	321%	294	2	147	222%	350	4	87	132%
Pejë	433	5	87	132%	193	5	39	60%	125	5	25	38%
Gjakovë	222	2	111	169%	150	3	50	76%	94	2	47	71%
Gjilan	359	6	60	91%	291	5	58	88%	276	4	69	105%
Ferizaj	244	3	81	123%	213	1	213	322%	243	3	61	92%
Total	3453	40	86	130%	2270	39	58	88%	1788	38	56	85%
PSRK	207	10	21	95%	164	14	12	55%	182	14	13	59%

Tabela 9 – Efikasiteti i Prokurorëve në Departamentin e Krimeve të Rënda në tri vitet 2016, 2017, 2018.

Prokurorët e PTh në Prishtinë në vitin 2016, kanë pasur normë të efikasitetit prej 130%, performanca e prokurorëve të kësaj prokurorie në vitin 2018, ka rënë në 50% të përmbushjes së normës orientuese. Respektivisht, kjo prokurori me numrin e prokurorëve që ka pasur në sistem gjatë këtij viti do të duhej të përfundonte 1056 lëndë në krime të rënda, përderisa në realitet ka arritur të përfundojë vetëm 527 lëndë.

PTh në Mitrovicë, gjatë vitit 2016, ka pas normë të efikasitetit 321%, kurse gjatë vitit 2018, ka pasur rënie të efikasitetit në 132%.

Gjatë vitit 2018, performancën më të ultë e ka realizuar PTh në Pejë. Kjo prokurori gjatë vitit 2018, me pesë prokurorë në Department të Krimeve të Rënda ka zgjidhur vetëm 125 raste, nga 330 sa e kanë pasur obligim të zgjidhin në bazë të normës orientuese. Efikasiteti i kësaj prokurorie ka qenë vetëm 38% në përmbushjen e normës.

Gjendje pothuajse e njëjtë është edhe në PSRK. Prokurori në PSRK në bazë të normës orientuese duhej të përfundonte 22 lëndë brenda vitit. Kjo prokurori në vitin 2016, kishte performancë prej 95% të përmbushjes së normës orientuese vjetore, ndërsa ky efikasitet ka rënë në vitin 2017 në 55%, kurse në vitin 2018 ka qenë 59%. Gjatë vitit 2018, kjo prokurori kishte 14 prokurorë, të cilët kanë zgjidhur 182 lëndë, nga 308 sa e kanë pasur për obligim të zgjidhin sipas Udhëzimit Administrativ të përcaktuar nga KPK.

V. Trajtimi i rasteve të korrupsionit në sistemin gjyqësor

a. Vendimet e gjykatave në rastet e korrupsionit sipas Mekanizmit Përcjellës të KPK

Tabela më poshtë tregon efikasitetin e mbrojtjes së aktakuzave të parashtruara në Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës nga secila prokurori respektive.

PROKURORIA	Numri Personave për të cilët Gjykata ka marrë vendim përkitazi me Aktet akuzuese	Aktakuza është hudhur para shqyrtimit gjyqësor	I akuzuari është shpallur fajtor	I akuzuari është liruar	Refuzuar
1 PSRK	28	3	16	5	4
2 Prishtinë	239	38	98	51	52
3 Prizren	133	7	73	41	12
4 Pejë	49	5	34	10	0
5 Gjilan	16	3	4	9	0
6 Mitrovicë	44	8	23	10	3
7 Ferizaj	73	1	47	13	12
8 Gjakovë	51	7	21	16	7
GJITHSEJ:	633	72	316	155	90

Tabela 10 – Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit gjatë tri viteve për aktakuzat e secilës prokurori sipas Mekanizmit Përcjellës në KPK.

PSRK - Gjykatat e Kosovës gjatë tri viteve 2016, 2017, 2018 kanë gjykuar gjithsej 28 persona të akuzuar nga PSRK. Prej tyre 16 persona janë shpallur fajtor, ndërsa 12 janë liruar nga përgjegjësia penale. Karakteristikë për këtë prokurori paraqet fakti se ndaj tre personave, aktakuza është hudhur para shqyrtimit gjyqësor.

PTh në Prishtinë – PTh në Prishtinë mbetet prokuroria që ka numrin më të madh të rasteve për të cilat kanë vendosur gjykatat e Kosovës apo 45.6% të të gjithë personave ndaj të cilëve gjykatat kanë shpallur aktgjykime në rastet e korrupsionit. Gjykatat gjatë tri viteve 2016, 2017, 2018 kanë trajtuar aktakuza kundër 239 personave, të parashtruara nga kjo prokurori. Prej tyre 98 persona janë shpallur fajtor, ndërsa 141 persona janë liruar nga përgjegjësia

penale. Edhe tek rasti i PTh në Prishtinë vërehet numër i madh i lëndëve që hudhen nga gjykatat para shqyrtimit gjyqësor, respektivisht ndaj 38 personave.

PTh Prizren - Gjykatat gjatë tri viteve 2016, 2017, 2018 kanë trajtuar lëndët e korrupsionit të parashtruara nga kjo prokurori ndaj 133 personave. Prej tyre, 73 persona janë shpallur fajtor, ndërsa 60 persona janë liruar nga përgjegjësia penale.

PTh Pejë - Gjykatat gjatë tri viteve 2016, 2017, 2018 kanë trajtuar lëndët e korrupsionit të parashtruara nga kjo prokurori ndaj 49 personave. Prej tyre, 34 persona janë shpallur fajtor, ndërsa 15 janë liruar nga përgjegjësia penale.

PTh Gjilan - Gjykatat gjatë tri viteve 2016, 2017, 2018 kanë trajtuar lëndët e korrupsionit të parashtruara nga kjo prokurori ndaj 16 personave. Prej tyre, 4 persona janë shpallur fajtor, ndërsa 12 janë liruar nga përgjegjësia penale.

PTh Mitrovicë - Gjykatat gjatë tri viteve 2016, 2017, 2018 kanë trajtuar lëndët e korrupsionit të parashtruara nga kjo prokurori ndaj 44 personave. Prej tyre, 23 persona janë shpallur fajtor, ndërsa 21 janë liruar nga përgjegjësia penale.


PTh Ferizaj - Gjykatat gjatë tri viteve 2016, 2017, 2018 kanë trajtuar lëndët e korrupsionit të parashtruara nga kjo prokurori ndaj 73 personave. Prej tyre, 47 persona janë shpallur fajtor, ndërsa 26 janë liruar nga përgjegjësia penale.

PTh Gjakovë - Gjykatat gjatë tri viteve 2016, 2017, 2018 kanë trajtuar lëndët e korrupsionit të parashtruara nga kjo prokurori ndaj 51 personave. Prej tyre, 21 persona janë shpallur fajtor, ndërsa 30 janë liruar nga përgjegjësia penale.

b. Vendimet e gjykatave në rastet e korrupsionit sipas Mekanizmit Përcjellës të KGJK


Sipas Mekanizmit Përcjellës të KGJK-së, Gjykatat e Kosovës gjatë tri viteve 2016, 2017, 2018, kanë pranuar në punë 620 aktakuza të parashtruara nga PSh. Në raport me vitet 2016 dhe 2017, performanca e PSh në vitin 2018, ka pësuar rënie të konsiderueshme. Përderisa, PSh gjatë vitit 2016, kishte parashtruar në gjykata 232 aktakuza, në vitin 2017 ky numër ka rënë në 223, kurse në vitin 2018, numri ka rënë në 165 aktakuza të parashtruara për korrupsion. Numri i rasteve të korrupsionit në Gjykatat e Kosovës ka rënë nga 407 lëndë që kanë qenë në fillim të vitit 2016, në 263 lëndë të korrupsionit në fund të vitit 2018.

Edhe efikasiteti i gjykatave të Kosovës në trajtimin e lëndëve të korrupsionit ka pësuar rënie vit pas viti. Përderisa, gjykatat në vitin 2016, kanë zgjidhur 284 lëndë, ky numër në vitin 2017 ka rënë në 254 lëndë, kurse në vitin 2018, gjykatat kanë zgjidhur vetëm 202 lëndë të korrupsionit. Për më tepër, shih grafikën më poshtë.



Grafika 5 - Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore gjatë viteve 2016, 2017, 2018.

Gjykatat e Kosovës gjatë tri viteve 2016, 2017, 2018 kanë marrë aktgjykime ndaj 740 personave të dyshuar për vepra penale të korrupsionit. Prej këtij numri të personave të gjykuar, gjykatat ndaj 101 personave apo ndaj 13.6% të tyre kanë shpallur aktgjykime me dënim me burgim efektiv. Ndaj 128 personave apo ndaj 17.2% të tyre, gjykatat kanë shqiptuar dënime me gjobë. Ndaj 145 personave apo 19.5% të tyre gjykatat kanë shqiptuar dënime me kusht. Gjykatat kanë liruar nga përgjegjësia penale lidhur me rastet e korrupsionit 252 persona apo 34% të personave të akuzuar (*duke përfshirë aktgjykimet liruese, refuzuese dhe parashkrimin absolut*). Gjykatat ndaj 6 personave kanë shqiptuar dënime të tjera dhe ndaj 108 personave të tjerë kanë zgjidhur lëndët në mënyrë tjetër.



Grafika 6 – Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit gjatë tri viteve sipas mekanizmit përcjellës në KGJK.

c. Efikasiteti i Gjykatave në Departamentin e Krimeve të Rënda

IKD ka analizuar performancën e gjykatësve në trajtimin e lëndëve në Departamentin e Krimeve të Rënda për tri vitet 2016, 2017, 2018.¹⁹ Arsyeja e kësaj analize të performancës së gjykatësve, ka të bëjë me faktin, se këta prokurorë janë të ngarkuar me lëndët e natyrës korruptive. Kjo nuk do të thotë që këta gjykatës kanë punuar ekskluzivisht vetëm me rastet e korrupsionit, sepse të njëjtit kanë qenë të angazhuar edhe në zgjidhjen e lëndëve të natyrave të tjera. Sidoqoftë, analiza e të dhënave statistikore, tregon se edhe në Gjykatat e Kosovës ka rënie të performancës në trajtimin e lëndëve ndër vite. Në vitin 2016, gjykatësit e këtij departamenti e kishin tejkaluar normën orientuese për gjykatës të përcaktuar nga KGJK për 137%. Në vitin 2017, ky efikasitet ka rënë në 89%, ndërsa në vitin 2018, ky efikasitet ka rënë edhe më tutje në 72%.

¹⁹ Burimi: Raportet vjetore të Punës së Gjykatave për tri vitet 2016, 2017, 2018

Gjykatat	2016				2017				2018			
	Numri i rasteve të zgjidhura në 2016	Numri i gjykatësve	Mesatarja e rasteve të zgjidhura nga gjykatësit	Performanca në bazë të normës orientuese	Numri i rasteve të zgjidhura në 2017	Numri i gjykatësve	Mesatarja e rasteve të zgjidhura nga gjykatësit	Performanca në bazë të normës orientuese	Numri i rasteve të zgjidhura në 2018	Numri i gjykatësve	Mesatarja e rasteve të zgjidhura nga gjykatësit	Performanca në bazë të normës orientuese
Prishtinë	691	14	49	99%	751	14	54	109%	629	18	35	71%
Prizren	234	5	47	95%	168	6	28	57%	134	6	22	44%
Mitrovicë	601	4	150	303%	140	4	35	71%	298	8	37	75%
Pejë	391	5	98	198%	183	5	37	75%	139	5	28	57%
Gjakovë	263	4	66	133%	161	4	49	99%	91	4	23	47%
Gjilan	470	6	78	158%	329	6	55	111%	314	5	63	127%
Ferizaj	191	4	48	97%	198	5	40	81%	205	4	51	103%
Total	2841	42	68	137%	1930	44	44	89%	1810	50	36	72%

Tabela 11 – Efikasiteti i Gjykatësve në Departamentin e Krimeve të Rënda në tri vitet 2016, 2017, 2018.

Në bazë të të dhënave të paraqitura në tabelë rezulton se disa gjykatës kanë performancë shumë të mirë, duke tejkaluar normën orientuese të përcaktuar nga KGJK përmes Udhëzimit Administrativ, ndërsa disa gjykatës kanë performancë shumë më të ulët se sa norma orientuese. Udhëzimi Administrativ lidhur me normën orientuese për gjykatës në krimet e rënda ka përcaktuar obligimin që çdo gjykatës duhet të përfundoj brenda një muaji tre lëndë të komplikuar ose shtatë lëndë të lehta.

Gjykatësit e GjTh në Prishtinë në vitin 2016, kanë pasur normë të efikasitetit prej 99%, ndërsa performanca e gjykatësve të kësaj gjykate në vitin 2018, ka rënë në 71% të përmbushjes së normës orientuese.

Gjykatësit e GjTh në Gjilan, gjatë vitit 2016, kanë pas normë të efikasitetit 158%, kurse gjatë vitit 2018, kanë pasur normë të efikasitetit 127%.

Gjatë vitit 2018, performancën më të ulët e kanë realizuar gjykatësit e GjTh në Prizren dhe ata në Gjakovë. Gjykatësit e Departamentit për Krime të Rënda në Prizren gjatë vitit 2018 kanë përmbushur vetëm 44% të normës orientuese, ndërsa në vitin 2016 e kanë përmbushur 95% të normës orientuese. Efikasiteti i gjykatësve të këtij Departamenti në GjTh në Gjakovë gjatë vitit 2016, ka qenë 133%, ndërsa në vitin 2018 ka rënë në vetëm 47%.

VI. Monitorimi i IKD-së në proceset gjyqësore në rastet e korrupsionit

IKD²⁰ monitoron sistematikisht rastet e korrupsionit në të gjitha Gjykatat Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës. Ekipi i monitoruesve të IKD-së vazhdimisht në mënyrë sistematike kanë vizituar të gjitha Gjykatat dhe Kryetarët e Gjykatave Themelore, Prokuroritë dhe Kryeprokurorët e Prokurorive Themelore për të monitoruar për së afërmi secilin proces gjyqësor që ndërlidhet me veprat penale të korrupsionit. Monitorimi ka përfshirë procesin e identifikimit të rasteve të korrupsionit në punë, caktimin dhe ndarjen në punë të lëndëve, informacionet se në cilën fazë të procedurës gjenden këto raste në gjykata dhe raportimin e tyre për publikun në baza ditore përmes uebfaqes.²¹ Sfidat në identifikimin e rasteve të korrupsionit dhe sigurimin e orarit të seancave gjyqësore kanë qenë dhe mbesin të vazhdueshme për monitoruesit e IKD-së.²² Sidoqoftë, IKD dhe KGJK kanë nënshkruar edhe Memorandum të Bashkëpunimit²³, i cili ka lehtësuar qasjen e monitoruesve të IKD-së në gjykata, komunikimin, bashkëpunimin dhe koordinimin.

a. Seancat gjyqësore të korrupsionit të monitoruara nga IKD përgjatë tri viteve


Monitoruesit e IKD-së prej 1 janarit 2016 deri më 31 dhjetor 2018 kanë monitoruar 3994 seanca gjyqësore të veprave penale të korrupsionit. Prej tyre 2860 seanca apo 71% e tyre janë mbajtur, ndërsa 1134 apo 29% e tyre janë shtyrë. Shih grafikën më poshtë.

²⁰ IKD prej nëntorit 2013 monitoron sistematikisht sistemin prokurorial dhe sistemin gjyqësor në trajtimin e rasteve të korrupsionit.

²¹ IKD në bashkëpunim me Radio Televizionin Publik bashkëprodhojnë emisionin e specializuar për fushën e sundimit të ligjit “Betimi për Drejtësi”. Krahas kësaj, është zhvilluar edhe portali “Betimi për Drejtësi”, në të cilin përveç hulumtimeve, analizave dhe debateve që zhvillohen në emision, publikohen në baza të përditësuara edhe raportet e monitoruesve të IKD-së për të gjitha rastet e korrupsionit. Raportimi bëhet në rubrikën e veçantë të portalit, të cilat gjenden në këtë link <http://betimiperdrejtesi.com/lajme/>

²² GjTh-të ende nuk kanë një sistem efikas dhe efektiv të azhurnimit të bazës së të dhënave për orarin e mbajtjes së seancave gjyqësore në përgjithësi dhe në veçanti për rastet e korrupsionit. Fillimisht, IKD ka vendosur komunikim përmes Kryetarëve të GjTh-ve dhe më pas përmes zëdhënësve të këtyre gjykatave, të cilët kanë informuar monitoruesit e IKD-së për orarin e caktimit të seancave gjyqësore për rastet e korrupsionit. Megjithatë, kjo praktikë nuk ka funksionuar në mënyrën më të mirë, sepse zëdhënësit kanë dërguar tek monitoruesit e IKD-së informacione jo të plota dhe jo të sakta për orarin e seancave, gjë që ka shkaktuar probleme për monitorimin e tyre. Ky komunikim përditë ka avancuar, megjithatë ende ka probleme praktike që ndërlidhen me orarin e seancave gjyqësore në rastet e korrupsionit. Duke parë këto sfida, IKD duke shfrytëzuar legjislationin pozitiv për të pasur qasje në të gjitha informatat e nevojshme rreth këtyre rasteve, ka nënshkruar Memorandum të Bashkëpunimit me KGJK-në, përmes të cilit mundësohet një qasje, komunikim, bashkëpunim dhe koordinim më të mirë në mes të monitoruesve të IKD-së dhe KGJK-së, përkatësisht të të gjitha niveleve të Gjykatave dhe Kryetarëve.

²³ Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të KGJK-së dhe IKD-së është aprovuar unanimisht nga të gjithë anëtarët e KGJK-së në mbledhjen e mbajtur më 6 prill 2016, ndërsa është nënshkruar mes drejtuesve të KGJK-së dhe IKD-së më 7 prill 2016. Prishtinë, 7 prill 2016.



Grafika 7 – Numri i seancave gjyqësore të korrupsionit të monitoruara nga IKD gjatë tri viteve.

Në vitin 2016, IKD ka monitoruar 383 raste të korrupsionit, ku përfshihen 989 persona të akuzuar, në vitin 2017 ka monitoruar 357 raste të korrupsionit, ku përfshihen 1027 persona të akuzuar dhe në vitin 2018 ka monitoruar 320 raste të korrupsionit, ku përfshihen 935 persona të akuzuar. Shih tabelën më poshtë.²⁴

Numri i rasteve dhe personave të monitoruara nga IKD					
2016		2017		2018	
Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
383	989	357	1027	320	935

Tabela 12 – Numri i rasteve të korrupsionit dhe personat e përfshirë në to në rastet e monitoruara nga IKD në tri vitet 2016, 2017 dhe 2018.

Gjykatat më e ngarkuar me lëndë të korrupsionit, vazhdon të mbetet Gjykata Themelore në Prishtinë, në të cilën IKD për tri vite ka monitoruar 1983 seanca gjyqësore për korrupsion. Prej tyre 1316 seanca apo 66 % e tyre janë mbajtur, ndërsa 667 seanca apo 44% e tyre nuk janë mbajtur por janë shtyrë. Për më tepër shih, tabelën më poshtë, në të cilën janë paraqitur të gjitha seancat e monitoruara në të gjitha Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës.

²⁴ *Shënim:* Në këtë rast nuk mund të mblidhen rastet e monitoruara për tri vite, për shkak se një numër i madh i rasteve të monitoruara në këto tri vite, janë rastet e njëjta të cilat kanë filluar të procedohen para dhe gjatë kësaj periudhe të monitorimit. Disa prej tyre kanë përfunduar, disa prej tyre kanë vazhduar dhe vazhdojnë ende të procedohen në gjykata.

Monitorimi i seanceve gjyqësore në rastet e korrupsionit nga IKD në tri vite									
Gjykata	Monitorimi 2016			Monitorimi 2017			Monitorimi 2018		
	Seanca	Të mbajtura	Të shytyra	Seanca	Të mbajtura	Të shytyra	Seanca	Të mbajtura	Të shytyra
Prishtinë	632	430	202	698	447	251	653	439	214
Prizren	233	185	48	166	127	39	87	74	13
Pejë	117	99	18	86	59	27	61	38	23
Gjilan	186	148	38	172	113	59	192	144	48
Mitrovicë	89	71	18	63	44	19	50	32	18
Ferizaj	145	118	27	50	37	13	81	62	19
Gjakovë	103	88	15	62	47	15	68	58	10
Total	1505	1139	366	1297	874	423	1192	847	345

Tabela 13 – Numri i rasteve të korrupsionit dhe personat e përfshirë në to në rastet e monitoruara nga IKD për secilën gjykatë në tri vitet 2016, 2017 dhe 2018.

b. Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit

Nga rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës, prej 1 janarit 2016 deri më 31 dhjetor 2018, kanë shpallur 518 aktgjykime, ku janë përfshirë 996 persona.

Aktgjykimet e shpallur në shkallë të parë ndaj këtyre 996 personave, dëshmojnë se gjykatësit kryesisht zbatojnë politikë të butë ndëshkimore ndaj kryesve të veprave penale të korrupsionit. Prandaj, në këtë drejtim IKD vlerëson se politika e dënimeve në rastet e korrupsionit vazhdon të mbetet e butë dhe joadekuate për të arritur qëllimin e dënimit.

Në vazhdim është paraqitur tabela, e cila pasqyron detajet e vendimeve të shqiptuara nga ana e gjykatësve në këto 518 aktgjykime për rastet e korrupsionit. Shih tabelën.

Aktgjykimet për rastet e korrupsionit nga Gjykatat Themelore për tri vite									
Viti	Dënim me burg		Dënim me kusht		Dënim me gjobë		Aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Hudhje aktakuzës - parashkrim
	Persona	Muaj	Persona	Muaj	Persona	Euro	Persona	Persona	Persona
2016	63 ²⁵	878	61 ²⁶	710	22	47,450	115	79	26
2017	56 ²⁷	773	72 ²⁸	757	43	210,300	114	31 ²⁹	27 ³⁰
2018	57 ³¹	893	45 ³²	382	33	131,680	95	41	16
Total	176	2544	178	1849	98	389,430.00	324	151	69

Tabela 12 - Rastet e aktgjyimeve të monitoruara nga IKD.

Gjetjet e IKD-së, nga procesi i monitorimit të rasteve të korrupsionit, tregojnë se numri më i madh i personave të akuzuar për korrupsion janë liruar nga akuza, kurse më pak se gjysma e të akuzuarve kanë marrë dënim me burg efektiv, me kusht apo me gjobë. (Shih grafikën)

²⁵ Sqarim: Nga 63 personat e dënuar me burg, 17 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 15,600 euro.

²⁶ Sqarim: Nga 61 personat e dënuar me kusht, 10 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 6,550 euro.

²⁷ Sqarim: Nga 56 personat e dënuar me burg, 24 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 80,400 euro.


²⁸ Sqarim: Nga 72 personat e dënuar me kusht, 26 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 54,565 euro.

²⁹ Sqarim: Një nga 31 personat ndaj të cilit është shpallur aktgjykim refuzues në rastin e parë, është i njëjti që për rastin e dytë ndaj tij është shpallur aktgjykim lirues.

³⁰ Sqarim: Një nga 27 personat ndaj të cilit është shpallur aktgjykim lirues në rastin e parë, është i njëjti që për rastin e dytë ndaj tij është shpallur aktgjykim dënues dhe atë burgim me kusht.

³¹ Sqarim: Nga 57 personat e dënuar me burg, 28 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 77,300 euro.

³² Sqarim: Nga 45 personat e dënuar me kusht, 8 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 11,200 euro.



Grafika 8 – Personat e gjykuar për korrupsion në tri vitet e fundit.

Nga 996 personat e akuzuar, Gjykatat rezultojnë se kanë dënuar me burg efektiv 176 persona apo 17.7 % të personave të akuzuar. Gjithashtu, nga këta 996 persona të akuzuar, gjykatësit ndaj 178 personave kanë shqiptuar dënime me kusht apo ndaj 17.9% të personave të akuzuar, ndaj 98 personave kanë shqiptuar dënime me gjobë apo ndaj 9.8% të personave të akuzuar, ndërsa janë liruar 544 persona apo 54.6% të personave të akuzuar.

Aktgjykimet e shpallura për korrupsion gjatë vitit 2016

Gjetjet e IKD-së, nga procesi i monitorimit të rasteve të korrupsionit, tregojnë se në rastet ndaj 366 personave ndaj të cilëve është marrë aktgjykim në shkallë të parë, ndaj 63 personave kanë marrë aktgjykim me dënim me burg, në total prej tetëqindeshtatëdhjetetë (878) muajve apo shtatëdhjetë (73) vite e dy (2) muaj për të gjithë personat e dënuar.

Nga 63 personat e dënuar dy persona janë dënuar me nga 2 muaj burg, dy persona janë dënuar me nga 3 muaj burg, dy persona janë dënuar me nga 4 muaj burg, pesë persona³³ janë dënuar me nga 5 muaj burg, dhjetë persona³⁴ janë dënuar me nga 6 muaj burg, katër persona³⁵ janë dënuar me nga 7 muaj burg, dy persona³⁶ janë dënuar me nga 8 muaj burg, dy persona

³³ Sqarim: Një nga pesë personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 5 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 200 euro

³⁴ Sqarim: Një nga dhjetë personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 400 euro

³⁵ Sqarim: Tre nga katër personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 7 muaj, janë të njëjtit të cilëve i'u është shqiptuar edhe dënimi me gjobë, dy prej tyre në vlerë prej nga 600 euro dhe të tretit dënimi në vlerë 400 euro.

³⁶ Sqarim: Një nga dy personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 8 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 600 euro

janë dënuar me nga 10 muaj burg, pesëmbëdhjetë persona³⁷ janë dënuar me nga 12 muaj burg, një person është dënuar me 14 muaj burg, një person është dënuar me 16 muaj burg, tre persona janë dënuar me nga 18 muaj burg, tre persona janë dënuar me nga 20 muaj burg, dy persona³⁸ janë dënuar me nga 24 muaj burg, një person është dënuar me 27 muaj burg, katër persona janë dënuar me nga 30 muaj burg, tre persona janë dënuar me nga 36 muaj burg dhe një person është dënuar me 84 muaj burg.

Gjykatësit ndaj 61 personave kanë shqiptuar dënime me kusht prej 710 muajve. Ndaj një personi³⁹ kanë marrë aktgjykim me dënim me kusht për 1 muaj, ndaj tre⁴⁰ personave dënim me kusht nga 2 muaj, ndaj tre personave⁴¹ dënim me kusht nga 3 muaj, ndaj një personi dënim me kusht për 4 muaj, ndaj trembëdhjetë personave⁴² dënim me kusht nga 6 muaj, ndaj pesë⁴³ personave dënim me kusht nga 8 muaj, ndaj dy personave dënim me kusht nga 10 muaj, ndaj shtatëmbëdhjetë⁴⁴ personave dënim me kusht nga 12 muaj, ndaj pesë personave dënim me kusht nga 18 muaj, ndaj tre personave dënim me kusht nga 22 muaj dhe ndaj tetë personave⁴⁵ dënim me kusht nga 24 muaj.

Gjykatësit ndaj 22 personave kanë shqiptuar dënime me gjobë në total prej 47,450 eurosh. Prej tyre, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 150 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 200 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 300 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 800 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 1000 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 1,500 euro, tre persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 2,000 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 2,400 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 2,500 euro, katër persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 3,000 euro, tre persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 3,600 euro dhe një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 5,000 euro.

Gjykatësit ndaj 115 personave kanë shqiptuar aktgjykim lirues, ndërsa ndaj 79 personave kanë shqiptuar aktgjykim refuzues. Ndërkaq, gjykatësit, ndaj 26 personave kanë hudhur aktakuzat.

³⁷ *Sqarim:* Nëntë nga pesëmbëdhjetë personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 12 muaj, janë të njëjtit të cilëve i'u është shqiptuar edhe dënimi me gjobë, për një prej tyre dënimi në vlerë prej 200 euro, për gjashtë prej tyre nga 1,000 euro, për një prej tyre dënimi në vlerë prej 1,500 euro, ndërsa të nëntit dënimi në vlerë prej 2,000 euro.

³⁸ *Sqarim:* Një nga dy personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 24 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 3,000 euro.

³⁹ *Sqarim:* Personi i dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 1 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 500 euro.

⁴⁰ *Sqarim:* Një nga tre personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 2 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 150 euro.

⁴¹ *Sqarim:* Një nga tre personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 3 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 300 euro.

⁴² *Sqarim:* Një nga trembëdhjetë personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 6 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 500 euro.

⁴³ *Sqarim:* Një nga pesë personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 8 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 2,000 euro.

⁴⁴ *Sqarim:* Tre nga shtatëmbëdhjetë personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 12 muaj, janë të njëjtit të cilëve i'u është shqiptuar edhe dënimi me gjobë, për dy prej tyre nga 200 euro, ndërsa të tretit dënimi në vlerë prej 700 euro.

⁴⁵ *Sqarim:* Dy nga tetë personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 24 muaj, janë të njëjtit të cilëve i'u është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 1,000 euro.

Nga 366 persona të akuzuar, Gjykatat rezultojnë se kanë dënuar me burg efektiv 63 persona apo 17.2 % të personave të akuzuar. Gjithashtu, nga këta 366 persona të akuzuar, gjykatësit ndaj 61 personave kanë shqiptuar dënime me kusht apo ndaj 16.7% të personave të akuzuar, ndaj 33 personave kanë shqiptuar dënime me gjobë apo ndaj 6% të personave të akuzuar, ndërsa janë liruar 220 persona apo 60.1% të personave të akuzuar.

Aktgjykimet e shpallura për korrupsion gjatë vitit 2017

Nga 343 persona të akuzuar për vepra penale korruptive, gjatë vitit 2017, gjykatat ndaj 172 personave kanë marrë aktgjykime që kanë liruar të akuzuarit nga përgjegjësia penale, apo në 50% të rasteve gjykatat nuk kanë gjetur se të akuzuarit kanë kryer veprat penale të korrupsionit apo kanë marrë aktgjykime refuzuese për shkak të parashkrimit.

Gjetjet e IKD-së, nga procesi i monitorimit të rasteve të korrupsionit, tregojnë se në rastet ndaj 343 personave ndaj të cilëve është marr aktgjykim gjatë vitit 2017, ndaj 56 personave kanë marr aktgjykim me dënim me burg, në total prej shtatëqindeshtatëdhjetë (773) muajve apo gjashtëdhjetëkatër (64) vite e pesë (5) muaj për të gjithë personat e dënuar.

Nga 56 personat e dënuar me burg, dy persona janë dënuar me nga 3 muaj burg efektiv, një person është dënuar me 4 muaj burg efektiv, tre persona⁴⁶ janë dënuar me nga 5 muaj burg efektiv, shtatëmbëdhjetë persona⁴⁷ janë dënuar me nga 6 muaj burg efektiv, katër persona⁴⁸ janë dënuar me nga 7 muaj burg efektiv, nëntë persona⁴⁹ janë dënuar me nga 8 muaj burg efektiv, një person është dënuar me 10 muaj burg, tetë persona⁵⁰ janë dënuar me nga 12 muaj burg efektiv, një person është dënuar me 18 muaj burg, një person është dënuar me 24⁵¹ muaj burg, një person është dënuar me 32⁵² muaj burg, dy persona⁵³ janë dënuar me nga 36 muaj burg efektiv, një person është dënuar me 38 muaj burg, tre persona⁵⁴ janë dënuar me nga 48

⁴⁶ *Sqarim:* Dy nga tre personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 5 muaj secili, janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë në shumën prej 800 euro në total.

⁴⁷ *Sqarim:* Nga 17 personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj secili, 3 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 2,700 euro.

⁴⁸ *Sqarim:* Nga 4 personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 7 muaj secili, 3 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 9,100 euro.

⁴⁹ *Sqarim:* Nga 9 personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 8 muaj secili, 5 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 13,500 euro.

⁵⁰ *Sqarim:* Nga 8 personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 12 muaj, 4 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 10,800 euro.

⁵¹ *Sqarim:* Personi i dënuar me burg në kohëzgjatje prej 24 muaj, është i njëjti i cili ka marrë edhe dënim me gjobë në total në vlerë prej 25,000 euro.

⁵² *Sqarim:* Personi i dënuar me burg në kohëzgjatje prej 32 muaj, është i njëjti i cili ka marrë edhe dënim me gjobë në total në vlerë prej 10,000 euro.

⁵³ *Sqarim:* Një nga dy personat e dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 36 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 1,000 euro.

⁵⁴ *Sqarim:* Tre personat e dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 48 muaj, janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 7,000 euro.

muaj burg, një person është dënuar me 54⁵⁵ muaj burg dhe një person është dënuar me 58 muaj burg.

Gjykatësit ndaj 72 personave kanë shqiptuar dënime me kusht prej 757 muajve. Prej tyre, një person⁵⁶ është dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 2 muaj, katër persona janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 3 muaj secili, katër persona janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 5 muaj secili, njëzetekatër persona⁵⁷ janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 6 muaj secili, dy persona janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 7 muaj secili, katër persona⁵⁸ janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 8 muaj secili, një person është dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 10 muaj, një person është dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 11 muaj, gjashtëmbëdhjetë persona⁵⁹ janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 12 muaj secili, një person është dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 14 muaj, pesë persona⁶⁰ janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 18 muaj secili, nëntë persona⁶¹ janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 24 muaj secili.

Gjykatësit ndaj 43 personave kanë shqiptuar dënime me gjobë në total prej 210,300 eurosh. Prej tyre, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 100 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 200 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 300 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 400 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 700 euro, katër persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 1,000 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 1,100 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 1,200 euro, tre persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 1,500 euro, shtatë persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 2,000 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 2,400 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 2,500 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 3,000 euro, katër persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 3,600 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 4,000 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 4,500 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 5,000 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 10,000 euro, gjashtë persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 20,000 euro.

Gjykatësit ndaj 114 personave kanë shqiptuar aktgjykim lirues, ndërsa ndaj 31 personave kanë shqiptuar aktgjykim refuzues. Ndërkaq, ndaj 27 personave kanë hudhur aktakuzat.

⁵⁵ *Sqarim:* Personi i dënuar me burg në kohëzgjatje prej 54 muaj, është i njëjti i cili ka marrë edhe dënim me gjobë në total në vlerë prej 500 euro.

⁵⁶ *Sqarim:* Personi i dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 2 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 150 euro.

⁵⁷ *Sqarim:* Nga 24 personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 6 muaj secili, 10 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marrë edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 16,215 euro.

⁵⁸ *Sqarim:* Nga 4 personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 8 muaj secili, 2 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marrë edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 800 euro.

⁵⁹ *Sqarim:* Nga 16 personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 12 muaj secili, 10 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marrë edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 28,400 euro.

⁶⁰ *Sqarim:* Nga 5 personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 18 muaj secili, një prej tyre është i njëjti i cili ka marrë edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 1,000 euro.

⁶¹ *Sqarim:* Nga 9 personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 24 muaj secili, dy prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marrë edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 8,000 euro.

Nga 343 persona të akuzuar, Gjykatat rezultojnë se kanë dënuar me burg efektiv 56 persona apo 16.3% të personave të akuzuar. Gjithashtu, nga këta 343 persona të akuzuar, gjykatësit ndaj 72 personave kanë shqiptuar dënime me kusht apo ndaj 21% të personave të akuzuar, ndaj 43 personave kanë shqiptuar dënime me gjobë apo ndaj 12.5% të personave të akuzuar, ndërsa janë liruar 172 persona apo 50.2% të personave të akuzuar.

Aktgjykimet e shpallura për korrupsion gjatë vitit 2018

Gjetjet e IKD-së, nga procesi i monitorimit të rasteve të korrupsionit, tregojnë se në rastet ndaj 287 personave ndaj të cilëve është marr aktgjykim në shkallë të parë, ndaj 57 personave kanë marr aktgjykim me dënim me burg, në total prej tetëqindëntëdhjetëetë (893) muajve apo shtatëdhjetëekatër (74) vjet e pesë (5) muaj për të gjithë personat e dënuar.

Nga 57 personat e dënuar me burg efektiv, një person është dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 5 muaj, shtatëmbëdhjetë persona⁶² janë dënuar me nga 6 muaj burg efektiv, dy persona⁶³ janë dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 8 muaj, gjashtë persona⁶⁴ janë dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 10 muaj, gjashtë persona⁶⁵ janë dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 12 muaj, gjashtë persona⁶⁶ janë dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 15 muaj, dy persona janë dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 18 muaj, shtatë persona⁶⁷ janë dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 24 muaj, një person⁶⁸ është dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 25 muaj, tre persona janë dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 30 muaj, një person⁶⁹ është dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 31 muaj, dy persona⁷⁰ janë dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 36 muaj secili, dy persona⁷¹ janë dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 42 muaj dhe një person është dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 54 muaj.

⁶² Sqarim: Nga 17 personat e dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 6 muaj secili, 7 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marrë edhe dënim me gjobë në total prej 5,500, ku pesë prej tyre janë dënuar edhe me nga 500 euro, një prej tyre është dënuar edhe me 1000 euro kurse një prej tyre është dënuar me 2000 euro.

⁶³ Sqarim: Një nga dy personat e dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 8 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 1,000 euro.

⁶⁴ Sqarim: Dhjetë personat e dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 10 muaj, janë të njëjtit të cilit janë dënuar edhe me gjobë në vlerë prej 1,000 euro secili.

⁶⁵ Sqarim: Nga 6 personat e dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 12 muaj secili, 3 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marrë edhe dënim me gjobë në total prej 3,500, ku dy persona janë dënuar edhe me nga 1000 euro kurse tjetri prej tyre është dënuar me 1500 euro.

⁶⁶ Sqarim: Gjashtë personat e dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 15 muaj, janë të njëjtit të cilit janë dënuar edhe me gjobë në vlerë prej 9300, ku njëri prej tyre është dënuar edhe me 300 euro gjobë, kurse pesë prej tyre edhe me nga 1500 euro gjobë.

⁶⁷ Sqarim: Një nga shtatë personat e dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 8 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 25,000 euro.

⁶⁸ Sqarim: Personi i dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 18 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 2500 euro.

⁶⁹ Sqarim: Personi i dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 31 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 3000 euro.

⁷⁰ Sqarim: Një nga dy personat e dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 36 muaj secili, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 7000 euro.

⁷¹ Sqarim: Një nga dy personat e dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 42 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 16,000 euro.

Gjykatësit ndaj 45 personave kanë shqiptuar dënime me kusht prej treqindetëdhjetë (382) muajve. Prej tyre, tre persona⁷² janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 3 muaj secili, katër persona janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 5 muaj secili, njëzet persona⁷³ janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 6 muaj secili, një person është dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 7 muaj, dy persona janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 8 muaj secili, një person është dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 10 muaj, njëmbëdhjetë persona⁷⁴ janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 12 muaj secili, një person⁷⁵ është dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 20 muaj dhe dy persona⁷⁶ janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 24 muaj secili.

Gjykatësit ndaj 33 personave kanë shqiptuar dënime me gjobë në total prej 131,680 eurosh. Prej tyre, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 150 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 200 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 300 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 350 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 500 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 800 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 1000 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 1500 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 1700 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 2000 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 2200 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 2800 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 2500 euro, katër persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 3000 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 3080 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 4000 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 5000 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 6800 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 7000 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 8600 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 10000 euro, tre persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 12000 euro dhe një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 13000 euro.

Gjykatësit ndaj 95 personave kanë shqiptuar aktgjykim lirues, ndaj 41 personave kanë shqiptuar aktgjykim refuzues, kurse për 16 persona është hudhur aktakuza.

Nga 287 persona të akuzuar, Gjykatat rezultojnë se kanë dënuar me burg efektiv 57 persona apo 19.8 % të personave të akuzuar. Gjithashtu, nga këta 287 persona të akuzuar, gjykatësit ndaj 45 personave kanë shqiptuar dënime me kusht apo ndaj 15.7% të personave të akuzuar,

⁷² Sqarim: Një nga tre personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 3 muaj secili, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 200 euro.

⁷³ Sqarim: Nga 20 personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 6 muaj secili, dy prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marrë edhe dënim me gjobë në total prej 5,500, ku njëri është dënuar edhe me 4000 euro kurse tjetri prej tyre është dënuar me 1500 euro.

⁷⁴ Sqarim: Nga 11 personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 12 muaj, 3 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marrë edhe dënim me gjobë në total prej 4,000, ku njëri është dënuar edhe me 2000 euro, njëri është dënuar edhe me 1500 euro kurse tjetri prej tyre është dënuar me 500 euro.


⁷⁵ Sqarim: Personi i dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 20 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 1000 euro.

⁷⁶ Sqarim: Një nga dy personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 24 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 500 euro.

ndaj 33 personave kanë shqiptuar dënime me gjobë apo ndaj 11.5% të personave të akuzuar, ndërsa janë liruar 152 persona apo 53% të personave të akuzuar.

c. Profili i personave të gjykuar për korrupsion nga gjykatat gjatë tri viteve (2016, 2017, 2018)

Në këto raste të korrupsionit në të cilat ka pasur shpallje të aktgjykimit, janë përfshirë të gjitha profilet e personave të akuzuar. Prej tyre, 442 persona i takojnë profilit të ulët, 516 persona profilit të mesëm dhe 38 persona i takojnë të profilit të lartë.



Grafika 9- Profili i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit, për të cilët është shpallur aktgjykim në Gjykata Themelore gjatë periudhës raportuese, të monitoruara nga IKD (2016, 2017, 2018)

Profili i lartë i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit ndaj të cilëve është shpallur aktgjykim gjatë periudhës (2016, 2017, 2018)	Numri i personave	Aktgjykim dënues	Aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Hudhje e aktakuzës
Kryeshef Ekzekutiv i PTK-së	3	0	1	0	2
Kryetar i OSHP-së	2	1	0	1 ⁷⁷	0
Kryetar Gjykatë	3	0	2	0	1 ⁷⁸
Kryeprokurore	1	0	0	0	1
Rektor	1	0	0	0	1
Ministër	4	1	1	0	2
Sekretar i përhershëm në Ministri	1	0	1	0	0
Deputet	1	1	0	0	0
Kryetar Komune	22	6	8	5	3
Totali i pozitive	38	9	13	6	10

Grafika 13 – Profili i lartë i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit, për të cilët është shpallur aktgjykim nga Gjykatat Themelore gjatë periudhës raportuese (2016, 2017, 2018)

⁷⁷ Në rastin e dytë, gjatë të njëjtit vit (2017), është marrë aktgjykim lirues ndaj kryetarit të OSHP-së.

⁷⁸ Në rastin e dytë, gjatë të njëjtit vit (2017), është marrë aktgjykim dënues ndaj kryetarit të gjykatës që akuzohej si Rektor i Universitetit.

d. Politika e dënimeve në rastet e profilit të lartë të korrupsionit në tri vitet e fundit

Prej 1 janarit 2016 deri më 31 dhjetor 2018, IKD ka analizuar të gjitha rastet e monitoruara të aktakuzave të ngritura për korrupsion ndaj profilit të lartë. Në këtë periudhë tri vjeçare, rezulton se në gjykata janë trajtuar 59 aktakuza ndaj 68 personave të profilit të lartë, të cilat janë ngritur më herët apo gjatë kësaj periudhe. Në mesin e tyre janë disa zyrtarë të akuzuar disa herë, përkatësisht janë 13 zyrtarë të lartë që janë akuzuar më shumë se njëherë.⁷⁹ Vlen të theksohet se vetëm ndaj Sasha Mirkoviç ish-Kryetar i Kllokotit janë ngritur 7 aktakuza.



Tabela 14 – Profilet e larta që kanë më shumë se një aktakuzë.

IKD ka gjetur se karakteristikë e profilit të lartë të akuzuar është se prej 68 zyrtarëve të akuzuar, vetëm 13 prej tyre janë akuzuar dhe po përballen me procedura gjyqësore derisa ende janë duke mbajtur pozitën, ndërsa 55 prej tyre janë akuzuar pasi e kanë përfunduar mandatin apo pasi kanë kaluar në “isha”.

⁷⁹ *Shënim:* IKD në bazë të monitorimit ka gjetur se janë disa zyrtarë të profilit të lartë, të cilët janë akuzuar disa herë. Prokuroria ka ngritur dy aktakuza ndaj Kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj; Prokuroria ka ngritur dy aktakuza ndaj ish-Kryetarit të Komunës së Parteshit, Dragan Nikoliç; Prokuroria ka ngritur dy aktakuza ndaj Kryetarit të Komunës së Novobërdës, Svetislav Ivanoviç; Prokuroria ka ngritur dy aktakuza ndaj ish-Kryetarit të Komunës së Drenasit, Nexhat Demaku; Prokuroria ka ngritur dy aktakuza ndaj ish-Kryetarit të Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa, Prokuroria ka ngritur dy aktakuza ndaj ish-Kryetarit të Komunës së Gjakovës, aktualisht Ministër i Infrastrukturës, Pal Lekaj, Prokuroria ka ngritur dy aktakuza ndaj ish-Kryetarit të Komunës së Lipjanit, Shukri Buja; Prokuroria ka ngritur shtatë aktakuza ndaj ish-Kryetarit të Komunës së Kllokotit, Sasha Mirkoviç; Prokuroria ka ngritur dy aktakuza ndaj ish-Ministrit të Kulturës, Astrit Haraqija; Prokuroria ka ngritur dy aktakuza ndaj ish-Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, njëherit ish-Rektorit të UP-së, Enver Hasani; Prokuroria ka ngritur dy aktakuza ndaj ish-Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë së Shëndetësisë, Ilir Tolaj, Prokuroria ka ngritur katër aktakuza ndaj ish-Kryetarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, Hysni Hoxha dhe Prokuroria ka ngritur dy aktakuza ndaj ish-Kryetarit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, tani të ndjerit Nuhi Uka.

Prej tyre 61 zyrtarë të profilit të lartë janë akuzuar për veprën penale të “keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe vepra të tjera të lidhura me të, ndërsa 4 prej tyre janë të akuzuar për “mashtimi në detyrë”, dy janë akuzuar për “konflikt të interesit” dhe një është akuzuar për “zbulim të fshehtësisë zyrtare”.

Vendimet e shkallës së parë/Gjykatat Themelore në Republikën e Kosovës

Në të gjitha rastet e aktakuzave të ngritura ndaj 68 zyrtarëve të profilit të lartë, Gjykatat Themelore si shkallë e parë për 9 zyrtarë të lartë kanë hudhur aktakuzat, për 16 zyrtarë kanë marrë aktgjykime liruese, për 5 zyrtarë kanë marrë aktgjykime refuzuese⁸⁰, ndërsa ndaj 11 zyrtarëve të profilit të lartë gjykatat kanë shqiptuar dënime. Ndaj 27 zyrtarëve të profilit të lartë ende janë duke vazhduar procedurat gjyqësore në shkallë të parë.

Vendimet e Gjykatave Themelore prej 1 janar 2016 deri më 31 dhjetor 2018



Tabela 15 – Vendimet e shkallës së parë për profilet e larta të akuzuara për korrupsion.

Ndërkaq, prej dënimeve të shqiptuara, ndaj 8⁸¹ zyrtarëve të lartë janë shqiptuar dënime me burgim me kusht, ndërsa ndaj një zyrtari është shqiptuar dënim me gjobë. Ndërsa vetëm dy dënime janë shqiptuar me burgim efektiv, të dyja nga tri vjet burgim efektiv, njëri ndaj ish-Kryetarit të OShP-së, Hysni Hoxha dhe tjetri ndaj ish-Kryetarit të Lipjanit, Shukri Buja.

Gjykata e Apelit në Prishtinë

Në të gjitha këto raste të aktgjykimeve të shpallura nga Gjykatat Themelore si shkallë e parë, në rastet e proceduara me ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë si shkallë e dytë, janë

⁸⁰ *Shënim:* Prej 68 zyrtarëve të profilit të lartë, rezulton se ndaj dy zyrtarëve, Gjykatat Themelore nuk kanë marrë aktgjykime, pasi në fazën fillestare në procesin e shqyrtimit të ankesave rreth konfirmimit apo hudhjes së aktakuzës të ngritura në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, kjo gjykatë ka vendosur të hudhë këto dy aktakuza. Fjala është për hudhjen e aktakuzave ndaj ish-Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani dhe Kryetarit të Mitrovicës, Agim Bahtiri.

⁸¹ *Shënim:* Gjykatat Themelore kanë shqiptuar shtatë aktgjykime me dënim me kusht, përfshi: Gjashtë muaj burgim me kusht për ish-Kryetarin e Komunës së Parteshit, Dragan Nikoliq; 12 muaj burgim me kusht për ish-Kryetarin e Komunës së Dragashit, Salim Jenuzi, rasti ndaj tij është kthyer në rigjykim, në të cilin gjykata e ka liruuar duke shqiptuar aktgjykim refuzues në tetor 2018; 12 muaj burgim me kusht për ish-Kryetarin e Komunës së Prizrenit, Ramadan Muja, 10 muaj burgim me kusht për ish-Kryetarin e Komunës së Klllokotit, Sreqko Spasiq; 12 muaj burgim me kusht për ish-Ministrin e Kulturës, Astrit Haraqija; 12 muaj burgim me kusht për ish-Ministrin e Kulturës, Valton Beqiri; 24 muaj burgim me kusht ndaj deputetit të Kuvendit të Kosovës, Etem Arif; 12 muaj burgim me kusht për ish-Rektorin e UP-së, Enver Hasani dhe 4.500 euro gjobë për ish-Kryetarin e Komunës së Novobërdës, Svetislav Ivanoviq.

gjithsej 31 raste të zyrtarëve të profilit të lartë, në të cilat kjo gjykatë ka marrë vendime, ndërsa janë 8 raste ndaj zyrtarëve, për të cilët ende vazhdojnë proceset.⁸²

Vendimet e Gjykatës së Apelit në Prishtinë prej 1 janar 2016 deri më 31 dhjetor 2018



Tabela 16 – Vendimet e shkallës së dytë për profilet e larta të akuzuara për korrupsion.

Prej 31 rasteve në të cilat ka vendosur Gjykata e Apelit në Prishtinë, rezulton se gjykatësit në tetë (8) raste kanë konfirmuar hudhjet e aktakuzave për të cilat kanë vendosur Gjykatat Themelore në shkallë të parë.

Gjykatësit e Apelit kanë shpallur katër (4) aktgjykime refuzuese. Prej tyre kanë vërtetuar tri (3) aktgjykime refuzuese të Gjykatave Themelore, ndërsa një aktgjykim dënues me dy vjet burgim me kusht ndaj ish-Ministrit të Kulturës Astrit Haraqija e kanë konvertuar në aktgjykim refuzues.

Gjykatësit e Apelit kanë kthyer në rigjykim, rastin ndaj ish-Kryetarit të Dragashit Salim Jenuzi, i cili në shkallë të parë ishte dënuar me 10 muaj burgim me kusht, i cili rast, në ndërkohë ka përfunduar sërish në shkallë të parë, por tani me aktgjykim refuzues, duke e liruar të akuzuarin për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit, për çka Prokuroria është detyruar të heq dorë nga ndjekja penale.

Gjykatësit e Apelit kanë shpallur 17 aktgjykime liruese, prej të cilave janë vërtetuar trembëdhjetë (13) aktgjykime liruese të Gjykatave Themelore, ndërsa kanë ndryshuar katër (4) aktgjykime dënuese të shkallës së parë, duke i konvertuar në aktgjykime liruese.

Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit ka liruar:

- Ish-Ministrin e Kulturës Valton Beqiri, i cili ishte dënuar në shkallë të parë me 1 vit burgim me kusht;

⁸² *Shënim:* IKD gjatë monitorimit ka gjetur se në këto 8 raste, Gjykatat Themelore kanë shqiptuar vendimet, ndërsa rastet gjenden me ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Rastet që janë ende në pritje në Apel janë: 1. Shukri Buja ish-Kryetar i Lipjanit (*i dënuar në shkallë të parë me tri vjet burgim efektiv*); 2. Sasha Mirković ish-Kryetar i Kllokotit (*rasti i parë i liruar në shkallë të parë*); 3. Fatmir Limaj ish-Ministër (*i liruar në shkallë të parë*); 4. Ilir Tolaj ish-Sekretar i Përhershëm MSh (*i liruar në shkallë të parë*); 5. Ramadan Muja ish-Kryetar (*i dënuar në shkallë të parë me një vjet burgim me kusht*), 6. Agron Mustafa ish-Kryeshef i PTK (*është hudhur aktakuza ndaj tij në shkallë të parë*), 7. Ejup Qerimi ish-Kryeshef i PTK (*është hudhur aktakuza ndaj tij në shkallë të parë*) dhe 8. Etem Arifi Deputet (*i dënuar me dy vjet burgim me kusht në shkallë të parë*).

- Ish-Kryetarin e Komunës së Parteshit Dragan Nikoliq, i cili ishte dënuar nga shkalla e parë me gjashtë (6) muaj burgim me kusht;
- Ish-Rektorin e UP-së Enver Hasani, i cili ishte dënuar nga shkalla e parë me 12 muaj burgim me kusht;
- Ish-Kryetarin e OShP-së Hysni Hoxha, i cili ishte dënuar nga shkalla e parë me tri (3) vite burgim efektiv.

I vetmi dënim i vërtetuar nga Gjykata e Apelit është dënimi me kusht prej 10 muajve i shqiptuar ndaj Sreqko Spasiqit ish-Kryetar i Kllokotit.

e. Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në rastet e korrupsionit

Dështimet në respektimin e afateve ligjore në trajtimin e rasteve të korrupsionit paraqiten në të gjitha hallkat e sistemit të drejtësisë, përfshi zvarritjet në polici, prokurori dhe gjykata.⁸³ Zvarritjet në zgjidhjen e rasteve ndikojnë drejtpërdrejt në shkeljen e të drejtave të qytetarëve të Republikës së Kosovës,⁸⁴ të cilat garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.⁸⁵

IKD përmes monitorimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit në prokurori dhe gjykata, përfshi të gjitha fazat e procedurës penale, paraqet gjendjen reale se sa kohë iu merr institucioneve përgjegjëse për trajtimin e një lënde të korrupsionit, prej kohës së inicimit të kallëzimit penal deri në shpalljen e aktgjykimit, si dhe vonesat dhe shkeljet e identifikuara gjatë trajtimit të rasteve.

Në tri vite IKD ka monitoruar rreth 4000 seanca gjyqësore të korrupsionit, ku në secilin vit janë përfshirë mesatarisht rreth 350 raste me rreth 1000 persona. IKD ka analizuar kohëzgjatjen e procedurave penale në këto raste të monitoruara dhe ka identifikuar shkelje të afateve ligjore në të gjitha fazat e procedurës penale. IKD ka vendosur disa indikatorë për të matur në secilën fazë të procedurës penale kohën e kaluar për trajtimin e rastit përfshi:

1) Kohën e trajtimit të kallëzimit penal deri në fillimin e hetimeve⁸⁶ 2) kohën e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në përfundimin e hetimeve; 3) kohën e trajtimit prej fillimit të

⁸³ *Shënim:* Të gjitha raportet e monitorimit sistematik të IKD në trajtimin e rasteve të korrupsionit në sistemin gjyqësor dhe prokurorial kanë identifikuar shkeljet e prokurorëve dhe gjykatësve në respektimin e afateve ligjore të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale. Shih raportet periodike në faqen e Institutit të Kosovës për Drejtësi në linkun vijues ëëë.kli-ks.org/publikime

⁸⁴ Në të gjitha raportet e Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës theksohet shkelja e vazhdueshme e të drejtave dhe lirive të qytetarëve nga sistemi i drejtësisë në vend. Shih raportet vjetore të Avokatit të Popullit. (Shih linkun <http://ëëë.ombudspersonkosovo.org>).

⁸⁵ Neni 31 “E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm”. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. 15 qershor 2008.

⁸⁶ Neni 82, “Hudhja e kallëzimit penal të policisë”. 1. Prokurori i shtetit me aktvendim e hudh kallëzimin penal të pranuar nga policia apo burime tjera brenda tridhjetë (30) ditëve, nëse nga raporti është e qartë se: 1.1. nuk ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer vepër penale; 1.2. ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale; 1.3. vepra penale është përfshirë me amnisti ose me falje; 1.4. i dyshuari gëzon imunitet dhe heqja e tij nuk është e mundur ose nuk është miratuar nga organi kompetent; ose 1.5. ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e përjashtojnë ndjekjen. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.

hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës⁸⁷; 4) kohën e trajtimit prej përfundimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës; 5) kohën e trajtimit prej ngritjes së kallëzimit penal deri në ngritjen e aktakuzës; 6) koha prej ngritjes së aktakuzës deri në caktimin e shqyrtimit fillestar⁸⁸; 7) koha prej shqyrtimit fillestar deri në caktimin e shqyrtimit të dytë⁸⁹; 8) koha prej shqyrtimit të dytë deri në caktimin e shqyrtimit kryesor; 9) numri i seancave të mbajtura dhe 10) koha e trajtimit prej caktimit të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë⁹⁰.

Bazuar në këta indikatorë, IKD ka bërë matjen e rasteve të monitoruara në tri vitet e fundit (2016, 2017, 2018). Gjetjet e IKD-së tregojnë se prokurorët dhe gjykatësit vazhdimisht shkelin afatet e përcaktuara ligjore në KPPRK-së. Në tabelën më poshtë, IKD ka paraqitur disa prej indikatorëve të fazave të caktuara të procedurës penale dhe mesataren e kohës së kaluar për secilën prej këtyre fazave si rezultat i monitorimit dhe hulumtimit praktik dhe analizës ligjore.⁹¹

⁸⁷ Neni 159, “Afatet kohore të hetimit”, 1. Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.

⁸⁸ Neni 242, “Procedura për ngritjen e aktakuzës”; Paragrafët 4 dhe 5; 4. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës. 5. Nëse i pandehuri është në mbajtje në paraburgim, shqyrtimi fillestar mbahet në mundësinë e parë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ngritjes së aktakuzës. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.

⁸⁹ Neni 245, “Shqyrtimi fillestar”, paragrafi 5. Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.

⁹⁰ Kapitulli XIX, SHQYRTIMI GJYQËSOR, Neni 285 Caktimi i shqyrtimit gjyqësor, paragrafi 2) 2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton fillimin e shqyrtimit gjyqësor brenda një (1) muaji nga shqyrtimi i dytë ose nga urdhri i fundit i lëshuar nga neni 254, paragrafi 5. i këtij Kodi. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.


Neni 314, “Koha për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor”; 1. Përveç në rastet kur gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues shtyn shqyrtimin gjyqësor nga neni 310 i këtij Kodi, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda këtyre afateve kohore: 1.1. nëse shqyrtimit gjyqësor mbahet para gjyqarit të vetëm gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda nëntëdhjetë (90) ditësh, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjërit prej arsyeve nga paragrafi 2. i këtij neni; 1.2. nëse shqyrtimit gjyqësor mbahet para trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda njëqindnjëzet (120) ditësh, përveç nëse trupi gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjërit prej arsyeve nga paragrafi 2. i këtij neni. 2. Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet me aktvendimin të arsyetuar nga paragrafi 1. i këtij neni kur ekzistojnë rrethana të cilat kërkojnë më shumë kohë, përfshirë por pa u kufizuar në: 2.1. numër të shumtë të dëshmitarëve; 2.2. dëshmia e një apo më shumë dëshmitarëve është shumë e gjatë; 2.3. numri i provave është jashtëzakonisht i madh; 2.4. siguria e shqyrtimit gjyqësor bën të nevojshme vazhdimin. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 3. Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet për tridhjetë (30) ditë për secilin aktvendim nga paragrafi 1. i këtij neni.

⁹¹ *Shënim:* Matjet e realizuara për secilin indikatorë në secilën fazë dallojnë për sa i përket numrit të rasteve. IKD ka bërë matjet dhe analizat vetëm për aq raste sa ka arritur të kompletoj të dhënat për secilën fazë të procedurës penale të vendosur në indikatorë.

Mesatarja e kohëzgjatjes së procedurave penale në rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD				
Disa prej fazave të procedurës penale	2016	2017	2018	Mesatarja
Parashtrimi i kallëzimit penal – Fillimi i hetimeve	288	254	227	256 ditë
Parashtrimi i kallëzimit penal - Ngritje e aktakuzës	407	395	449	417 ditë
Ngritje e aktakuzës – Shqyrtim fillestar	319	262	273	286 ditë
Ngritje e aktakuzës - Shpallja e aktgjykimit	691	681	778	716 ditë
Parashtrimi i kallëzimit penal – Shpallja e aktgjykimit	1072	993	1098	1054 ditë

Tabela 17 - Mesatarja e kohëzgjatjes së procedurave penale në rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD në tri vitet 2016, 2017, 2018.

Më poshtë është paraqitur edhe grafika e mesatares së kohëzgjatjes së trajtimit të rasteve të korrupsionit në secilën prej fazave të procedurës penale.



Grafika 10 - Mesatarja e kohëzgjatjes së procedurave penale në rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD në tri vitet 2016, 2017, 2018.

Siç mund të vërehet nga tabela më sipër, në secilën prej fazave të procedurës penale, prokurorët dhe gjykatësit kanë shkelur afatet ligjore, rrjedhimisht kanë shkelur të drejtat e të pandehurve në procedurë penale. Mesatarja e kohëzgjatjes së procedurave penale, sipas analizës së IKD-së, rezulton se në tri vitet 2016, 2017 dhe 2018 është afërsisht e njëjtë. Trajtimi i një rasti të korrupsionit prej momentit të paraqitjes së kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit ka zgjatur rreth tri vite apo 1054 ditë. Prej parashtrimit të kallëzimit penal deri në fillimin e hetimeve, mesatarja e kohëzgjatjes është 256 ditë. Prej parashtrimit të kallëzimit penal deri në ngritje të aktakuzës, mesatarja e kohëzgjatjes është 417 ditë. Prej ngritjes së aktakuzës deri në seancën e parë të shqyrtimit fillestar mesatarja e kohëzgjatjes së rasteve është 286 ditë. Prej ngritjes së aktakuzës deri në shpallje të aktgjykimit në shkallë të parë, mesatarja e kohëzgjatjes së rasteve është 716 ditë. Trajtimi i rasteve të korrupsionit, me këtë mesatare të afateve ligjore, dëshmon se prokurorët dhe gjykatësit, vazhdimisht shkelin ligjin dhe nuk i respektojnë politikat e sistemit prokurorial dhe gjyqësor për t’i trajtuar me

prioritet lëndët e korrupsionit. Rrjedhimisht, të pandehurit në procedurë penale në rastet e korrupsionit vazhdimisht i nënshtrohen shkeljeve të të drejtave për tu zgjidhur rastet e tyre në kohë të arsyeshme.

VII. Shkeljet ligjore të prokurorëve dhe gjykatësve në trajtimin e rasteve të korrupsionit

KPK dhe KGJK përmes politikave të miratuara i obligon prokuroritë dhe gjykatat që rastet e korrupsionit t'i trajtojnë me top-prioritet. Këto politika zbatohen në rastet e korrupsionit të nivelit të ulët, ndërsa kjo praktikë nuk gjen zbatim në rastet tjera kur janë të përfshirë profili i lartë i politikanëve apo njerëzve të fuqishëm që iu takojnë sferave të ndryshme të interesit.

IKD si rezultat i monitorimit sistematik të rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit ka identifikuar lëndë të caktuara, në të cilat prokuroritë dhe gjykatat shkelin afatet ligjore të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale si dhe politikat dhe strategjitë e KPK-së dhe KGJK-së lidhur me trajtimin e këtyre rasteve me prioritet.

Prokuroritë dhe Gjykatat pa asnjë bazë dhe arsytim të vetëm, përmes veprimeve të caktuara apo edhe mos veprimeve ndikojnë që rastet e korrupsionit të dështojnë të faza të caktuara të procedurës penale, qoftë përmes hartimit të aktakuzave jo-profesionale, përfaqësimit dhe mbrojtjes jo profesionale të aktakuzave, shtyrjes së seancave gjyqësore pa arsye, ku në shumë raste gjykatësit mbajnë qëndrim indiferent dhe nuk shfrytëzojnë masat që përcakton Kodi i Procedurës Penale për të siguruar praninë e të pandehurit, dëshmitarit apo personave të tjerë në seancat gjyqësore.

Gjetjet e IKD-së nga monitorimi i këtyre seancave gjyqësore, dëshmojnë së afërsisht 50% e seancave gjyqësore të shtyra në rastet e korrupsionit ndodhin për shkak të mungesës së prokurorit apo gjykatësit.

Në shtetet bashkëkohore, të cilat bazohen në vlerat e garantimit dhe promovimit të të drejtave të njeriut, kodet e procedurës penale janë garanci kundër zbatimit arbitrar të ligjeve penale. Ato janë të dizajnuara për të jetësuar të drejtën e personave të dyshuar dhe të pandehurve në raste penale për gjykim të drejtë, të paanshëm, të pavarur dhe në kohë të arsyeshme në të gjitha fazat e procedurës penale, duke filluar nga kontakti fillestar me policinë e duke vazhduar gjatë fazës së arrestit, hetimit, shqiptimit të dënimit dhe mjetit juridik. Shpërfillja e procedurave dhe trajtimit të rasteve në një afat të arsyeshëm kohor mund të rezultojë me shkelje të të drejtave për proces të drejtë të të pandehurve, të mbrojtura me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.

IKD më poshtë shkurtimisht do të shtjellojë katër rastet e profilit të lartë, në të cilat qoftë prokuroria apo gjykatat, apo edhe të dyjat në bashkëveprim shkelin afatet kohore të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale, shkeljes së procedurave gjyqësore, administrimit të dobët nga ana e gjykatësve të procedurës gjyqësore, etj.



Rasti Ukë Rugova: Ish-Deputet

Një ndër rastet e njohura të profilit të lartë, në të cilin IKD vlerëson se ka pasur neglizhencë, joprofesionalizëm dhe shkelje të të gjitha afateve ligjore për trajtimin e një procesi gjyqësor është **rasti Ukë Rugova** dhe të tjerët. **Aktvendimi për fillimin e hetimeve në këtë rast është marrë më 18 nëntor 2013.** Nga koha kur është marrë aktvendim për fillimin e hetimeve dhe deri më 31 dhjetor 2018, kanë kaluar **1868 ditë** dhe rasti është ende në fazë fillestare të procedurës gjyqësore. **Afati kohor** i përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale-nenit 242 pika 4 e KPPK-së, ku gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës është shkelur për më shumë se **500 ditë** nga ana e trupit gjykues. **Ndërrimi i trupit gjykues**-Kryetar i trupit gjykues fillimisht ka qenë Vitor Pardal, pastaj Vladimir Mikula⁹² dhe në fund gjyqtari Petko Petkov, kurse tash rasti ka kaluar tek vendorët⁹³ ku Kryetare e trupit gjykues është Naime Krasniqi – Jashanica.

Ndërrimi i prokurorëve: Prokuror i parë i rastit ka qenë Andrew Hughes, pastaj Allen Cansick kurse tani rasti ka kaluar tek prokurorja vendore Florije Salihu-Shamolli.

Gjatë vitit 2018 nuk ishte caktuar asnjë seancë tjetër lidhur me këtë rast, pasi sipas GTh në Prishtinë, kjo lëndë nuk hynte në grupin e lëndëve me prioritet.⁹⁴ Gjykimi ndaj Rugovës dhe të tjerëve ishte planifikuar të mbahet më 29 janar 2019, por kjo nuk u arrit të realizohej pasi në sallën e gjyqimit nuk u paraqitën katër nga të akuzuarit, çka bëri që të dështojë fillimi i shqyrtimit gjyqësor, ndërsa kryetarja e trupit gjykues Naime Krasniqi-Jashanica, e ka shtyrë gjykimin në kohë të pacaktuar.⁹⁵

⁹² *Ndërrohet gjyqtari, kthehet në fillim procesi ndaj Ukë Rugovës dhe të tjerëve*” Betimi për Drejtësi 29 nëntor 2016 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nderrohet-gjyqtari-kthehet-ne-fillim-procesi-ndaj-uke-rugoves-dhe-te-tjereve/>)

⁹³ *“Rasti i Ukës Rugovës dorëzohet te vendorët, caktimi i seancave në pritje të përgjigjes nga Supremja”*. Betimi për Drejtësi. 30 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-i-ukes-rugoves-dorezohet-te-vendorët-caktimi-i-seancave-ne-pritje-te-pergjigjes-nga-supremja/>)

⁹⁴ *“Gjykata nuk e ka prioritet gjykimin e Ukë Rugovës dhe të tjerëve, për rreth tetë muaj nuk caktohet asnjë seance”*. Betimi për Drejtësi. 12 qershor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-nuk-e-ka-prioritet-gjykimin-e-uke-rugoves-dhe-te-tjereve-per-rreth-tete-muaj-nuk-caktohet-asnje-seance/>)

⁹⁵ *“Mungojnë katër të akuzuar, dështon gjykimi ndaj Ukë Rugovës dhe të tjerëve”* Betimi për Drejtësi. 29 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungojne-kater-te-akuzuar-deshton-gjykimi-ndaj-uke-rugoves-dhe-te-tjereve/>)



Rasti tjetër reprezentativ i korrupsionit për shkelje ligjore dhe trajtim joprofesional është **rasti “Stenta 1”** ku i akuzuar është ish-Ministri i Shëndetësisë, Ferid Agani, i cili madje është rast i shënjestruar.

Më 15 qershor 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit kishte ngritur aktakuzë kundër ish-ministrit të Shëndetësisë, Ferid Agani dhe 63 personave të tjerë, për veprat penale korruptive. Karakteristikë e këtij rasti është ngritja e aktakuzës nga prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, në kundërshtim me ligjin dhe praktikën gjyqësore në Kosovë, gjetje kjo të cilën e ka ngritur IKD në raportet paraprake.⁹⁶

Deri më tani, katër prokurorë janë ndërruar me lëndën “Stenta”. Prokurori i shtetit që e ka përpiluar aktakuzën as nuk e përfaqëson dhe as nuk e mbron atë. Aktakuza është dorëzuar në muajin qershor 2016, por leximi i saj nuk ishte bërë një kohë meqë prokuroria nuk i kishte dorëzuar provat për të gjithë të pandehurit në gjuhën që ata e kuptojnë. Kjo kishte rezultuar në 5 seanca të shtyra. Më 26 shkurt 2018, kryetarja e trupit gjykues, Shadije Gërguri, për qëllim të efikasitetit të çështjes, kishte veçuar procedurën në tri pjesë. Që nga ajo kohë, Ferid Agani dhe Gani Shabani gjykohen veçmas si një rast.⁹⁷ Në rastin e Ferid Aganit dhe Gani Shabanit, aktakuza ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit dhe këto raste tanimë janë në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

⁹⁶ “Luftë, persekutim apo amnisti në emër të luftës kundër korrupsionit?”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Dhjetor 2017. (Shih linkun <http://kli-ks.org/lufte-persekutim-apo-amnisti-ne-emer-te-luftes-kunder-korrupsionit/>)

⁹⁷ “Pas veçimit të procedurës ndaj tyre, sërish deklarohen të pafajshëm ish-ministri Agani dhe ish-sekretari Shabani”. Betimi për Drejtësi. 26 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtësi.com/pas-vecimit-te-procedures-ndaj-tyre-serish-deklarohen-te-pafajshem-ish-ministri-agani-dhe-ish-sekretari-shabani/>)



Rasti Emrush Thaçi dhe të tjerët

Rast tjetër representativ i shkeljeve të afateve ligjore, politikave dhe strategjive të miratuara nga sistemi prokurorial dhe gjyqësor në trajtimin e lëndëve të korrupsionit me prioritet është **rasti Emrush Thaçi**, ish- Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe 23 persona të tjerë.

Edhe pse aktakuza është ngritur më 17 nëntor 2016, shqyrtimi fillestar për këtë rast ishte caktuar tek më 25 shtator 2017, apo 10 muaj pas ngritjes së aktakuzës, por kjo seancë kishte dështuar, ashtu siç kishte dështuar të mbahet edhe më 7 dhe 24 nëntor 2017, për shkak të mungesës së vazhdueshme të të akuzuarve në seanca. Përfundimisht, më 6 dhjetor 2017, kishte arritur të mbahet shqyrtimi fillestar, ku të gjithë të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm për akuzat me të cilat ngarkohen.⁹⁸ Ky shqyrtim fillestar ishte mbajtur mbi një vit pas afatit të përcaktuar në KPPK për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

Shqyrtim i dytë në këtë rast, ishte mbajtur më 2 shkurt 2018, duke shkelur prapë afatin e paraparë me nenin 245, paragrafi 5 i KPPK-së. Aktakuza ndaj Emrush Thaçit, Sami Lushtakut dhe të tjerëve, ishte konfirmuar nga ana e Gjykatës Themelore në Prishtinë në prill të vitit 2018, si dhe nga Apeli në korrik të po të njëjtit vit.⁹⁹ Mirëpo edhe pas kësaj, gjykatësi akoma nuk ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor.

⁹⁸ “Sami Lushtaku deklarohet i pafajshëm për arratisjen e tij nga QKUK-ja, thotë se nuk i beson drejtësisë së EULEX-it”. Betimi për Drejtësi. 6 dhjetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/sami-lushtaku-deklarohet-i-pafajshem-per-arratisjen-e-tij-nga-qkuk-ja-thote-se-nuk-i-beson-drejtetise-se-eulex-it/>)

⁹⁹ “Apeli vërteton aktakuzën në rastin e arratisjes së Sami Lushtakut nga QKUK-ja.” Betimi për Drejtësi. 3 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-aktakuzen-ne-rastin-e-arratisjes-se-sami-lushtakut-nga-qkuk-ja/>)



Rasti Sokol Bashota dhe të tjerët

Rasti ish-Kryetarit të Komunës së Klinës **Sokol Bashota**, hyn në kuadër të rasteve të pashënjestuara, që ndërlidhet me veprat penale korruptive sipas aktakuzës së paraqitur nga PTh në Pejë.

Më 25 nëntor 2013, AKK kishte parashtruar informatë lidhur me dyshimet për keqpërdorim në Komunën e Klinës. Më 24 shkurt 2014, Prokuroria kishte marr aktvendim për fillim të hetimeve, kurse më 4 gusht 2016, prokurori i EULEX-it kishte ngritur aktakuzë kundër Sokol Bashotës, Kryetar i Klinës dhe tre të tjerëve. Që nga koha kur është marr aktvendimi për fillimin e hetimeve në këtë rast kanë kaluar më shumë **se 1800 ditë**, dhe ky rast është ende në shqyrtim gjyqësor.

Shqyrtimi fillestar lidhur me këtë rast ishte caktuar në GjTh në Pejë vetëm më 12 dhjetor 2016, apo më shumë se tre muaj pas afatit 30 ditor të përcaktuar me KPPK. Shqyrtimi i dytë ishte caktuar më 23 janar 2017, por ishte shtyrë për arsye se prokurorja Valeria Bolici, kishte deklaruar në seancë gjyqësore se nuk ka pranuar asnjë shkresë tjetër lidhur me kundërshtimet e provave të paraqitura nga palët, përveç ato të të akuzuarit Bashota.¹⁰⁰ Më 31 mars 2017, gjykimi ndaj Bashotës dhe të tjerëve kishte filluar sërish prej fillimit për shkak të ndryshimit dhe zgjerimit të akuzës që ishte bërë nga prokurorja speciale, Valeria Bolici.¹⁰¹

Shqyrtim i dytë në këtë rast ishte mbajtur tre muaj më vonë, më 30 qershor 2017, duke shkelur prapë afatin e paraparë me nenin 245, paragrafi 5 i KPPK-së. Më 30 nëntor 2017, gjykata e shkallës së parë kishte refuzuar kërkesat për hudhje të aktakuzës nga të akuzuarit, por, pas ankesave të mbrojtësve të të akuzuarve, Gjykata e Apelit, në mars 2018, e kishte kthyer lëndën në rivendosje.¹⁰²

¹⁰⁰ “Prokurorja nuk i ka pranuar të gjitha shkresat për kundërshtimin e provave, shtyhet shqyrtimi i dytë në rastin e kryetarit të Klinës dhe tre të akuzuarve tjerë”. Betimi për Drejtësi. 23 janar 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurorja-nuk-i-ka-pranuar-te-gjitha-shkresat-per-kundershtimin-e-provave-shtyhet-shqyrtimi-i-dyte-ne-rastin-e-kryetarit-te-klines-dhe-tre-te-akuzuarve-tjere/>)

¹⁰¹ “Nis prej fillimi gjykimi ndaj kryetarit të Klinës, Sokol Bashot”. Betimi për Drejtësi. 31 mars 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nis-prej-fillimi-gjykimi-ndaj-kryetarit-te-klines-sokol-bashota/>)

¹⁰² “Apeli e kthen në rivendosje rastin ndaj ish-kryetarit të Klinës, Sokol Bashota”. Betimi për Drejtësi. 10 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rivendosje-rastin-ndaj-ish-kryetarit-te-klines-sokol-bashota/>)

Edhe pas kthimit të lëndës në rivendosje, gjykata e shkallës së parë, më 19 prill 2018 kishte vendosur njëjtë si herën e parë, duke refuzuar sërish kërkesat e të akuzuarve për hudhje të aktakuzës. Ky vendim i shkallës së parë, ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, në maj 2018.¹⁰³

Pas konfirmimit të aktakuzës e deri në fund të muajit tetor 2018, në këtë rast janë caktuar gjashtë seanca gjyqësore, prej të cilave, tri kanë dështuar të mbahen. Në seancën e 3 dhjetorit 2018, gjykata kishte vendosur që të bëhet një ekspertizë financiare për të përcaktuar lartësinë e çmimit të banesave të cilat janë objekt i aktakuzës,¹⁰⁴ ndërsa nga ajo kohë akoma nuk është caktuar ndonjë seancë tjetër gjyqësore.





























¹⁰³ “Apeli konfirmon aktakuzën ndaj ish-kryetarit të Klinës, Sokol Bashota dhe të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 30 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-konfirmon-aktakuzen-ndaj-ish-kryetarit-te-klines-sokol-bashota-dhe-te-tjereve/>)

¹⁰⁴ “Caktohet ekspertizë financiare në gjykimin ndaj Sokol Bashotës dhe të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 3 dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/caktohet-ekspertize-financiare-ne-gjykimin-ndaj-sokol-bashotes-dhe-te-tjereve/>)

VIII. Performanca e prokurorëve dhe gjykatësve në trajtimin e korrupsionit të profilit në lartë

IKD në vazhdim paraqet performancën e sistemit prokurorial dhe gjyqësor në trajtimin e rasteve të aktakuzave të ngritura ndaj profilit të lartë të korrupsionit. Grafika në vazhdim paraqet të dhënat për secilin prokurorë që ka ngritur dhe përfaqësuar aktakuzat e profilit të lartë si dhe vendimet e secilit gjykatës të shkallës së parë dhe shkallës së dytë rreth këtyre aktakuzave.

I akuzuar i profilit të lartë	Prokurori përpilues i aktakuzës	Prokurori përfaqësues i aktakuzës	Gjykatësi i rastit në shkallë të parë	Vendimi i shkallës së parë	Gjykatësi i rastit në shkallë të dytë	Vendimi i shkallës së dytë
 Muharrem Shabani	 Shyqyri Sylta	 Ismet Ujkani	 Burim Ademi		 Fillim Skoro	
 Ragip Begaj	 Haki Gecaj	 Haki Gecaj	 Artan Sejrani		 Fillim Skoro	
 Ragip Begaj	 Abdurrahim Islami	 Abdurrahim Islami	 Gëzim Pozhegu		 Fillim Skoro	
 Dragan Nikoliq	 Shaban Spahiu	 Shaban Spahiu	 Naser Maliqi		 Fillim Skoro	
 Dragan Nikoliq	 Shaban Spahiu	 Shaban Spahiu	 Agim Ademi		 Xhevdet Abazi	
 Lutfi Haziri	 Ali Rexha	 Ali Rexha	 Afrim Shala		 Xhevdet Abazi	
 Nexhat Demaku	 Feti Tunuzliu	 Feti Tunuzliu	 Valbona Mustiu		 Mejreme Memaj	
 Mehmet Krasniqi	 Agron Bajrami	 Agron Bajrami	 Afërdita Bytyçi		 Driton Muharremi	
 Agim Bahtiri	 Agron Bajrami	 Agron Bajrami	 Beqir Halili		 Mejreme Memaj	

I akuzuar i profilit të lartë	Prokurori përpilues i aktakuzës	Prokurori përfaqësues i aktakuzës	Gjykatësi i rastit në shkallë të parë	Vendimi i shkallës së parë	Gjykatësi i rastit në shkallë të dytë	Vendimi i shkallës së dytë
 Salim Jenuzi	 Sefer Morina	 Genc Nixha	 Ajser Skenderi	REFUZIM	 Driton Muharremi	E PËRFUNDUAR PA ANKESË
 Sreqko Spasiq	 Shaban Spahiu	 Shaban Spahiu	 Afrim Shala	DËNIM 10 MUAJ BURG ME KUSHT	 Fillim Skoro	DËNIM 10 MUAJ BURG ME KUSHT
 Sreqko Spasiq	 Aqron Uka	 Aqron Uka	 Aziz Shaqiri	LIRIM	 Fillim Skoro	LIRIM
 Gemaji Mustafa	 Shaban Spahiu	 Shaban Spahiu	 Naser Maliqi	REFUZIM		E PËRFUNDUAR PA ANKESË
 Pal Lekaj	 Sylë Hoxha	 Faik Halili	 Gëzim Pozhegu	HUDHJE	 Xhevdet Abazi	HUDHJE
 Shukri Buja	 Agron Bajrami	 Agron Bajrami	 Beqir Kalludra	DËNIM 36 MUAJ BURGIM EFEKTIV		NË PROCES
 Sasha Mirkoviq	 Shaban Spahiu	 Shaban Spahiu	 Agim Ademi	REFUZIM		E PËRFUNDUAR PA ANKESË
 Sasha Mirkoviq	 Shaban Spahiu	 Shaban Spahiu	 Naser Maliqi	LIRIM	 Tonka Berishaj	LIRIM
 Sasha Mirkoviq	 Arben Ismajli	 Arben Ismajli	 Agim Ademi	LIRIM		NË PROCES

I akuzuar i profilit të lartë	Prokurori përpilues i aktakuzës	Prokurori përfaqësues i aktakuzës	Gjykatësi i rastit në shkallë të parë	Vendimi i shkallës së parë	Gjykatësi i rastit në shkallë të dytë	Vendimi i shkallës së dytë
 Sasha Mirkoviq	 Afrim Shefkiu	 Afrim Shefkiu	 Zyhdi Haziri		 Abdullah Ahmeti	
 Sasha Mirkoviq	 Shaban Spahiu	 Shaban Spahiu	 Agim Ademi		 Abdullah Ahmeti	
 Svetislav Ivanoviq	 Rabije Jakupi	 Rabije Jakupi	 Emine Salihu			
 Fatmir Limaj	 Charles Hardaway	 Charles Hardaway	 Marie Tuma		 Mejreme Memaj	
 Ramë Buja	 Ali Rexha	 Ali Rexha	 Valon Kurtaj		 Fillim Skoro	
 Astrit Haraqija	 Drita Hajdari	 Hivzi Bajraktari	 Suzana Çerkini		 Fillim Skoro	
 Valton Beqiri	 Drita Hajdari	 Hivzi Bajraktari	 Suzana Çerkini		 Fillim Skoro	
 Dalibor Jevtiq	 Sylë Hoxha	 Sylë Hoxha	 Valon Kurtaj		 Mejreme Memaj	
 Valdrin Lluka	 Habibe Salih	 Habibe Salih	 Hamdi Ibrahim		 Fillim Skoro	

I akuzuar i profilit të lartë	Prokurori përpilues i aktakuzës	Prokurori përfaqësues i aktakuzës	Gjykatësi i rastit në shkallë të parë	Vendimi i shkallës së parë	Gjykatësi i rastit në shkallë të dytë	Vendimi i shkallës së dytë
 Etem Arifaj	 Drita Hajdari	 Drita Hajdari	 Veseli Ismaili	DËNIM 24 MUAJ BURG ME KUSHT		NË PROCES
 Salih Mekaj	 Drita Hajdari	 Drita Hajdari	 Shasivar Hoti	LIRIM	 Driton Muharremi	LIRIM
 Enver Hasani	 Drita Hajdari	 Drita Hajdari	 Arben Hoti	DËNIM 12 MUAJ BURG ME KUSHT	 Mejreme Memaj	LIRIM
 Mazllum Baraliju	 Sefer Morina	 Sefer Morina	 Skender Çoçaj	LIRIM	 Mejreme Memaj	LIRIM
 Shpresa Bakija	 Agron Uka	 Agron Uka	 Afrim Shala	LIRIM	 Abdullah Ahmeti	LIRIM
 Ilir Tolaj	 Admir Shala	 Floriqe Shamolli	 Valbona Mustiu	LIRIM		NË PROCES
 Shyqeri Haxha	 Fikrije Fejzullahu	 Fikrije Fejzullahu	 Valbona Musliu	LIRIM	 Vahid Halili	LIRIM
 Hysni Hoxha	 Haki Gecaj	 Haki Gecaj	 Beqir Kalludra	DËNIM 36 MUAJ BURGIM EFEKTIV	 Driton Muharremi	LIRIM
 Hysni Hoxha	 Admir Shala	 Sylë Hoxha	 Arben Hoti	LIRIM	 Xhevdet Abazi	LIRIM









































I akuzuar i profilit të lartë	Prokurori përpilues i aktakuzës	Prokurori përfaqësues i aktakuzës	Gjykatësi i rastit në shkallë të parë	Vendimi i shkallës së parë	Gjykatësi i rastit në shkallë të dytë	Vendimi i shkallës së dytë
 Hysni Hoxha	 Tomas Meskauskas	 Paul Flynn	 Shasivar Hoti		 Abdullah Ahmeti	
 Nuhi Uka	 Danilo Cicareli	 Danilo Cicareli	 Arcadius Sedeck		 Fillim Skoro	
 Shaban Buza	 Agron Matjani	 Ali Uka	 Nikolë Komani		 Mejreme Memaj	
 Agron Mustafa	 Abdurrahim Islami	 Naim Abazi  Florije Salihu 	 Lutfi Shala			
 Ejup Qerimi	 Abdurrahim Islami	 Naim Abazi  Florije Salihu 	 Lutfi Shala			
 Ramadan Muja	 Natasha Vicary	 Fikrije Fejzullahu	 Agim Ademi			


Tabela 18 – Vendimet e shkallës së parë dhe të dytë për aktakuzat e ngritura për profilin e lartë në tri vitet e fundit.




Ngjyra e kuqe tregon dështimin e aktakuzave që përfshinë: hudhje, refuzim, lirim të akuzuarëve dhe rastet e përfunduara pa ankesa



Ngjyra e verdhë tregon dënimet e shqiptuara që përfshinë: dënimet me burgim me kusht dhe dënimet me gjobë;



Ngjyra e gjelbër tregon dënimet e shqiptuara me burgim efektiv;



Ngjyra e portokalltë tregon dënimet e shqiptuara me burgim efektiv;



Pa ngjyrë tregon rastet në procedurë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë;

IX. Konfiskimi i pasurisë prej veprave penale të korrupsionit

IKD gjatë kësaj periudhe ka monitoruar aktivitetet e prokurorëve dhe gjykatësve në zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale të korrupsionit. Nga të gjitha rastet e korrupsionit të monitoruara gjatë këtyre tri viteve, në të gjitha Gjykatat Themelore, IKD ka gjetur se prokurorët në raste shumë të rralla zbatojnë në praktikë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me kërkesat për sekuestrim apo konfiskim ndaj kryesve të veprave penale të korrupsionit.

IKD ka identifikuar 69 raste të korrupsionit, në të cilat janë paraqitur kërkesa për sekuestrim apo konfiskim të aseteve, gjë që dëshmon për një numër të kufizuar të rasteve kur prokurorët kanë paraqitur kërkesa të tilla.

Sfidë vazhdon të mbetet qasja e sistemit prokurorial dhe gjyqësor në raport me të dhënat e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë që përfitohet nga veprat penale të korrupsionit. KKLKE nuk ka bazë të të dhënave të profilizuara për veprat e caktuara penale. IKD vazhdimisht ka kërkuar që kjo bazë e të dhënave të veçohet, kërkesë kjo që është bërë ndaj KKLKE-së edhe nga KPK. Për më tepër, shih në fund të këtij raporti tabelën në aneksin 2 për të gjitha rastet e monitoruara në të cilat ka pasur sekuestrim dhe konfiskim për vepra penale të korrupsionit.¹⁰⁵

X. Gjetjet e veçanta të IKD-së në monitorimin tre vjeçar të rasteve gjyqësore të korrupsionit

Si rezultat i monitorimit dhe hulumtimit sistematik në trajtimin e rasteve të korrupsionit, IKD ka identifikuar probleme të shumta të natyrës subjektive dhe ndërhyrjeve nga brenda dhe jashtë sistemit të drejtësisë, sidomos prej politikës në punën e prokurorëve dhe gjykatësve në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Në këtë drejtim, në vazhdim do të shtjellohen disa prej problemeve të ngritura nga IKD në këto tri vite që ndërlidhen me pavarësinë, paanshmërinë dhe profesionalizmin në trajtimin e rasteve të korrupsionit.

a. Lufta e Këshillave për shfaqësim në publik rreth dështimeve në luftimin e korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit vazhdon të mbetet prioriteti më i lartë shtetëror, përfshi këtu KGJK-në dhe KPK-në, të cilat kanë përgatitur strategji e plane veprimi¹⁰⁶ për trajtimin e lëndëve të korrupsionit me prioritet absolut. Pavarësisht kornizës ligjore të avancuar që ka Kosova si dhe miratimit të politikave në luftimin e korrupsionit, rezultatet në praktikë, dëshmojnë se profili i lartë i korrupsionit vazhdon të amnistohet, duke mos arritur ende të

¹⁰⁵ *Shënim:* Në fund të këtij raporti gjeni të bashkangjitur tabelën në aneksin 2 për të gjitha të dhënat e sekuestrimit/konfiskimit në rastet e monitoruara të korrupsionit nga IKD.

¹⁰⁶ *Shënim:* IKD prej vitit 2013, si rezultat i monitorimit sistematik të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në trajtimin e rasteve të korrupsionit, ka ofruar gjetje, vlerësime dhe rekomandime konkrete si dhe ndihmuar të dy Këshillat në hartimin e Planeve të Veprimit për trajtimin me prioritet absolut të lëndëve të korrupsionit.

shpallet asnjë aktgjykim përfundimtar me dënim burgim efektiv. Në këtë drejtim, gjatë këtyre viteve, ka pasur procedura hetimore, aktakuza të ngritura dhe procedura gjyqësore që janë zhvilluar për raste të korrupsionit, përfshi edhe ndaj profilit të lartë. Ndaj këtij të fundit, të gjitha rastet deri më tash kanë dështuar. Për dështimin e këtyre rasteve, ka pasur akuza të ndërsjella të gjyqësorit dhe prokurorisë, se kush prej tyre bartin fajin për amnistinë që ju bëhet profilit të lartë të korrupsionit. Në vazhdim janë ngritur disa prej çështjeve problematike të luftës së dy Këshillave për ta hedhur topin tel pala tjetër për dështimet në luftimin e korrupsionit.

1. Konflikti KGJK-KPK lidhur me dështimet në luftimin e korrupsionit

Gjatë vitit 2018, të dy këshillat kanë hedhur akuza të ndërsjella lidhur me dështimin e sistemit të drejtësisë në luftimin e korrupsionit. Më konkretisht, në atë se kush është fajtor lidhur me dështimin e aktakuzave të profilit të lartë. Lidhur me këtë çështje, vetë Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, dhe Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Shqipdon Fazliu, kanë qenë subjekt i hetimit nga ZPD. Kjo e fundit, brenda një afati shumë të shkurtë kohor kishte mbyllur hetimet në këto raste.

Para se konflikti të fillonte sa i përket aktakuzave të dështuara të korrupsionit ndaj profilit të lartë, ishte kryesuesi i KGJK-së, Nehat Idrizi, ai që në takimin e mbajtur më 1 mars 2018 deklaroi se prokurorët po na e lënë “pataten e nxehtë” në duar. Idrizi këtë deklaram e dha teksa po shqyrtoj raportin vjetor i punës së Gjykatës Themelore në Gjakovë. Në këtë raport, figuronin se disa lëndë ishin parashkruar. Por, sipas nënkryetarit të kësaj Gjykate, Nikollë Komani, kjo ka ardhur për arsye se ishte vetë prokuroria ajo që i kishte ngritur aktakuzat e parashkruara, ndërsa Gjykata prej nga ai vjenë vetëm se kishte nxjerrë aktvendim për parashkrim relativ të lëndës, pasi të njëjtat ishin parashkruar në prokurori. Idrizi tutje tha se nëse gjykatat janë fajtoresh duhet ta pranojnë fajin, në të kundërtën ti thuhet prokurorisë se për këto raste faji është tek ju¹⁰⁷.

Por, konflikti u intensifikua në takimin e mbajtur më 30 maj 2018 në KPK, në të cilin Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, i kishte bërë fajtoresh gjykatat që nuk po kalojnë aktakuzat që përfshijnë njerëz të rëndësishëm, të cilët akuzohen për vepra penale të korrupsionit. Gjatë raportimit të tij, Kryeprokurori Lumezi, deklaroi se sa i përket rasteve të korrupsionit që nuk kalojnë në gjykata, sipas tij, po ndodh vetëm kur bëhet fjalë për emra të rëndësishëm.

“Nuk është e vërtetë ajo që raportohet në media se shumica e aktakuzave tona hudhen në Gjykatë. Në 89.15 % të rasteve këto aktakuza kalojnë në Gjykatë dhe të njëjtat marrin aktgjykime dënuese. Mirëpo, kjo situatë nuk është kështu edhe në rastet e korrupsionit. Por, kjo është një pikëpyetje e madhe. Pse njerëzit të cilët nuk kanë emër dhe mbiemër dënohen nga Gjykata dhe aktakuzat konfirmohen. Ndërsa ato aktakuza ku janë të përfshirë njerëzit e rëndësishëm me emra dhe mbiemër, ato nuk kalojnë në Gjykatë. Mirëpo, ne nuk i

¹⁰⁷ “Kryesuesi i KGJK-së: Prokurorët po na e lënë në dorë “pataten e nxehtë”. Betimi për Drejtësi. 01 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryesuesi-i-kgjk-se-prokuroret-po-na-e-lene-ne-dore-pataten-e-nxehte/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

komentojmë vendimet gjyqësore edhe atëherë kur nuk pajtohemi me to, pos në rastet kur ushtrojmë mjetet juridike”, ka thënë Kryeprokurori Lumezi¹⁰⁸.

Po ashtu, KKLKE Shqipdon Fazliu, në emisionin “Click” në RTV21, në të njëjtën ditë ka deklaruar se Prokurorit të Shtetit i hudhen aktakuzat vetëm kur bëhet fjalë për persona të cilët janë të profilit të lartë.

Lidhur me këto deklarata, KGJK 5 ditë më vonë, më 4 qershor 2018, mbajti takim të jashtëzakonshëm, në të cilin deklaratat e Prokurorit të Shtetit i quajti ndërhyrje në sistemin gjyqësor. Kryesuesi i KGJK-së, Nehat Idrizi, dhe Kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, këto deklarata i quajtën si ndërhyrje në punën e tyre, përderisa kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, tha se Prokurori i Shtetit dështimet e veta po mundohet të i’ a atribuojë gjyqësorit¹⁰⁹.

ZPD me 4 qershor në një përgjigje për “Betimi për Drejtësi” kishte thënë se nuk është e informuar lidhur me këto akuza dhe kundërakuza¹¹⁰. Por, 4 ditë më vonë, ZPD përmes postës elektronike kishte njoftuar IKD-në se hetimi disiplinor ndaj Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, dhe Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Shqipdon Fazliu, është mbyllur.

“Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD), sipas detyrës zyrtare i ka vlerësuar pretendimet e ngritura nga “Betimi për Drejtësi” ku pretendohet se, Kryeprokurori Aleksandër Lumezi, në mbledhjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), të mbajtur me datë 30 maj 2018, “i ka bërë fajtores gjykatat që nuk po kalojnë aktakuzat që përfshijnë njerëz të rëndësishëm, të cilët akuzohen për vepra penale të korrupsionit”. Po ashtu, ZPD i ka vlerësuar edhe pretendimet se, KKLKE Shqipdon Fazliu, në Emisionin “Click”, ka deklaruar se: “Prokurorit të Shtetit i hudhen aktakuzat vetëm kur bëhet fjalë për persona të cilët janë të profilit të lartë”. Lidhur me pretendimet e lartcekura për Kryeprokurorin e Shtetit Aleksandër Lumezi, ZPD ka gjet se, diskutimi i tij në mbledhjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës të datës 30 maj 2018, ka qenë në cilësinë e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Meqenëse, diskutimi i tij ka qenë në cilësinë e anëtarit të Këshillit Prokurorial, ZPD nuk ka mandat ligjor të hetoj pretendimet e ngritura për sjellje të mundshme të pahijshme në rastit konkret. Ndërsa, sa i përket pretendimeve të lartcekura për Koordinatorin Kombëtarë për Luftimin e Krimit Ekonomik Shqipdon Fazliu, ZPD ka gjetur se, Prokurori Fazliu në emision nuk ka përmendur emrat e gjykatësve të cilët kanë vendosur rastet, nuk ka përmendur hierarkinë dhe emrin e gjykatës por, thjeshtë ka shprehur mendim profesional në lidhje me një çështje të

¹⁰⁸ “Kryeprokurori Lumezi thotë se gjykatat po i hedhin poshtë aktakuzat kur bëhet fjalë për njerëz të rëndësishëm”. Betimi për Drejtësi. 30 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryeprokurori-lumezi-thote-se-gjykatat-po-i-hedhin-poshte-aktakuzat-kur-behet-fjale-per-njerez-te-rendesishem/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹⁰⁹ “Deklaratat e Prokurorit të Shtetit për hudhje të aktakuzave të korrupsionit, krerët e gjyqësorit i quajnë ndërhyrje në këtë sistem (Video)”. Betimi për Drejtësi. 04 qershor 2018. Betimi <https://betimiperdrejtesi.com/deklaratat-e-prokurorit-te-shtetit-per-hudhje-te-aktakuzave-te-korrupsionit-kreret-e-gjyqesorit-i-quajne-nderhyrje-ne-kete-sistem/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹¹⁰ “Prokuroria e Shtetit dhe KGJK në “luftë”, ZPD thotë se s’ka informacion se çfarë po ndodhë”. Betimi për Drejtësi. 04 qershor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-e-shtetit-dhe-kgjk-ne-lufte-zpd-thote-se-ska-informacion-se-cfare-po-ndodhe/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

rëndësishme për sundimin e rendit dhe ligjit në Kosovë. Në mbështetje të nenit 35 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, ZPD i ka vlerësuar pretendimet e ngritura në lidhje me këtë çështje por, tani për tani nuk ka gjet bazë ligjore dhe bazë të mjaftueshme për të hapur një rast disiplinor lidhur me këtë çështje”, thuhej në përgjigjen me shkrim të ZPD-së.

IKD nga monitorimi sistematik që i bënë ZPD-së tash e sa vite, ka vërejtur se ZPD këtë rast e ka favorizuar, duke bërë trajtim selektiv të rasteve të njëjta për persona të ndryshëm. Fillimisht, janë të rralla rastet kur ZPD fillon dhe mbyll hetimin për 4 ditë, si në rastin e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, dhe KKLKE-së, Shqipdon Fazliu. Në anën tjetër, për shkak të intervistave që kishte dhënë në një medium të caktuar ku kishte kritikuar pushtetin gjyqësor, ZPD e kishte dërguar në komisionin disiplinor të KPK-së Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Imer Beka. Ndaj Bekës, Komisioni Disiplinor i KPK-së kishte shqiptuar masën disiplinore “qortim”.

Në anën tjetër, IKD e sheh si shumë shqetësuese lojën “ping-pong” në mes të sistemit prokurorial dhe atij gjyqësor lidhur me dështimin e tyre për ta luftuar korrupsionin e profilit të lartë. Në këtë drejtim, duhet të kontribuojnë të dy sistemet. Por, është e njohur përgjithësisht, se në rastin kur një prokuror e dërgon në Gjykatë një aktakuzë e cila ka prova bindëse ndaj të akuzuarve, Gjykata e ka jashtëzakonisht të vështirë që ti shmanget vendimit të drejtë. Po ashtu, Prokurori i Shtetit ka në dispozicion mjetet e rregullta dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike, në rast se nuk është i kënaqur me vendimin e Gjykatës. Po ashtu, është detyrë e Prokurorit të Shtetit, që në rast se vërteton se gjykatat po i hudhin aktakuzat në rastet kur, siç thotë Kryeprokurori i Shtetit Lumezi, bëhet fjalë për emra të mëdhenj, të hetojë dhe dërgojë para drejtësisë gjyqtarë të caktuar, pasi “nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore” në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës është vepër penale. Kështu duhet të funksionojë ky relacion, dhe Prokurorit të Shtetit në asnjë formë nuk i lejohet që të komentojë aktgjykimet e gjykatave, për shkak se kjo përbën shkelje të Kodit të Etikës.

2. Tendanca e Këshillave që me rekomandime ta luftojë korrupsionin

KGJK, KPK, Kryetarët e Gjykatave, Kryeprokurorët dhe Ministri i Drejtësisë më 22 mars 2018 kishin mbajtur një takim të përbashkët, ku në të njëjtin kishin diskutuar lidhur me hapat e mëtutjeshëm për luftën kundër korrupsionit, si kriter i fundit për liberalizimin e vizave.

Ky takim vinte një ditë pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte ratifikuar Marrëveshjen Ndërkombëtare për Përcaktimin e Vijës Kufitare me Malin e Zi, apo siç njihej në publik, Demarkacionin me Malin e Zi.

Gjatë kësaj mbledhje ishin dhënë gjashtë rekomandime për hapat e mëtutjeshëm në luftimin e korrupsionit. “1. Të mbahen takime të rregullta mujore në këtë përbërje, 2. Të ketë koordinim në mes Prokurorive dhe Gjykatave, 3. Të mos shtyhen seancat mbi 10 ditë, 4. Të rritet numri i gjyqtarëve në Gjykatën Themelore të Prishtinës, 5. Kufizimi i gjyqtarëve për pjesëmarrjen e tyre në trajnime dhe 6. Ngritja e transparencës në raport me mediat dhe shoqërinë civile”.

Gjatë këtij takimi, mediat dhe shoqëria civile ishin përjashtuar, me arsyetimin se në takim do të diskutohet për të dhëna të cilat nuk janë publike. Por, për dallim nga mediat dhe shoqëria civile, në takim kishte marrë pjesë edhe Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri.

Sidoqoftë, IKD ka monitoruar në vazhdimësi këto rekomandime, nëse të njëjtat janë zbatuar në praktikë. IKD ka gjetur se rekomandimi që seancat e korrupsionit të mos shtyhen më shumë se 10 ditë është shkelur nga Gjykatat e Republikës së Kosovës qysh në ditën e parë kur do të duhej të zbatoheshin këto rekomandime. Po ashtu, edhe rekomandimi për takime të rregullta të këtij formati nuk ishte zbatuar asnjëherë, pasi takim në këtë përbërje nuk ishte mbajtur më.

b. Kontrolli, ndërhyrjet dhe ndikimet politike në sistemin prokurorial

Një prej problemeve më shqetësuese në sistemin e drejtësisë në Kosovë vazhdon të mbetet ndërhyrja politike dhe ndikimet e grupeve të interesit në sistemin gjyqësor dhe prokurorial. IKD tashmë një dekadë, vazhdimisht ngritë zërin për pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe prokurorial, për të cilat ka ofruar gjetje, vlerësime dhe rekomandime se sit ë adresohet zgjidhja e këtij problem. Në vazhdim janë ngritur disa prej çështjeve problematike që ndërliken drejtpërdrejtë me ndërhyrjet politike, ndërhyrjet e ekzekutivit si dhe ndërhyrjet e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, në pavarësinë individuale të prokurorëve dhe sistemit prokurorial, në pavarësinë e gjykatësve dhe sistemit gjyqësor.

1. Centralizimi i hetimeve ndaj profilit të lartë, kontroll i kundërligjshëm i Kryeprokurorit

Më 30 dhjetor 2015, Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka miratuar udhëzim të detyrueshëm të kundërligjshëm, përmes së cilit ka obliguar të gjithë prokurorët që brenda pesë ditëve nga pranimi i ndonjë informate/rasti të korrupsionit të nivelit të lartë të informojnë Kryeprokurorin e prokurorisë përkatëse. Sipas këtij udhëzimi, Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse posa të pranoj informatën e tillë, brenda tetë ditëve është i obliguar të informoj Kryeprokurorin e Shtetit.

Kryeprokurori i Shtetit, që nga ardhja e tij në këtë pozitë ka filluar marrjen e masave dhe veprimeve të kundërligjshme që për qëllim parësor kanë pasur kontrollin e gjithë sistemit prokurorial në trajtimin e rasteve të korrupsionit, me theks të veçantë korrupsionin e nivelit të lartë.

Kryeprokurori Lumezi, në vazhdimësi në kundërshtim me ligjin ka themeluar komisione përmes së cilave ka ndërtuar mekanizma dhe praktika, për të kontrolluar çdo prokuror dhe prokurori për të pasur informacion dhe për të kontrolluar çdo rast të korrupsionit të nivelit të lartë që është në procedurë. Për më tepër, Udhëzuesi i Detyrueshëm nuk ka bazë ligjore, dhe përbën shkelje dhe ndërhyrje flagrante në pavarësinë individuale të prokurorëve në trajtimin e rasteve të korrupsionit, ku ka hapur mundësinë që numër i madh i personave të kenë qasje në

informata lidhur me raste të tilla, dhe këto informata të rrjedhin në publik dhe në media, praktikë kjo që ka ndodhur në vazhdimësi.

Kryeprokurori Lumezi, ka keqpërdorur dispozitën e ligjit të aplikueshëm për Prokurorin e Shtetit, e cila i jep Kryeprokurorit të drejtën për të nxjerrë me shkrim rregulla, udhëzime dhe vendime të përgjithshme të detyrueshme për të gjithë kryeprokurorët dhe prokurorët me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit.

Kjo dispozitë ka për qëllim që Kryeprokurori i Shtetit të nxjerr rregulla dhe udhëzime të përgjithshme dhe të detyrueshme për të shmangur apo evituar situatat kur prokurorët mund të ndërtojnë praktika të ndjekjes që bien në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm apo praktikën gjyqësore, dhe të sigurohet që të zbatohet në mënyrë unike ndjekja penale në të gjitha prokuroritë.

IKD vlerëson se qasja e tillë e Kryeprokurorit të Shtetit, është ndërhyrje e rëndë në pavarësinë individuale të prokurorëve në rastet e korrupsionit, pavarësi kjo e garantuar me Kushtetutë, Ligjin për KPK, Ligjin për PSh dhe standardet ndërkombëtare.¹¹¹

IKD vlerëson se ndërhyrjet, centralizimi i menaxhimit të rasteve për të pasur nën kontroll çdo informacion mbi rastet, dëshmon se Kryeprokurori i Shtetit ka ndërtuar praktika të punës për të krijuar amnisti të kryesve të vërtetë të veprave penale të korrupsionit, gjë që dëshmohet se në tri vitet e fundit, nuk ka asnjë aktgjykim përfundimtar ndaj profilit të lartë, i cili është shqiptuar me dënim me burgim efektiv. IKD vazhdimisht ka ngritur shqetësime për mënyrën se si janë ngritur aktakuzat ndaj profilit të lartë të korrupsionit, aktakuza të cilat nuk janë përshkuar me hetime dhe ndjekje profesionale, duke ofruar prova dhe dëshmi, por duke ngritur aktakuza, të cilat bien në shqyrtimin fillestar. IKD ka vlerësuar vazhdimisht se kjo mënyrë e ngritjes së aktakuzave, të cilat assesi nuk kanë arritur të provohen në gjykatë, bëhet për tri arsye. E para për shkak të mungesës së profesionalizmit nga ana e prokurorëve dhe hetuesve, e dyta bëhet qëllimisht për të persekutuar individë të caktuar të cilët ndiqen sipas agjendave politike dhe të grupeve të ndryshme të interesit dhe e treta për shkak të amnistisë që iu krijohet zyrtarëve të akuzuar për korrupsion, për shkak se aktakuzat ndaj tyre rrëzohen për mungesë të provave dhe dëshmive dhe të njëjtit nuk mund të ndiqen më për veprat e njëjta të gjykuara njëherë.

Përfundimisht, bazuar në mungesën e rezultateve konkrete në luftimin e korrupsionit të profilit të lartë dhe duke vlerësuar sjelljen dhe afërsinë e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi me politikën dhe grupet e interesit, IKD vlerëson se qëllimi i këtij Udhëzimi ka qenë ekskluzivisht futja e kontrollit të prokurorëve dhe kryeprokurorëve në trajtimin e lëndëve të korrupsionit të profilit të lartë.

¹¹¹ “Kreu II, Parimet Themelore, Neni 3, Pavarësia dhe paanshmëria e Prokurorit të Shtetit”. *Ligji për Prokurorin e Shtetit*. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 30 shtator 2010. Shih linkun [http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Ligji_per_prokurorin_e_shtetit_\(shqip\).pdf](http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Ligji_per_prokurorin_e_shtetit_(shqip).pdf)

2. Ndërhyrjet e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit në hetimin e rasteve të korrupsionit

IKD konsideron se gjendja shqetësuese e mostrajimit të rasteve të korrupsionit, vërtetohet me analizimin e trendeve të rasteve të pazgjidhura nëpër prokurori, në të cilat ekzistojnë me qindra kallëzime penale të pazgjidhura të parashtruara ndër vite dhe me dekada, ku një numër i tyre kanë arritur afatin e parashkrimit absolut të ndjekjes penale. IKD vazhdimisht në gjetjet e saj gjatë procesit të monitorimit të prokurorive në trajtimin e rasteve të korrupsionit, ka shprehur shqetësim lidhur me mënyrën e zgjidhjes së këtyre rasteve dhe numrin e madh të rasteve të hudhura apo të pushuara. Hudhja dhe pushimi i rasteve të korrupsionit, bazuar në statistikën e prokurorive, rezulton se është shndërruar në një fenomen shqetësues në pothuajse të gjitha prokuroritë, ku mbi 50% të tyre kanë përfunduar me pushim apo hudhje.

Për këtë arsye, IKD në raportet e saj periodike ka rekomanduar KPK-në, që të themelojë një Komision të përbërë nga prokurorë me përvojë për të analizuar këtë fenomen, dhe për të hartuar një raport lidhur me gjetjet dhe arsyet se pse një numër kaq i madh i rasteve mbyllen në prokurori, duke u hudhur kallëzimet penale apo duke u pushuar hetimet. Rekomandimi i IKD ka pasur për qëllim që KPK të analizoj gjendjen aktuale, të vlerësojë cilësinë e kallëzimeve penale për të identifikuar nëse përgatitja e tyre është e dobët prej parashtruesve apo ka mungesë të profesionalizmit të prokurorëve që t'i trajtojnë këto raste, apo ka arsye të tjera që mund të identifikohen në praktikë. Në bazë të këtyre të gjeturave KPK, do të kishte mundësi të zhvillojë politika për luftimin e suksesshëm të korrupsionit, të mësonte nga gabimet në praktikë që janë zbatuar deri më tani, dhe të adresonte problemin në mënyrë institucionale. IKD ka rekomanduar themelimin e këtij komisioni në pajtim me ligjin e aplikueshëm pasi që Komisioni do të kishte përgjegjësi vetëm në vlerësimin e rasteve të mbyllura me vendim nga prokurorët, dhe çdo vlerësim apo analizë nga ky komision nuk do të mund të konsiderohej ndërhyrje në punën e prokurorëve apo në pavarësinë e tyre të garantuar me Kushtetutë dhe ligj.

Kryeprokurori i Shtetit më 6 tetor 2015,¹¹² ka nxjerrë Vendimin me numër A.nr.404/2015, për krijimin e një Komisioni Mbikëqyrës për rastet penale të korrupsionit në përbërje me Zëvendës Kryeprokuroren e Shtetit, Sevdije Morina dhe tre prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, Lulëzim Sylejmani dhe Laura Pula. Komisioni ka për detyrë të vizitojë të gjitha prokuroritë dhe të kërkojë nga secili prokuror rastet e korrupsionit që i kanë në punë, për të vlerësuar veprimet e ndërmarra nga ta. Pas verifikimit, Komisioni ka për detyrë të përgatisë raport tek Kryeprokurori i Shtetit.

IKD assesi nuk ka rekomanduar dhe nuk pajtohet që të krijohet dhe fuqizohet një Komision i tillë, (“*të kërkojë nga secili prokuror rastet e korrupsionit që i ka në punë, për të vlerësuar veprimet e ndërmarra nga prokurorët e çështjes*”) të cilit i jepet mandat i kundërligjshëm dhe

¹¹² Vendim nga Kryeprokurori i Shtetit z. Aleksandër Lumezi, për Emërimin e Komisionit mbikëqyrës për rastet e korrupsionit; [http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Nr_997_2015-Vendim-Emerimi_i_Komisionit_mbikeqyres_per_rastet_penale_te_korrupsionit_\(5\).pdf](http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Nr_997_2015-Vendim-Emerimi_i_Komisionit_mbikeqyres_per_rastet_penale_te_korrupsionit_(5).pdf)

në kundërshtim me frymën dhe pavarësinë e garantuar me Kushtetutë dhe Ligj për prokurorët gjatë trajtimit të rasteve që i'u janë ndarë në punë.

IKD vlerëson se mandati i këtij Komisioni është i kundërligjshëm dhe kjo ndikon drejtpërdrejt në pavarësinë e vendimmarrjes së prokurorëve.¹¹³ Ndërhyrjet për të pasur qasje në një lëndë, për t'ia marrë një prokurori dhe për t'ia caktuar një prokurori tjetër, janë e drejtë ligjore e përcaktuar ekskluzivisht për Kryeprokurorin e Shtetit, dhe vetëm për raste individuale, dhe një gjë të tillë mund të bëhet përmes vendimit të veçantë në formë të shkruar dhe arsyetuar, por kjo e drejtë assesi nuk mund t'i delegohet dikujt tjetër, sikurse në këtë rast Komisionit. Ndërhyrje të tilla mund të bëhen vetëm për raste të caktuara dhe rrethana specifike, por assesi për të aplikuar gjerësisht për një kategori të veprave penale, sikurse në këtë rast për vepra penale të korrupsionit nga ky Komision, i cili IKD vlerëson se si i tillë ndërhyr rëndë në pavarësinë individuale të prokurorëve në rastet e korrupsionit, pavarësi kjo e garantuar me Kushtetutë, Ligjin për KPK, Ligjin për PSh dhe standardet ndërkombëtare¹¹⁴.

Udhëzimi tjetër i kundërligjshëm i Kryeprokurorit të Shtetit është edhe udhëzimi për trajtimin e kallëzimeve penale. Kryeprokurori i Shtetit më 29 prill 2016, ka nxjerrë Udhëzim me numër A.nr.258/2016, përmes së cilit ka obliguar të gjithë prokurorët e shtetit që brenda afatit prej tre (3) muajve nga dita e pranimit të kallëzimit penal, të nxjerrin Aktvendim për fillim të hetimeve nëse i njëjti kallëzim penal nuk është hudhur.¹¹⁵ Ky Udhëzimi ishte nxjerrë nga Kryeprokurori nga takimi i kolegjiut të të gjithë Kryeprokurorëve të të gjitha prokurorive të Republikës së Kosovës. Udhëzimi i lartë-përmendur bie në kundërshtim me parimet dhe standardet e përcaktuara me KPPRK. Kjo e fundit, askund nuk e përcakton afatin kohor prej 3 muajve, por e përcakton qartë në nenin 82 afatin tridhjetë (30) ditor për ta trajtuar kallëzimin penal. Ky udhëzim është i kundërligjshëm dhe si i tillë IKD ka rekomanduar të hudhet poshtë.¹¹⁶

¹¹³ “Garancionet e mos ndërhyrjes në punën e prokurorit individual, përcaktojnë se në shumicën e rasteve vendimi për të ndjekur penalisht duhet të jetë i bazuar vetëm mbi bazën e dëshmive të mjaftueshme. Përjashtimisht, në praktikë mund të paraqiten raste kur prokurori do të mund të shkaktonte dëm të interesit më të gjërë, social, ekonomik apo lidhur me çështje të sigurisë. Në ato raste kur interesi publik vihet në pyetje, duhet shtuar kujdesi në mos shkilet sundimi i ligjit, dhe prokurori në këto raste mund të konsultohet me persona që kanë përvojë dhe ekspertizë të veçantë në këto raste, por prokurorit i mbetet në fuqinë e tij për të vendosur nëse ndjekja penale është në interes të publikut. Nëse prokurori pranon ndonjë udhëzim në një rast të tillë, udhëzimi duhet të jetë i arsyetuar dhe kur eshte e mundshme i hapur për publikun”. REPORT ON EUROPEAN STANDARDS AS REGARDS THE INDEPENDENCE OF THE JUDICIAL SYSTEM:PART II – THE PROSECUTION SERVICE, Adopted by the Venice Commission at its 85th plenary session (Venice, 17-18 December 2010), Fq. 11. Shih linkun http://ëëë.coe.int/t/dghl/cooperation/capacitybuilding/Source/judic_reform/europeanStandards_en.pdf

¹¹⁴ Kreu II, Parimet Themelore, Neni 3, Pavarësia dhe paanshmëria e Prokurorit të Shtetit. Ligji për Prokurorin e Shtetit. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 30 shtator 2010. Shih linkun [http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Ligji_per_prokurorin_e_shtetit_\(shqip\).pdf](http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Ligji_per_prokurorin_e_shtetit_(shqip).pdf)

¹¹⁵ Udhëzim Nr. 258/2016, i nxjerr nga Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi më 29 prill 2016. (Shih linkun http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.578.2016-Udhëzim_-_ZKPSH.pdf (Qasur për herë të fundit me 5 tetor 2016).

¹¹⁶ Miftaraj E. dhe Musliu B. “Retorika në luftimin e korrupsionit: Raport i monitorimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Kosovë” (Instituti i Kosovës për Drejtësi: Prishtinë). 27 tetor 2016. Fq. 15, 16 dhe 17.

3. Ndërhyrjet politike dhe të Kryeprokurorit në rastin e veteranëve dhe rastin pronto

Prokurori i Shtetit, sipas Kushtetutës ka përgjegjësi ligjore për ndjekjen e personave që dyshohen se kanë kryer vepra penale. Ky është organi që ka mandatin kryesor në luftimin e kriminalitetit, në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe të drejtë¹¹⁷.

Elez Blakaj, prokuror në PSRK, më 13 gusht 2018 kishte ofruar dorëheqje nga pozita¹¹⁸. Ndërsa, më 16 gusht 2018, përmes një letre të postuar në rrjetin social “Facebook”, kishte informuar opinionin publik se më 11 korrik 2018, kishte dorëzuar aktakuzën për rastin e njohur si “Veteranët”, në zyrën e Kryeprokurorit të PSRK-së, Reshat Millaku¹¹⁹.

Pas letrës së parë, pati reagime të shumta, nga të cilat edhe akuza kundrejt personalitetit dhe profesionalizmit të prokurorit Blakaj, të cilat e shtynë atë që të paraqesë edhe një letër tjetër, më 20 gusht 2018, duke u paraqitur edhe në rolin e sinjalizuesit. Prokurori Blakaj, kësaj radhe, në publik paraqiti kërcënimet dhe presionet që kishte pasur që nga koha kur kishte filluar trajtimin e rastit të “Veteranëve”¹²⁰.

Blakaj, në një intervistë për “Betimi për Drejtësi”, kishte deklaruar se në çdo hetim të profilit të lartë, Kryeprokurori Aleksandër Lumezi, kërkonte sqarime, madje edhe kur personat e profilit të lartë ftoheshin thjesht në cilësi të dëshmitarëve¹²¹. Dorëheqja e Blakajt dhe arsyet e kësaj dorëheqjeje shkaktuan reagime të shumta në publik, përfshirë reagime nga shoqëria civile, institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare.

IKD konsideron se dorëheqja e prokurorit Blakaj, ka dëshmuar për gjendjen e sigurisë dhe të funksionimit të sistemit prokurorial, në të cilin ndikojnë politika dhe grupet e interesit, që pamundësojnë hetime të pavarura¹²².

Ambasada Amerikane në Kosovë, e kishte vlerësuar si dekurajuese dorëheqjen e Blakajt¹²³. Ambasadori Amerikan në Kosovë, Greg Delawie, e kishte quajtur të trishtë ditën kur

¹¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 109

¹¹⁸ “Për shkak të kërcënimeve jep dorëheqje prokurori special, Elez Blakaj”. Koha.net. 15 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/111200/per-shkak-te-kercenimeve-jep-doreheqje-prokurori-special-elez-blakaj/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹¹⁹ “Prokurori special Elez Blakaj, në dorëheqjen e tij, konfirmon se nga 11 korriku aktakuzën e ngritur ia ka dorëzuar Kryeprokurorit special, Reshat Millaku”. Betimi për Drejtësi. 16 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-special-elez-blakaj-ne-doreheqjen-e-tij-konfirmon-se-nga-11-korrikuaktakuzen-e-ngritur-ia-ka-dorezuar-kryeprokurorit-special-reshat-millaku/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹²⁰ “Flet Elez Blakaj, thotë se kishte kërcënime nga veteranët, përmend presionin e Kryeprokurori Aleksandër Lumezi për veteranët e UÇK-së dhe rastin “Pronto”. Betimi për Drejtësi. 20 gusht 2018. <https://betimiperdrejtesi.com/fletelez-blakaj-thote-se-kishte-kercenime-nga-veteranet-permend-presionin-e-kryeprokurori-aleksander-lumezi-perveteranet-e-uck-se-dhe-rastin-pronto/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹²¹ “Çfarë thotë Blakaj për kërcënimet nga Kryeprokurori Lumezi, Kryeministri Haradinaj dhe të tjerët? (Video)”. Betimi për Drejtësi. 12 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/cfare-thote-blakaj-per-kercenimetnga-kryeprokurori-lumezi-kryeministri-haradinaj-dhe-te-tjeret-video/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹²² “Ndërhyrjet politike në sistemin e politizuar prokurorial, alarm për nevojën e vetingut në polici, prokurori dhe gjykata”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 30 gusht 2018. Faqe 4 (Shih linkun <http://kli-ks.org/nderhyrjet-politike-nesistemin-e-politizuar-prokurorial-alarm-per-nevojen-e-vetingut-ne-polici-prokurori-dhe-gjykata/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

prokurori Blakaj kishte dhënë dorëheqje¹²⁴. Njëkohësisht, Delaëie, në një ligjëratë para studentëve të Fakultetit Juridik, kishte thënë se në rastin e “Veteranëve”, të cilin e kishte hetuar Blakaj, kishte pasur kërcënime si nga brenda sistemit të drejtësisë, ashtu edhe jashtë tij¹²⁵.

Edhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, kishte shprehur shqetësimin e saj për ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë pas dorëheqjes së Blakajt. “Deklaratat e disa politikanëve dhe prokurorëve në Kosovë rrezikojnë parimet kryesore të sundimit të ligjit. Për më tepër, ato dërgojnë sinjale dekurajuese tek të gjithë zyrtarët ligjorë që trajtojnë lëndë të ndjeshme dhe të rëndësishme”¹²⁶.

KPK më 22 gusht 2018, përmes një komunikate për media kishte deklaruar se ky institucion është duke u angazhuar që Prokurori i Shtetit të veprojë si i pavarur dhe i paanshëm. Në këtë komunikatë KPK, edhe pse i thirrur për të mbrojtur dhe siguruar pavarësinë e sistemit prokurorial, kishte thënë po ashtu se ky organ nuk do të ketë kompromise për asnjë prokuror në rast të dështimit të kryerjes së detyrave të tyre¹²⁷.

Shoqata e prokurorëve, e udhëhequr nga Kryeprokurori i PA, Haxhi Dërguti, e cila është e thirrur që të mbrojë interesat e prokurorëve, nuk i doli në mbrojtje prokurorit Blakaj, përkundrazi. “Deri më tani, asnjë prokuror i sistemit prokurorial të Kosovës, duke përfshirë dhe ish-prokurorin Blakaj, nuk ka shprehur asnjë shqetësim, qoftë si kërcënim apo si ndikim në punën e tij të pavarur dhe të paanshme nga kushdo qoftë. Andaj, deklaratimet publike për kinse kërcënime dhe ndikime brenda sistemit prokurorial, janë për të mbuluar interesat e tij personale apo të kujtdo tjetër”, thuhej në këtë reagim¹²⁸.

Edhe ZKPSH, kishte theksuar se kjo Zyrë, asnjëherë nuk kishte marrë informacione se prokurori Blakaj, ishte kërcënuar ndonjëherë lidhur me rastin e “Veteranëve”¹²⁹. Për më tepër, Kryeprokurori i Shtetit Aleksandër Lumezi, në një intervistë për portalin “Gazeta Express”, e kishte quajtur Blakajn, prokuror joprofesional, frikacak, të dështuar dhe prokuror

¹²³ “Ambasada amerikane për dorëheqjen e Prokurorit Special: Rast shumë dekurajues”. KlanKosova.tv. 15 gusht 2018. (Shih linkun <http://klankosova.tv/ambasada-amerikane-per-doreheqjen-e-prokurorit-special-rast-shumedekurajues/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹²⁴ “Reagimi i Ambasadorit Amerikan Greg Delawie në rrjetin social Facebook”. 15 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.facebook.com/kosovo.usembassy/posts/2663396183686520>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹²⁵ “Ambasadori amerikan thotë se UÇK-ja s’kishte më shumë se 15 mijë ushtarë, thotë se pati presion dhe frikësim ndaj prokurorit Blakaj”. Betimi për Drejtësi. 31 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ambasadoriamerikan-thote-se-uck-ja-skishte-me-shume-se-15-mije-ushtare-thote-se-pati-presion-dhe-frikesim-ndaj-prokurorit-blakaj/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹²⁶ “Reagimi i Zyrës së BE-së në Prishtinë për rastin Blakaj”. 22 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.facebook.com/610960288923231/posts/statement-by-the-eu-office-in-kosovo-eu-specialrepresentativethe-eu-is-closely-f/2059258884093357/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹²⁷ “KPK e diskuton me dyer të mbyllura dorëheqjen e ish-prokurorit të PSRK-së, Elez Blakaj”. Betimi për Drejtësi. 7 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kpk-e-diskuton-me-dyer-te-mbyllura-doreheqjen-e-ishprokurorit-te-psrk-se-elez-blakaj/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹²⁸ “Shoqata e Prokurorëve: Blakaj s’ka shprehur asnjë kërcënim”. Evropaelire.org. 23 gusht 2018. (Shih linkun <https://ëëë.evropaelire.org/a/29449560.html>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹²⁹ “Kryeprokurori i Shtetit tregon për kërcënime ndaj prokurorit të dorëhequr, Elez Blakaj”. Koha.net. 15 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/111282/kryeprokurori-i-shtetit-tregon-per-kercenimet-ndajprokurorit-te-dorehequr-elez-blakaj/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

të profileve të ulëta¹³⁰. Deklarata e tillë, e Kryeprokurorit Lumezi, ishte kontradiktore, për faktin se disa ditë më herët i njëjti kishte dhënë vlerësime pozitive për Prokurorin Blakaj, duke thënë se ai “nuk është tërhequr për shkak të kanosjes, sepse ka qenë prokuror i vendosur dhe i pa korrupsuar dhe i guximshëm.¹³¹” Pra, pasi Blakaj tregoi arsyet e dorëheqjes, ndryshoi edhe qëndrimi i Lumezit.

Gjuhë ofenduese përdori edhe Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj. Ai në një intervistë për emisionin “Interaktiv”, ish-Prokurorin Blakaj, e ka quajtur “hajn të pulave dhe pishpirik”. Po ashtu, kishte thënë se “një i ikur në Bllacë e Stankovec, nuk mund të vlerësojë numrin e saktë të veteranëve”, për të cilin Blakaj, kishte zhvilluar hetime intensive për disa muaj¹³².

Në intervistën e Blakajt dhënë për “Betimi për Drejtësi”, përpos tjerash, ai kishte thënë se mënyra e bashkëpunimit të Haradinajt me prokurorinë ka qenë e papranueshme, pasi sipas tij, kërkesa që prokurori t’i raportojë kryeministrit lidhur me hetimet, është në kundërshtim me rregullimin kushtetues të Kosovës, që bën ndarjen e pushteteve¹³³.

Fryma e kërcënimeve ndaj Blakajt kishte shkuar shumë larg. Kështu, deputeti i AAK-së, Shkumbin Demalijaj, në një intervistë në televizion publik RTK, e kishte quajtur Blakajn “kriminel”, “dezertor”, “hajn”, “idiot” e “rrugaç”. Ai kishte thënë se nëse shteti nuk e ndjek Blakajn në Kosovë për ta gjykuar, sipas tij për “shantazhin” që i ka bërë opinionit, atëherë ai do ta ndjek privatisht¹³⁴.

Edhe përkundër deklaratave të tilla, Prokurori i Shtetit nuk e kishte parë të arsyeshme t’i hetojë akuzat publike të deputetit Demalijaj ndaj prokurorit Blakaj. Vetëm pas reagimit të shoqërisë civile dhe me 11 ditë vonesë, Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte vendosur të reagojë. Sipas kërkesës së kësaj prokurorie, pas seancës dëgjimore të 28 shtatorit 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë i kishte caktuar 30 ditë paraburgim Demalijajt¹³⁵. Pas ankesës ndaj këtij vendimi, Gjykata e Apelit, më 4 tetor 2018, masën e paraburgimit ia kishte

¹³⁰ “Ekskluzive, flet Aleksandër Lumezi: Elez Blakaj është frikacak, prokuror i dështuar dhe joprofesional”. Gazetaexpress.com. 20 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.gazetaexpress.com/lajme/ekskluzive-flet-aleksanderlumezi-elez-blakaj-eshte-frikacak-prokuror-i-deshtuar-dhe-joprofesional-568679/?archive=1>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹³¹ “Ende pa nisur hetimet, Lumezi thotë se Blakaj nuk iku nga kërcënimet”. Gazetaexpress.com. 16 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.gazetaexpress.com/lajme/ende-pa-nisur-hetimet-lumezi-thote-se-blakaj-nuk-iku-ngakercenimet-567639/?archive=1>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹³² “Haradinaj e quan Blakajn hajn e pishpirik - “s’mund të vlerësojë veteranët i ikuri në Bllacë”. Koha.net. 21 gusht 2018. (Shih linkun <https://www.koha.net/video/112385/haradinaj-e-quan-blakajn-hajn-e-pishpirik-smund-te-vleresoje-veteranet-i-ikuri-ne-bllace/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹³³ “Si ndërhyri Kryeministri Haradinaj në hetimet e prokurorit Elez Blakaj? (Video)”. Betimi për Drejtësi. 12 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/si-nderhyri-kryeministri-haradinaj-ne-hetimet-e-prokuroritelez-blakaj-video/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹³⁴ “Demalijaj kërcënon Elez Blakajn: Ai është dezertor, hajn, idiot, rrugaç..., do të merrem privatisht me të”. Telegrafi.com. 17 shtator 2018. (Shih linkun <https://telegrafi.com/demalijaj-sulmon-rende-elez-blakajn-ai-eshtedezertor-hajn-idiot-rrugac-do-te-merrem-privatisht-me-te/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹³⁵ “Një muaj paraburgim edhe ndaj deputetit Shkumbin Demalijaj”. Betimi për Drejtësi. 28 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nje-muaj-paraburgim-edhe-ndaj-deputetit-shkumbin-demalijaj/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

zëvendësuar me arrest shtëpiak¹³⁶. Aktakuza e veteranëve më pas është ngritur edhe formalisht në Gjykatë nga Prokurori Special Afrim Shefkiu.

Më pas, kjo aktakuzë i ishte kthyer PSRK-së për përmirësim dhe qartësim¹³⁷. Aktakuzën e plotësuar, PSRK e kishte dërguar në Gjykatë me 7 dhjetor 2018¹³⁸.

c. Ndërhyrjet dhe kërcënimet e Kryeprokurorit të Shtetit ndaj pavarësisë së gjykatësve

Raporti i Mekazmit Përcjellës ndërinstitucional për vitin 2016 thuhet se gjatë këtij viti, prokurorët kanë parashtruar gjithsej 94 ankesa në Gjykatën e Apelit, përderisa kjo e fundit kishte aprovuar vetëm 6 prej tyre, që në përqindje i bie të jetë 6.38%.

Në raportin e Mekanizmit Përcjellës ndërinstitucional figuron se gjatë vitit 2017, për rastet e korrupsionit, prokurorët kanë parashtruar gjithsej 68 ankesa në Gjykatën e Apelit. Por, raporti nuk jep të dhëna se cilat kanë qenë vendimet e Gjykatës së Apelit përkitazi me ankesat e prokurorëve.

Në raportin vjetor të mekanizmit përcjellës ndërinstitucional figuron se gjatë vitit 2018, për rastet e korrupsionit, prokurorët kanë parashtruar gjithsej 63 ankesa në Gjykatën e Apelit. Nga këto ankesa, Gjykata e Apelit ka aprovuar vetëm 6 prej tyre, apo 9.52 %.

Kjo e dhënë vetëm sa e thellon dështimin e PSH-së në luftimin e korrupsionit për tri vitet e fundit. Në këtë drejtim, përderisa shumica dërrmuese e aktakuzave kanë dështuar në Gjykatat Themelore, të njëjtat nuk arrijnë që të kenë sukses as në Gjykatën e Apelit me rastin e parashtrimin të ankesave.

Në takimin e KPK-së të mbajtur më 30 maj 2018, Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi ka deklaruar se Gjykatat po i hudhin aktakuzat kur bëhet fjalë për personat e rëndësishëm.

“Nuk është e vërtetë ajo që raportohet në media se shumica e aktakuzave tona hudhen në Gjykatë. Në 89.15 % të rasteve këto aktakuza kalojnë në Gjykatë dhe të njëjtat marrin aktgjykime dënuese. Mirëpo, kjo situatë nuk është kështu edhe në rastet e korrupsionit. Por, kjo është një pikëpyetje e madhe. Pse njerëzit të cilët nuk kanë emër dhe mbiemër dënohen nga Gjykata dhe aktakuzat konfirmohen. Ndërsa ato aktakuza ku janë të përfshirë njerëzit e rëndësishëm me emra dhe mbiemër, ato nuk kalojnë në Gjykatë. Mirëpo, ne nuk i komentojmë vendimet gjyqësore edhe atëherë kur nuk pajtohemi me to, pos në rastet kur ushtrojmë mjetet juridike”.

¹³⁶ “Deputeti Shkumbin Demalijaj lirohet nga paraburgimi, i caktohet masa e arrestit shtëpiak”. Betimi për Drejtësi. 4 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-shkumbin-demalijaj-lirohet-nga-paraburgimi-icaktohet-masa-e-arrestit-shtepiak/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹³⁷ “Aktakuza e veteranëve i kthehet Prokurorisë Speciale për përmirësim dhe qartësim”. Betimi për Drejtësi. 10 tetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktakuza-e-veteraneve-i-kthehet-prokurorise-speciale-per-permiresim-dhe-qartesim/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹³⁸ “Prokuroria Speciale e dorëzon në Gjykatë aktakuzën e plotësuar në rastin e “Veteranëve””. Betimi për Drejtësi. 07 dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-speciale-e-dorezon-ne-gjykatë-aktakuzën-e-plotësuar-ne-rastin-e-veteraneve/>). (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

Pas kësaj, më 4 qershor 2018, KGJK ka mbajtur takim të jashtëzakonshëm ku janë shqyrtuar këto deklaratat, për të cilat është thënë se përbëjnë ndërhyrje në sistemin e drejtësisë.

Pas takimit, për “Betimi për Drejtësi”, Kryetari i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Hasan Shala ka deklaruar se aktakuzat e prokurorisë janë të pabazuara në prova, dhe se prokuroria punon për statistika, ndërsa dështimet e veta po ia atribuon gjyqësorit. Në anën tjetër, Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, nuk e sheh këtë fakt si dështim të ankesave të prokurorëve, por si praktikë e krijuar nga Gjykata e Apelit për hudhjen e ankesave të prokurorëve. “Nga 100 ankesa, i kemi vetëm 6 apo 7 prej tyre të aprovuara. Duhet të shikojmë se për këto ankesa a është krijuar një praktikë për hudhjen e tyre, apo ne ende nuk kemi arritur ta përmirësojmë cilësinë e ankesave. Me gjasë është krijuar praktikë hudhja e këtyre ankesave”, kishte thënë Hyseni në takimin e KPK-së të mbajtur me 21 shkurt 2019, kur edhe është prezantuar raporti i Mekanizmit Përcjellës ndërinstitucional për vitin 2018.

1. Dukuria e tërheqjes së prokurorëve nga aktakuzat për korrupsion pa arsytim adekuate

IKD ka monitoruar sistematikisht trajtimin e rasteve të korrupsionit në gjykata dhe ka vërejtur një dukuri të shprehur nga ana e prokurorëve për tu tërhequr nga aktakuzat. Për shkak të rolit të gjykatësit në procedurë penale – rol ekskluzivisht i arbitrit – në rastet kur prokurorët tërhiqen nga aktakuzat pushon procedura penale. Në këto raste edhe nëse vendimi i prokurorit për tu tërhequr nga aktakuza është i pabazuar, gjykatësi nuk mund të ndërmer asnjë veprim. Ky fenomen i tërheqjes së prokurorëve nga aktakuzat është i shprehur kryesisht tek rastet e profilit të lartë.

Ndër rastet e monitoruara nga IKD, theksohet rasti i tani shefit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, Driton Gashi.¹³⁹ Prokurorit Feti Tunuzliu as dy javë nuk i kanë mjaftuar që të bëhet pishman për aktakuzën e ngritur ndaj Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Driton Gashi. Aktakuzën ndaj këtij të fundit, Tunuzliu e kishte ngritur në maj 2016, ndërsa në seancën fillestare të ftuar më 27 dhjetor 2016, për të cilën kishte raportuar “Betimi për Drejtësi”, nuk ishin paraqitur as prokurori Tunuzliu e as i pandehuri Gashi. Seanca fillestare ishte mbajtur tek më 18 janar 2017, ku prokurori kishte paraqitur aktakuzën si të qëndrueshme para Gjykatës Themelore në Prishtinë. Ndërkohë, pas vetëm 13 ditësh, më 1 shkurt, prokurori Tunuzliu përmes një parashtrere kishte njoftuar kryetarin e trupit gjykues, Arben Hoti, se kërkon të tërhiqet nga aktakuza. Në arsyetim prokurori ka thënë se nuk ka prova të mjaftueshme, për ta mbështetur dyshimin e bazuar se Gashi, e kishte kryer veprën penale me të cilën e ngarkonte aktakuza. Vetëm një javë pas tërheqjes nga aktakuza, e cila ishte konfirmuar nga gjykatësi Hoti, Driton Gashi është emëruar në krye të AKI-së. Aktakuza ishte ngritur duke u bazuar në kallëzimin penal që ishte iniciuar nga Udhëheqësi i Divizionit për Sigurimin e Aviacionit Civil në kuadër të MPB-së, Luan Ismajli, kundër Driton Gashit, për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Ismajli këtë e kishte bërë, pasi që, sipas aktakuzës, Gashi

¹³⁹ “Prokurori Feti Tunuzliu një javë para emërimit të shefit të AKI-së tërhiqet nga aktakuza kundër Driton Gashit për keqpërdorim të pozitës zyrtare”. Betimi për Drejtësi. 8 shkurt 2017. (Shih linkun <http://betimiperdrejtesi.com/prokurori-feti-tunuzliu-nje-jave-para-emerimit-te-shefit-te-aki-se-terhiqet-nga-aktakuza-kunder-driton-gashit-per-keqperdorim-te-pozites-zyrtare/>)

nga pozita e sekretarit të Përgjithshëm në MPB, me një vendim të tij, e kishte transferuar Ismajlin në një divizion tjetër, duke e ulur kështu në pozitë.

Ky ishte vetëm një ndër rastet më reprezentative të tërheqjes së prokurorit nga aktakuza, pa pasur prova dhe dëshmi të reja, por që është deklaruar se nuk është bindur se është kryer vepra penale, brenda një periudhe të shkurtër kohore. Në këtë rast, nuk është parë asnjë mekanizëm i llogaridhënies, të ketë ndërmarr veprime konkrete për të mbajtur përgjegjës këtë veprim të prokurorit. IKD vlerëson se në këto raste, ngritja ose tërheqja nga aktakuza nga ana e prokurorit është bërë qëllimisht dhe njëherësh ka kërkuar përgjegjësi publikisht nga mekanizmat e llogaridhënies. IKD ka raportuar me dhjetëra raste të tilla, në të cilat prokurorët kanë tërhequr aktakuzat, në faza të ndryshme, pa pasur prova apo dëshmi të reja, të cilat do ta ndërronin gjendjen faktike nga ajo e ngritjes së aktakuzës.¹⁴⁰

Raste si ky ka pasur vazhdimisht gjatë procesit të monitorimit të rasteve të korrupsionit.¹⁴¹ Ka pasur qytetarë që me dekada janë mbajtur pezull duke udhëhequr procedura penale ndaj

¹⁴⁰ Për më tepër për të gjitha rastet e ngjashme të tërheqjes së prokurorëve nga aktakuzat vizitoni faqen e portalit “Betimi për Drejtësi” - “www.betimiperdrejtesi.com”

¹⁴¹ “Prokurori heq dorë nga ndjekja penale ndaj teknikut të pyjeve që akuzohej për keqpërdorim pozite” – Betimi për Drejtësi – 27 nëntor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-heq-dore-nga-ndjekja-penale-ndaj-teknikut-te-pyjeve-qe-akuzohej-per-keqpërdorim-pozite/>)

“Gjykimi ndaj Zana Kotorrit dhe të tjerave, prokurori heq dorë nga ndjekja penale për dy vepra, kërkon dënim për marrje ryshfeti” – Betimi për Drejtësi – 2 nëntor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-zana-kotorrit-dhe-te-tjerave-prokurori-heq-dore-nga-ndjekja-penale-per-dy-vepra-kerkon-denim-per-marrje-ryshfeti/>)

“Arrihet parashkrimi absolut, prokuroria heq dorë nga ndjekja penale ndaj ish-kryetarit të Dragashit” – Betimi për Drejtësi – 5 tetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/arrihet-parashkrimi-absolut-prokuroria-heq-dore-nga-ndjekja-penale-ndaj-ish-kryetarit-te-dragashit/>)

“Prokurori tërhiqet nga aktakuza ndaj ish-komandantit policor në veri, gjykimi vazhdon për ish-zëvendësin e tij” – Betimi për Drejtësi – 29 gusht 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-terhiqet-nga-aktakuza-ndaj-ish-komandantit-policor-ne-veri-gjykimi-vazhdon-per-ish-zevendesin-e-tij/?fbclid=IwAR0IJ4v6q8jYG4p2etgUomYërb8YS03uh83YhhictZ7SDgt7lC92hBKozC4>)

“13 vjet pas ngritjes së aktakuzës, prokuroria heq dorë nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit për korrupsion” – Betimi për Drejtësi – 18 korrik 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/13-vjet-pas-ngritjes-se-aktakuzes-prokuroria-heq-dore-nga-ndjekja-penale-ndaj-te-akuzuarit-per-korrupsion/>)

“Prokuroria heq dorë nga ndjekja penale për një të akuzuar në rastin Kohler, kërkon dënimin e dy të tjerëve derisa mbrojtja kërkon lirimin e tyre” – Betimi për Drejtësi – 22 maj 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-heq-dore-nga-ndjekja-penale-per-nje-te-akuzuar-ne-rastin-kohler-kerkon-denimin-e-dy-te-tjereve-derisa-mbrojtja-kerkon-lirimin-e-tyre/>)

“Aktgjykim refuzues ndaj ish-zyrtarit të Komunës së Kllokotit, pasi prokurori tërhiqet nga aktakuza” – Betimi për Drejtësi – 3 maj 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-refuzues-ndaj-ish-zyrtarit-te-komunes-se-kllokotit-pasi-prokurori-terhiqet-nga-aktakuza/>)

“Aktgjykim refuzues ndaj zyrtarëve të gjendjes civile në Komunën e Pejës, dy të tjerët dënohen me kusht” – Betimi për Drejtësi – 26 prill 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-refuzues-ndaj-zyrtareve-te-gjendjes-civile-ne-komunen-e-pejes-dy-te-tjeret-denohen-me-kusht/>)

“Prokuroria tërhiqet nga aktakuza pasi kupton që për të njëjtën çështje tash ka një vendim të formës së prerë” – Betimi për Drejtësi – 21 prill 2018 (Shih linkun https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-terhiqet-nga-aktakuza-pasi-kupton-qe-per-te-njejtën-ceshtje-tash-ka-nje-vendim-te-formes-se-prere/?fbclid=IwAR2licTZYxtMëqCJg241n117djvyn2_L0XdOK80Njpb5Fp1xnTY9GDFL31Y)

“Rasti i të akuzuarit për korrupsion, prokurori tërhiqet nga ndjekja për një të akuzuar nga veprat penale” – Betimi për Drejtësi – 2 nëntor 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-i-te-akuzuarit-per-korrupsion-prokurori-terhiqet-nga-ndjekja-per-njeren-nga-veprat-penale/>)

tyre për korrupsion, por që në fund prokurorët kanë hequr dorë nga aktakuzat, pa arsyetime adekuate.

2. Trajtimi i KGJK-së dhe KPK-së si “departamente” të MD-së

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, në emër të bashkëpunimit që ka me KGJK dhe KPK, ka tejkualuar autorizimet e tij në takimet që ka zhvilluar me të dy këshillat. Për më tepër, Ministri Tahiri ka prezantuar edhe në një takim të mbyllur mes KGJK-së dhe KPK-së, takim i cili tanimë është sqaruar në faqet e mëposhtme të këtij raporti.

Në takimet me punëtorët e administratës së sistemit gjyqësor dhe prokurorial, kur këta të fundit kishin hyrë në grevë, kishte qenë prezent Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, se bashku me kryesuesin e KGJK-së, Nehat Idrizi¹⁴². Me të dy kryesuesit, Tahiri kishte zhvilluar takim edhe në Gjykatën Themelore të Prishtinës¹⁴³, kishin pritur në takim Prokurorin e Specializuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, Jack Smith¹⁴⁴, kishin qenë bashkë në

“Dy herë shpallet fajtor, ish avokati publik herën e tretë lirohet nga akuza” – Betimi për Drejtësi – 12 maj 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ishte-shpallur-dy-here-fajtor-ish-avokati-publik-ne-kacanik-heren-e-trete-lirohet-nga-akuza/>)

“Pas 4 vite gjykimi, prokurori Arben Kadriu tërhiqet nga aktakuza ndaj rojës së pyllit” – Betimi për Drejtësi – 10 tetor 2016 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-4-vite-gjykimi-prokurori-arben-kadriu-terhiqet-nga-aktakuza-ndaj-rojes-se-pyllit/?fbclid=IèAR05Uq9xkM61cv0xMxojDPah09ORyT3mTvÈHXAiKfrcNisxO2BDlvNIOJsk>)

“Pas përfundimit të procedurës së provave, prokurori tërhiqet nga aktakuza – Betimi për Drejtësi” – 1 gusht 2016 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-perfundimit-te-procedures-se-provave-prokurori-terhiqet-nga-aktakuza/?fbclid=IèAR1RffhjEPUazPu2m8dSg9aiJjoKFTTmhx5UKvj7KYBp9g-9eCzaolSSStQo>)

“Arrihet parashkrimi absolut, prokuroria heq dorë nga ndjekja penale kundër policëve të akuzuar për ryshfet” – Betimi për Drejtësi – 27 korrik 2016 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/arrihet-parashkrimi-absolut-prokuroria-heq-dore-nga-ndjekja-penale-kunder-policeve-te-akuzuar-per-ryshfet/>)

“Prokuroria tërhiqet nga ndjekja penale kundër të akuzuarve për keqpërdorim të pozitës zyrtare” – Betimi për Drejtësi – 7 qershor 2016 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-terhiqet-nga-ndjekja-penale-kunder-te-akuzuarve-per-keqperdorim-te-pozites-zyrtare/>)

“Prokurori heq dorë nga ndjekja penale për keqpërdorim detyre, kërkon që ish-drejtori i shkollës të dënohet për marrje ryshfeti” – Betimi për Drejtësi - 4 qershor 2016 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-heq-dore-nga-ndjekja-penale-per-keqperdorim-detyre-kerkon-qe-ish-drejtori-i-shkolles-te-denohet-per-marrje-ryshfeti/>)

“Prokurori heq dorë nga ndjekja penale për njëzën nga të akuzuarat për korrupsion” – Betimi për Drejtësi - 28 prill 2016 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-heq-dore-nga-ndjekja-penale-per-njeren-nga-te-akuzuarat-per-korrupsion/>)

“Prokurori heq dorë nga ndjekja penale e Pren Krasniqit, vazhdon gjykimi ndaj Azem Bajramit për marrje ryshfeti” – Betimi për Drejtësi 6 prill 2016 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-heq-dore-nga-ndjekja-penale-e-pren-krasniqit-vazhdon-gjykimi-ndaj-azem-bajramit-per-marrje-ryshfeti/>)

“Lirohet nga akuza Ahmet Shehu i akuzuar për korrupsion” – Betimi për Drejtësi - 21 mars 2016 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lirohet-nga-akuza-ahmet-shehu-i-akuzuar-per-korrupsion/>)

¹⁴² “Ministri i Drejtësisë dhe kryesuesi i KGJK-së kërkojnë ndërprerjen e grevës, sindikalistët thonë se ajo do të vazhdojë (Video)”. Betimi për Drejtësi. 10 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ministri-i-drejtësisë-dhe-kryesuesi-i-kgjk-se-kerkojne-nderprerjen-e-greves-sindikalistet-thone-se-ajo-do-te-vazhdoje/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹⁴³ “Tahiri: Pavarësia e gjyqësorit, shtyllë e shtetndërtimit demokratik”. Telegrafi.com. 3 nëntor 2017. (shih linkun <https://telegrafi.com/tahiri-pavaresia-e-gjyqesorit-shtyllë-e-shtetndertimit-demokratik/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹⁴⁴ “Ministri Tahiri takoi Prokurorin e Specializuar, Jack Smith”. Indeksonline.com. 30 tetor 2018. (shih linkun <https://indeksonline.net/ministri-tahiri-takoi-prokurorin-e-specializuar-jack-smith/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

përrurimin e vënies në zbatim të projektit TIK/SMIL¹⁴⁵ si dhe në shumë takime të tjera, për çfarë ishte krijuar përcepti sikur Ministria e Drejtësisë të jetë pjesë e sistemit gjyqësor dhe jo atij ekzekutiv, apo e kundërta, që KGJK dhe KPK janë pjesë e MD-së.

Në rastin e debatit mbi aktakuzën e veteranëve, Ministri Tahiri kishte premtuar se kjo aktakuzë nuk do të mbetet në sirtarët e prokurorisë. Ai kishte thënë se këtë do ta bëjë për aq sa ja lejojnë kompetencat e tij¹⁴⁶.

Në një intervistë televizive në Radio Televizionin e Kosovës, Tahiri i kishte cilësuar shumë normale këto takime, për faktin se ai është Ministër i Drejtësisë¹⁴⁷.

IKD e sheh si shumë shqetësuese këtë “bashkëpunim”. Bashkëpunimi në mes KGJK-së dhe KPK-së në njërin anë, dhe MD-së në anën tjetër, duhet të jetë në fushat në të cilat këto institucione duhet të bashkërendojnë agjendën, siç janë nismat legjislative, grupet punuese apo fushat që kanë të bëjnë me hartimin e politikave në sektorin e drejtësisë, ku kompetente është Ministria e Drejtësisë.

Kushtetuta e Kosovës, e bën në mënyrë të qartë ndarjen e pushteteve, në atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Pushteti gjyqësor është i pavarur nga dy pushtetet tjera dhe kjo pavarësi duhet mbrojtur.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës, Qeveria apo edhe vet Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, duhet tii kenë parasysh kompetencat që kanë dhe nuk duhet të ndërmarrin veprime që cenojnë pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Për më tepër, si legjislativi ashtu dhe ekzekutivi duhet të shmangin situatat që në publik mund të përceptohen si ndërhyrje në pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Në anën tjetër, edhe vet KGJK dhe KPK duhet të jenë të vëmendshëm dhe t'i shmangen takimeve të tilla, në mënyrë që ti shmangen ndikimit eventual si dhe t'i shmangen krijimit të opinionit në publik se sistemi ekzekutiv ka ndikim në atë gjyqësor. Shembull tipik të kësaj kemi premtimin e Ministrit Tahiri se aktakuza ndaj veteranëve nuk do të mbetet në sirtarët e prokurorisë, për aq sa atij i'a lejojnë kompetencat. Ministri i Drejtësisë duhet ta ketë parasysh se në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ligjeve të aplikueshme, ai nuk e ka as edhe një kompetencë të vetme në këtë aspekt. Për më tepër, një deklaratë të tillë në publik IKD e vlerëson se lehtësisht mund të përceptohet si ndërhyrje në punën e gjyqësorit, përkundër faktit se Tahiri kishte thënë se ky nuk ishte qëllimi i tij.

¹⁴⁵ “Komunikatë e përbashkët e KGJK-së, KPK-së dhe ambasadës së norvegjisë në prishtinë”. KGJK. 21 nënton 2018. (shih linkun <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/event/index/1755>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹⁴⁶ “Tahiri premtonte se aktakuza për veteranët s’do të mbetet në sirtar, vettingun e quan të domosdoshëm”. Koha.net. 21 gusht 2018. (shih linkun <https://www.koha.net/arberi/112483/tahiri-premtonte-se-aktakuza-per-veteranet-sdo-te-mbetet-ne-sirtar-vettingun-e-quan-te-domosdoshem/>) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

¹⁴⁷ “10 minuta”. RTK. 28 mars 2018. (Shih linkun https://web.facebook.com/rklivecom/videos/10155952694023859/UzpfSTExODY4MzMëMTA6MTAyMTU4ODE3NzgZMzU4MjA/?q=ehat%20miftaraj%20besart%20galica%20abelard%20tahiri&epa=SEARCH_BOX) . (Qasur për herë të fundit më 22 janar 2018).

d. Luftimi i korrupsionit pa kontroll të gjyqësorit

Kodi i procedurës penale, prokurorit të shtetit i ofron diskrecion lidhur me fillimin e hetimit apo ndjekjes së veprës penale. IKD gjatë procesit të monitorimit të rasteve të korrupsionit por edhe veprave penale karakteristike ka gjetur se një numër i madh i rasteve të raportuara qoftë në polici apo prokurori që i takojnë fazës parapenale apo fazës së hetimit në procedurën penale mbyllën nga prokuroria pa kontroll gjyqësor.

Në tri vitet e fundit (2016, 2017, 2018) në procedurën parapenale pa kaluar përmes kontrollit gjyqësor janë mbyllur 889 raste me 1553 persona. Përderisa, gjatë të njëjtës periudhë kohore, PSh ka mbyllur rastet e hetimeve parapenale dhe penale ndaj 1794 personave që janë raportuar lidhur me dyshimet për vepra penale të korrupsionit. Prej tyre ndaj 1006 personave prokurorët kanë hudhur kallëzimet penale, kurse ndaj 788 personave kanë pushuar hetimet.

Kontrolli gjyqësor në rastet pushimit të hetimeve dhe hudhjes së kallëzimeve penale në bazë të ligjit në Kosovë nuk ekziston fare. Prokurori njofton gjykatën vetëm sa i përket pushimit të hetimit, përderisa gjykatësi nuk ka kontroll apo kompetencë për të vlerësuar nëse vendimi i prokurorit është i bazuar në ligj, apo nëse faktet dhe provat e grumbulluara janë të mjaftueshme për të proceduar me rastin në gjykim. Në rastet e hudhjes së kallëzimit penal, gjykata nuk pranon asnjë njoftim, lidhur me mbylljen e rastit. Ndaj vendimit të prokurorit të shtetit, nuk lejohet ankesë qoftë nga ana e parashtruesit të kallëzimit penal apo të të dëmtuarit nga vepra penale.

Për më tepër, Kodi i Procedurës Penale nuk lejon padinë private e as padinë subsidiare, kjo pasi Kodi Penal nuk parasheh asnjë vepër penale, e cila ndiqet sipas padisë private. Legjislacioni i aplikueshëm në Kosovë nuk mundëson ankesë ndaj vendimeve të prokurorit në rastet e hudhjes së kallëzimit penal apo të pushimit të hetimeve. Në këtë drejtim vendimi i prokurorit për të mbyllur rastet në këtë fazë të procedurës penale, është përfundimtar.


Një qasje e tillë e ndërtuar nga Kodi i Procedurës Penale bie në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, si dhe me aktet tjera ndërkombëtare që garantojnë dhe promovojnë të drejtat dhe liritë e njeriut.

Sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e drejta në ankesë dhe e drejta e qasjes në gjykatë, hyn në kuadër të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kushtetuta e Kosovës garanton se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Nga analiza e 100 rasteve të korrupsionit të mbyllura nga Prokuroria me vendim për pushimin e hetimeve apo vendim për hudhjen e kallëzimit penal, del se afati mesatar i trajtimit të këtyre 100 rasteve të korrupsionit prej ngritjes së kallëzimit penal deri në hudhjen e kallëzimit penal apo pushimin e hetimit është 1.180 ditë apo afërsisht tri vite. Rasti i korrupsionit, cili është trajtuar në kohën më të shpejtë në këto raste, ka marrë 21 ditë prej

pranimet të kallëzimit penal deri te hudhja e kallëzimit penal.¹⁴⁸ Ndërsa, rasti i korrupsionit, i cili është trajtuar në kohën më të gjatë 5415 ditë apo 15 vjet.

Rasti i cili është zgjidhur në afat rekord në rrethana të efikasitetit të sistemit prokurorial, rezulton të jetë rasti i hetimeve preliminare në lidhje me dyshimet për dosjen e falsifikuar të provimit të jurisprudencës së Aleksandër Lumezit, i cili si Kryeprokuror i Shtetit, i takon profilit të lartë. Rasti i dosjes Aleksandër Lumezi ishte ngritur më 25 tetor 2017 dhe është mbyllur për 21 ditë, përkatësisht më 14 nëntor 2017. Ndërsa, rasti ndaj dy zyrtarëve të profilit të ulët, ishte ngritur më 10 tetor 2001, ndërsa ishte mbyllur për 5415 ditë apo afër 15 vjet.



Grafika 11 – Mesatarja e kohës së trajtimit të rasteve, bazuar në 100 raste të analizuar nga IKD.

¹⁴⁸ Aktvendimi për hudhjen e kallëzimit penal në rastin e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi.

e. Dështimet në respektimin e Mekanizmit Përcjellës

IKD prej fillimit të monitorimit sistematik të sistemit prokurorial ka siguruar të dhënat e Mekanizmit Përcjellës të KPK-së. Vazhdimisht janë identifikuar raste të regjistruara me vonesë në Mekanizmin Përcjellës, duke krijuar bazë të arsyeshme të dyshimeve, se me lëndët e paregjistruara në këtë mekanizëm, prokurorët apo stafi kanë keqpërdorur detyrën dhe informacionet e këtyre rasteve në raport me palët e treta.

Në këtë drejtim, vazhdimisht kanë dështuar prokurorët, Kryeprokurorët dhe KPK që të sigurojnë respektimin e Mekanizmit Përcjellës, përmes së cilit mundësohet skanimi i gjendjes në lidhje me performancën individuale dhe të sistemit në lidhje me efikasitetin e trajtimit të lëndëve.

Regjistrimi me vonesë i rasteve të korrupsionit në Mekanizmin Përcjellës nga ana e prokurorëve vazhdimisht është ngritur si shqetësim nga IKD, për shkak se ky mekanizëm ka për qëllim harmonizimin e raporteve statistikore mes PSh-së dhe agjencive që e zbatojnë ligjin në Kosovë. Po ashtu, ky mekanizëm shërben edhe si mjet i rëndësishëm për Prokuroritë për të pasur informacion lidhur me numrin e lëndëve të korrupsionit në çdo prokurori. Përmes këtyre informacioneve KPK ka mundësinë që të bëjë politika adekuate për zbatimin e obligimeve kushtetuese dhe ligjore në ndjekje të kryesve të vepave penale.

Dështimet në respektimin e këtij mekanizmi krijojnë pasoja të mëdha për sistemin prokurorial dhe sistemin e drejtësisë, duke pamundësuar identifikimin e gjendjes reale të lëndëve të korrupsionit në sistemin prokurorial dhe duke pamundësuar hartimin e politikave adekuate për luftimin e veprave penale të korrupsionit. Mungesa e llogaridhënies është faktori kyç që pamundëson zbatimin me efikasitet të obligimeve për të respektuar rregullat e Mekanizmit Përcjellës. KPK kishte nxjerrë vendime për të mbajtur përgjegjës të gjithë ata që kanë dështuar në respektimin e vazhdueshëm të Mekanizmit Përcjellës, por vendimet kanë mbetur të pazbatuara, pasi askush nga Kryeprokurorët e as Koordinatorja Nacionale, nuk kanë raportuar për shqiptimin e masave ndaj personave përgjegjës.

f. Vonesat në procedimin e aktakuzave të korrupsionit nga prokurorët

IKD gjatë monitorimit të rasteve të korrupsionit në prokurori dhe gjykata ka vërejtur në praktikë fenomenin e zvarritjes së dërgimit të aktakuzave nga prokurorët në gjykata. IKD ka identifikuar me dhjetëra raste në të gjitha gjykatat e Kosovës.

Një prej rasteve me vonesën më të madhe është rasti në PTh në Prishtinë (Dega në Podujevë). Aktakuza me numër PP.nr. 600-14/2006, është konstatuar se është dërguar në gjykatë me vonesë prej 400 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori.¹⁴⁹

Prokurorët kanë për obligim që në momentin që e përpilojnë aktakuzën ta dorëzojnë atë në Gjykatë. Në të kundërtën, ngriten me të drejtë dyshime për abuzim me detyrën zyrtare nga

¹⁴⁹ Miftaraj E. dhe Musliu B. “Deti i korrupsionit në Kosovë: Peshqit e vegjël kapen, të mëdhënjtë lihen të lirë”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, mars 2017). Faqe 92. (shih linkun <https://kli-ks.org/deti-i-korrupsionit-ne-kosove-peshqit-e-vegjel-kapen-te-medhenjte-lihen-te-lire/>)

prokurorët dhe stafi i prokurorive. ZPD ka zhvilluar hetime preliminare në lidhje me këto gjetje të IKD-së në zvarritjen e procedimit të aktakuzave të prokurorëve në gjykatë, por asnjëherë nuk ka njoftuar publikun në lidhje me rezultatet përfundimtare.

g. Ngritja e aktakuzave jo-profesionale dhe dështimi i prokurorëve në gjykatë

IKD gjatë procesit të monitorimit të seancave gjyqësore në rastet e korrupsionit, në shumë raste ka gjetur se prokurorët e shtetit janë akuzuar qoftë nga gjykatësit e rastit, avokatët mbrojtës apo të pandehurit se aktakuzat e tyre janë jo-profesionale¹⁵⁰, të pa mbështetura në prova¹⁵¹, të ngritura pa shfrytëzuar të gjitha mundësitë që lejon Kodi i Procedurës Penale¹⁵² në raste të caktuara edhe persekutuese.

Rasti i shënjestruar kundër Naser Osmanit, deputet i Kuvendit të Kosovës dhe të tjerëve, ishte filluar nga Policia e Kosovës sipas kallëzimit penal të 28 prillit 2014, për veprë penale korruptive. PSRK më 30 prill 2014, kishte marrë aktvendim për fillimin e hetimeve, kurse kjo Prokurori më 16 shkurt 2016, kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Prishtinë.

Sipas aktakuzës së ngritur nga PSRK, të akuzuarit Naser Osmani, si nënkryetar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, së bashku me zyrtarë të tjerë të lartë në AKP ishin akuzuar se kishin shkelur të drejtat e punëtorëve të kësaj ndërmarrje, me çka njëkohësisht i kanë shkaktuar Buxhetit të Kosovës dëm prej 5.4 milion eurove. Shqyrtimi fillestar lidhur me këtë rast është caktuar më 17 mars 2016, por ishte shtyrë për 4 prill 2016. Në seancën e 4 prillit 2016, përderisa prokurori special Admir Shala ka lexuar aktakuzën, Naser Osmani dhe Bahri Shabani, pjesë e bordit të drejtorëve të AKP-së, nuk ishin deklaruar lidhur me fajësinë, me

¹⁵⁰ Hamdi Ibrahim, gjykatës për krime të rënda në Gjykatën Themelore në Prishtinë: Organi i ndjekjes ka qëndruar mbi 10 vjet në këtë lëndë me vetëm një provë që nuk ka provuar elemente të veprës penale, ndërsa ka shtuar se ka menduar se gjatë shqyrtimit gjyqësor prokuroria do të propozoi ndonjë ekspertizë apo provë tjetër. “Ka qenë rast interesant që prokuroria ka mbet pranë aktit akuzues me vetëm një provë, me të cilin nuk është manifestuar asnjë element i veprës penale. Rast eklatant i ndjekjes penale që ndiqet penalisht një person me asnjë provë, ky rast nuk duhet të ndodhë në të ardhmen”, kishte përfunduar Ibrahim në arsyetimin e vendimit të trupit gjykues”, në: <https://betimiperdrejtesi.com/rezimi-i-aktakuzes-me-vetem-nje-prove-gjykatesi-hamdi-ibrahimi-i-pergjigjet-reagimit-te-prokurorise-se-shtetit/>

¹⁵¹ Besnik Berisha avokat, Mbrojtësi i të akuzuarës Gorani, avokati Besnik Berisha, ka thënë se fatkeqësi që Mekaj është privuar nga e drejta e ushtrimit të profesionit si kryetar i Gjykatës edhe avancimit profesional. Sipas tij, ky është leksion për prokurorinë që të mos ngrit aktakuza pa e mbështetur me prova, në: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-apelit-salih-mekaj-lirohet-nga-te-gjitha-akuzat/>

¹⁵² Fatime Dermaku, Gjykatëse në Gjykatën Themelore në Prishtinë: “Nuk ka rëndësi prokurore pse thotë dispozita, ju keni pas mundësi që të gjithë këta dëshmitarë me i marr në pyetje, me i marr dëshmitarët, të pandehurin, të dëmtuarin, por s’keni marr mundim me i marr hiq. Keni ngritë aktakuzë me një deklaratë të vetme”. “Prokurore, ju po doni pafundësisht me ma zgjat procesin, merre k’to, merre ato, meri boni hetimet në prokurori”, i është përgjigjur gjykatësja, e cila shtoi se e ka për obligim të mbrojtë të drejtat e të gjitha palëve në procedurë, përfshirë edhe të akuzuarin, kur nuk ka mbrojtës. “Gjykata është për t’i mbrojtur të drejtat e njeriut, është konventa për gjykim të drejtë dhe të arsyeshëm dhe unë jam për t’i respektuar konventën dhe Kodin”, tha gjykatësja. Lidhur me këto deklarata, gjykatësja u shpreh se është e kënaqur me prezencën e monitorueses nga “Betimi për Drejtësi”, pasi që sipas saj, është mjaft mirë, pasi që seanca është e hapur dhe siç tha, të shihet se si zhvillohen procedurat në gjykatat tona. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/keni-ngrite-aktakuze-me-nje-deklarate-te-vetme-tensione-ne-seance-midis-prokurores-dhe-gjykateses/>)

arsyetimin se prezent duhet të jenë të gjithë anëtarët e bordit.¹⁵³ Shqyrtimi gjyqësor i këtij rasti ishte arrit të mbahet vetëm më 12 korrik 2017.

Pas 23 seancave gjyqësore, pesë nga të cilat kishin dështuar të mbaheshin dhe gati 3 vjet pas ngritjes së aktakuzës, më 8 shkurt 2019, deputeti Naser Osmani dhe të akuzuarit tjerë për rastin e njohur si “FAN”, Melita Ymeraga, Adrian Kelmendi, Bahri Shabani, Shkelzen Llluka dhe Naim Avdiu ishin shpallur të pafajshëm për keqpërdorim të pozitës zyrtare.

Gjykata lidhur me këtë rast ka dënuar vetëm një të akuzuar. Agim Deshishku ishte gjetur fajtor nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe ndaj tij ishte shqiptuar dënim unik prej 1 viti e 8 muajsh burgim, ku do t’i llogaritej edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak. Gjithashtu, sipas aktgjykimit të shpallur nga gjykatësi Shashivar Hoti, i akuzuari Agim Deshishku obligohej që dëmin prej 53,807.46 euro t’ia kompensojë Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), si dhe të paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në vlerë prej 300 euro. Ndërkaq, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) ishte udhëzuar në kontest civil. Sipas aktgjykimit, ishte refuzuar edhe kërkesa e prokurorisë për konfiskimin e ndërmarrjes “FAN”.¹⁵⁴

Rasti “Z-mobile”, ku të dyshuar janë Agron Mustafa, ish-drejtor i PTK-së dhe dy të tjerëve, është rast i shënjestruar. Më 22 dhjetor 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, pas disa publikimeve në media kishte dorëzuar lëndën PPN.nr.236/16 me të cilën kishte kërkuar nga Prokuroria Speciale ta trajtojë çështjen e kontestit në mes të PTK-së dhe “Z-mobile”, në procedurën e arbitrazhit, kontest të cilin, e kishte humbur PTK-ja, duke u detyruar që “Z-mobile”-it, t’ia përmbush detyrimin prej 32,856,407.28 euro. Pasi PSRK-ja, kishte filluar hetimet, e njëjta më 17 gusht 2018, kishte ngritur aktakuzë ndaj Drejtorit të PTK-së Agron Mustafa, ish-Drejtorit të PTK-së Ejup Qerimi dhe Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të PTK-së Rexhë Gjonbalaj, duke i ngarkuar ata me veprën penale “keqpërdorim të pozitës zyrtare” nga neni 422 i KPRK-së.

Shqyrtimi fillestar në këtë rast është caktuar më 27 shtator 2018.¹⁵⁵ Në shqyrtimin e dytë i cili ishte caktuar më 7 nëntor 2018, të akuzuarit kërkuan hudhjen e aktakuzës.¹⁵⁶ Ndërsa, më 7 dhjetor 2018, gjykatësi i rastit Lutfi Shala, kishte nxjerrë aktvendim me anë të së cilit kishte hudhur poshtë aktakuzën, për shkak se, sipas tij, nuk ishte vërtetuar që të akuzuarit kanë kryer veprën penale me të cilën ngarkoheshin. Edhe pse Prokuroria Speciale kishte pretenduar se

¹⁵³ “Fillon gjykimi, Naser Osmani dhe të tjerët në rastin e AKP-së deklarohen të pafajshëm”. Betimi për Drejtësi. 4 prill 2016. (Shih linkun <http://betimiperdrejtesi.com/fillon-gjykimi-naser-osmani-dhe-te-tjeret-ne-rastin-e-akp-se-deklarohen-te-pafajshem/>)

¹⁵⁴ “Deputeti Naser Osmani dhe të tjerët shpallen të pafajshëm për keqpërdorim pozite, dënohet Agim Deshishku”, Betimi për Drejtësi, 2 shkurt 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-naser-osmani-dhe-te-tjeret-shpallen-te-pafajshem-per-keqperdorim-pozite-denohet-agim-deshishku/>)

¹⁵⁵ “Agron Mustafa dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm për rastin e Z-Mobile”. Betimi për Drejtësi. 27 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/agron-mustafa-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem-per-rastin-e-z-mobile/>)

¹⁵⁶ “Agron Mustafa dhe dy të tjerët kërkojnë hudhjen e aktakuzës për rastin “Z-Mobile”. Betimi për Drejtësi. 7 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/agron-mustafa-dhe-dy-te-tjeret-kerkojne-hudhjen-e-aktakuzes-per-rastin-z-mobile/>)

tre të akuzuarit i kanë shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës rreth 30,000,000.00 euro dëm, sipas gjykatës, prokuroria nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale.¹⁵⁷ Pas ankesës së PSRK-së, Gjykata e Apelit, ka aprovuar këtë ankesë dhe ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë, duke i ka kërkuar së njejtës që të caktojë shqyrtimin gjyqësor.¹⁵⁸

Rasti Salih Mekaj, Kryetar i Gjykatës së Apelit, rast i shënjestruar. Më 31 maj 2016, PSRK ka ngritur aktakuzë në GjTh në Prishtinë, kundër ish-Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe anëtarit të KGJK-së, Salih Mekaj, për veprën penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Në rastin kundër Salih Mekaj, shqyrtimi fillestar është caktuar pesë muaj pas ditës së ngritjes së aktakuzës, apo rreth katër muaj pas afatit të paraparë me KPPK, respektivisht më 20 tetor 2016.

Seanca e 20 tetorit 2016 është shtyrë për shkak të mungesës së të akuzuarit Mentor Seferaj, i cili gjendej në paraburgim. Avokati Besnik Berisha, në këtë seancë, kishte kërkuar nga gjykata përjashtimin e publikut në këtë rast, si dhe mos publikimin e fotografive. Kërkesës së tij iu është bashkuar edhe përfaqësuesi i të akuzuarit Salih Mekaj, avokati Ramë Gashi. Edhe prokurorja e kësaj lënde Drita Hajdari është pajtuar për përjashtimin e publikut. Me këtë rast, gjykata duke u bazuar në nenin 294 të KPPRK-së ka marrë vendim që shqyrtimi gjyqësor për rastin në fjalë të jetë i mbyllur për publikun.¹⁵⁹

Ky proces gjyqësor, ishte rast i shënjestruar për liberalizimin e vizave por që ishte mbajtur larg syve të publikut për shkak të vendimit të gjykatës për ta mbyllur atë për median dhe publikun. Ndërsa gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor, prokurorja Drita Hajdari, kishte rikualifikuar veprën penale ndaj Mekajt, nga “keqpërdorim të pozitës zyrtare”, në “ushtrim i ndikimit”. Gjykata, më 28 maj 2018, shpalli aktgjykimin me të cilin i liroi të akuzuarit nga të gjitha akuzat.¹⁶⁰ Aktgjykimin e shkallës së parë, e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, e cila më 23 tetor 2018 i kishte liruar përfundimisht nga akuzat Mekajn dhe të tjerët.¹⁶¹ E pakënaqur me vendimet e shkallës së parë dhe të dytë, prokuroria me pretendimet se gjyqësori nuk ka vepruar drejt kur ka liruar Mekajn dhe të tjerët, me mjet të jashtëzakonshëm

¹⁵⁷ “Hudhet poshtë aktakuza ndaj Agron Mustafës dhe të tjerëve në rastin e “Z-Mobile”. Betimi për Drejtësi. 18 dhjetor 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-poshte-aktakuza-ndaj-agron-mustafes-dhe-te-tjereve-ne-rastin-e-z-mobile/>)

¹⁵⁸ “Apeli vendos që Agron Mustafa dhe ish-drejtesit tjerë të Telekomit të Kosovës të gjykohen për rastin “Z-Mobile” Betimi për Drejtësi 4 shkurt 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-vendos-qe-agron-mustafa-dhe-ish-drejtesit-tjere-te-telekomit-te-kosoves-te-gjykohen-per-rastin-z-mobile/>)

¹⁵⁹ “Shtyhet gjykimi ndaj ish-Kryetarit të Gjykatës së Apelit, Salih Mekaj dhe tre të akuzuarve tjerë, përjashtohet publiku”. Betimi për Drejtësi. 20 tetor 2016. (Shih linkun <http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-gjykimi-ndaj-ish-kryetarit-te-gjykates-se-apelit-salih-mekaj-dhe-tre-te-akuzuarve-tjere-perjashtohet-publiku/>)

¹⁶⁰ “Ish-kryetari i Apelit, Salih Mekaj lirohet nga të gjitha akuzat (Video)”. Betimi për Drejtësi. 28 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-apelit-salih-mekaj-lirohet-nga-te-gjitha-akuzat/>)

¹⁶¹ “Gjykata e Apelit vërteton pafajësinë e ish-kryetarit të saj, Salih Mekaj dhe tre të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 23 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-apelit-verteton-pafajesine-e-ish-kryetarit-te-saj-salih-mekaj-dhe-tre-te-tjereve/>)

për mbrojtje të ligjshemrisë i është drejtuar edhe Gjykatës Supreme, por edhe kjo gjykatë i ka vlerësuar si të drejta vendimet e shkallëve më të ulëta gjyqësore.¹⁶²

Rasti tjetër në të cilin Prokuroria ka dështuar ta mbroj aktakuzën në gjykatë ndërlidhet me ish-zyrtarin e Ministrisë së Tregëtisë dhe Industrisë, **Valdrin Lluka**, i cili aktualisht është ministër i Zhvillimit Ekonomik. Më 27 tetor 2016, PTh në Prishtinë, kishte ngritur aktakuzë ndaj Valdrin Llukës dhe Eliana Nakës, pas pretendimeve se të njëjtit duke qenë zyrtarë të Ministrisë së Tregëtisë dhe Industrisë, i kanë dhënë mbështetje financiare Organizatës Jo-Qeveritare “Jakova Innovation Center”, të cilën e drejtonte Naka, ndërsa e kishte themeluar Lluka.

Shqyrtimin fillestar ishte mbajtur me 26 janar 2017, ndërsa shqyrtimi i dytë, ishte mbajtur më 3 mars 2017, ku dy të akuzuarit kishin kërkuar që aktakuza e prokurorisë të hudhet poshtë, me pretendimin se e njëjta nuk është e bazuar në prova.¹⁶³

Pasi ishte konfirmuar aktakuza, shqyrtimin gjyqësor e udhëhiqte gjyqtari Hamdi Ibrahim. Më 23 korrik 2018, u mbajt dhe u përfundua i gjithë shqyrtimi gjyqësor, në të cilën të akuzuarit e dhanë edhe mbrojtjen e tyre.¹⁶⁴ Gjykata më 23 korrik 2018, kishte shpallur aktgjykimin, me të cilin e kishte shpallur të pafajshëm Llukën pasi shkalla e parë nuk e kishte provuar se i njëjti e ka kryer veprën penale të “konfliktit të interesit”, ndërsa për këtë vepër e kishte gjetur fajtores të akuzuarën Eliana Naka, e cila ishte dënuar me gjobë prej 7.000 euro.¹⁶⁵

Gjykata e Apelit më 10 tetor 2018 e ka vërtetuar aktgjykimin lirues ndaj ministrit aktual të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, i cili akuzohej për konflikt të interesit. Ndërsa, për të akuzuarën tjetër Eliana Naka, gjykata e shkallës së dytë e ka aprovuar si të bazuar ankesën e mbrojtëses së saj, duke e anuluar aktgjykimin e Themelores dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim¹⁶⁶

Rasti Abit Kastratit: Ndjekja 11 vjeçare e prokurorisë me vetëm një provë. Policia e Kosovës, më 10 tetor të vitit 2007 kishte ushtruar kallëzim penal ndaj Abit Kastratit, Shpresa Spahiut dhe Vehbi Azemit, pas dyshimeve se të njëjtit kanë “përvetësuar gjatë ushtrimit të detyrës”. Prokurorisë i ishin dashur gati shtatë vjet që të nxjerrë aktvendimin për fillimin e

¹⁶²“Edhe Supremja konfirmon pafajësinë e Mekajt”. Koha.net. 22 janar 2019. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/140997/edhe-supremja-konfirmon-pafajesine-e-mekajt/>)

¹⁶³ “Në rastin ndaj zyrtarëve të MTI-së të akuzuar për konflikt interesi, mbrojtja kërkon hudhjen e aktakuzës”. Betimi për Drejtësi. 3 mars 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ne-rastin-ndaj-zyrtareve-te-mti-se-te-akuzuar-per-konflikt-interesi-mbrojtja-kerkon-hudhjen-e-aktakuzes/>)

¹⁶⁴ “Valdrin Lluka thotë se nuk e ka menduar se veprimi për të cilin akuzohet mund të shkaktoj konflikt interesi”. Betimi për Drejtësi. 20 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/valdrin-lluka-thote-se-nuk-e-ka-menduar-se-veprimi-per-te-cilin-akuzohet-mund-te-shkaktoj-konflikt-interesi/>)

¹⁶⁵ “Valdrin Lluka lirohet nga akuza për konflikt interesi”. Betimi për Drejtësi. 23 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/valdrin-lluka-lirohet-nga-akuza-per-konflikt-interesi/>)

¹⁶⁶ “Apeli e liron përfundimisht nga akuza për konflikt interesi ministrin Valdrin Lluka, e kthen në rigjykim rastin e ish-sekretares së MTI-së”. Betimi për Drejtësi. 20 dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-liron-perfundimisht-nga-akuza-per-konflikt-interesi-ministrin-valdrin-lluka-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-ish-sekretares-se-mti-se/>)

hetimeve, ndërsa jashtë çdo praktike, pas gati 10 vjetësh nga kallëzimi penal, prokuroria, kishte ngritur aktakuzë ndaj Abit Kastratit, duke e ngarkuar atë me veprën penale “përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare”, të paraparë me nenin 340 të Kodit të Vjetër Penal.

Edhe pse i akuzuari Abit Kastrati, ishte në procedurë në prokurori për rreth 10 vjet, të njëjtit i ishin dashur që të priste edhe më shumë se një vit, deri sa gjykata ta mbante seancën fillestare më 20 korrik 2017, ku Kastrati u deklarua i pafajshëm.

Pasi kjo aktakuzë ishte konfirmuar edhe në shkallën e parë, e po ashtu edhe në atë të dytën, më 22 shkurt 2018, filloi dhe përfundoi shqyrtimi gjyqësor, pasi aty prokuroria prezantoi vetëm një provë - një procesverbal të firmës të 8 qershorit 2007, të komisionit prej tre anëtarësh të NTSH “Urata”, me anë të të cilit evidentohet se është bërë pranim dorëzimi i një ekskavatori, nga ish-punëtori i tyre.¹⁶⁷ Një ditë më pas, më 23 shkurt 2018, gjykata shpalli aktgjykimin sipas të cilit Kastrati u lirua, ndërsa aktakuzën e prokurorisë, gjyqtari Hamdi Ibrahim i cilësoi si një rast eklatant, me të cilin prokuroria e mban në procedurë një person me vetëm një provë, e cila nuk vërteton asnjë pretendim të prokurorisë.

Ndaj vendimit të Ibrahimit, kishte parashtruar ankesë prokuroria, por shkalla e dytë e kishte refuzuar atë ankesë, duke vërtetuar vendimin e shkallës së parë.¹⁶⁸

h. Parashkrimi i rasteve të korrupsionit

Sistemi prokurorial dhe gjyqësor në Kosovë vazhdon të përballet me problemin e vjetërsimit të lëndëve, i cili ka prekur edhe një numër të madh të lëndëve të korrupsionit.

Monitoruesit/hulumtuesit e IKD-së kanë raportuar vazhdimisht për rastet e korrupsionit, të cilat kanë arritur afatin e parashkrimit të ndjekjes penale qoftë ky parashkrimi relativ apo absolut, si në prokurori ashtu edhe në gjykata. Këto të fundit, në përputhje me ligjin, kanë shpallur aktgjykime refuzuese në rastet e parashkrimit absolut apo relativ të ndjekjes penale në rastet e korrupsionit.

Në tri vitet e fundit, IKD ka identifikuar 78 raste të parashkruara në Prokurori dhe Gjykata Themelore. Në të gjitha këto raste, sipas detyrës zyrtare, ZPD bazuar në gjetjet e IKD-së ka iniciuar procedura hetimore disiplinore.

Sikurse në prokurori ashtu edhe në gjykata, shumë lëndë të korrupsionit janë mbajtur në sirtarë me dekada, duke qëndruar të parashkruara me vite. Vlen të theksohen dy prej rasteve më skandaloze, të cilat dëshmojnë se gjykatësit, në raste të caktuara, nuk i japin prioritet rasteve të korrupsionit, pasi të njëjtat mbesin me vite në sirtarë, pa u trajtuar.

¹⁶⁷ “Prokuroria kërkon dënimin e të akuzuarit për përvetësimin e ekskavatorit, mbrojtja lirimine e tij”. Betimi për Drejtësi. 22 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-kerkon-denimin-e-te-akuzuarit-per-pervetesimin-e-ekskavatorit-mbrojtja-lirimine-e-tij/>)

¹⁶⁸ “Apeli vërteton aktgjykimin që rrezoi aktakuzën me vetëm një provë që solli reagimin e Prokurorit të Shtetit dhe të KGJK-së”. Betimi për Drejtësi. 22 qershor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-aktgjykimin-qe-rrezoi-aktakuzen-me-vetem-nje-prove-ge-solli-reagimin-e-prokurorit-te-shtetit-dhe-te-kgjk-se/>)

- **Rasti 1: “Pas 15 vitesh, për shkak të parashkrimit të lëndës, shpallen të pafajshëm të akuzuarit për përvetësim detyre”**

Me 15 korrik 2016, Gjykata Themelore në Mitrovicë shpalli aktgjykim refuzues ndaj Vojislav Mihajloviq dhe Ljuban Milosavljeviq¹⁶⁹, të cilët akuzoheshin për përvetësim të detyrës zyrtare në vitin 2001, me arsyetimin se vepra penale ka arritur afatin e parashkrimit. Në arsyetimin e aktgjykimit, është thënë se meqenëse vepra penale është kryer në vitin 2001, gjykata detyrimisht ka aplikuar dispozitat e ligjit të ri, i cili është më i favorshëm për të pandehurit.

- **Rasti 2: “Parashkruhet lënda ndaj dy doganierëve të akuzuar për korrupsion, nuk mbahet asnjë seancë që nga ngritja e aktakuzës më 2013”**

Me 18 dhjetor 2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur ndaj Mustafë Deskut dhe Shukrie Muqolli-Muratit¹⁷⁰, të akuzuar se si doganierë të Doganës kishin keqpërdorur pozitën zyrtare, Gjykata Themelore në Prishtinë ka marrë aktgjykim refuzues për shkak se vepra penale ka arritur parashkrimin.

Në këtë rast për të cilin për “shmangie mashtruese nga taksat e importit dhe akcizës”, akuzoheshin edhe Real Rama dhe Naman Pacolli, nuk është mbajtur asnjë seancë prej përpilimit të aktakuzës më 17 maj të vitit 2013.

Ndryshe, ndër personat ndaj të cilëve është shpallur aktgjykim refuzues për shkak të arritjes së parashkrimit të veprës penale është edhe rasti i ish-kryetarit të Komunës së Dragashit, Salim Jenuzi¹⁷¹ dhe ish-gjyqtarës, tani avokates Shemsije Sheholli¹⁷².

i. Dështimet në ndjekje të rasteve të publikuara nga media dhe shoqëria civile

Gazetarë nga media të ndryshme në Kosovë si dhe përfaqësues të shoqërisë civile kanë ngritur debate dhe kanë raportuar lidhur me dyshimet për raste të ndryshme të shkeljes së ligjit nga funksionarë të caktuar publik. Në mesin e këtyre raportimeve për shkelje të ligjit, në raste jo të rralla raportohen veprime të cilat hyjnë në sferën inkriminuese, duke prezantuar elemente veprave penale që hyjnë në kapitullin e korrupsionit. Puna e raportimit të këtyre

¹⁶⁹ “Pas 15 vitesh, për shkak të parashkrimit të lëndës, shpallen të pafajshëm të akuzuarit për përvetësim detyre”. Betimi për Drejtësi, 15 korrik 2016. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pas-15-vitesh-per-shkak-te-parashkrimit-te-lendes-shpallen-te-pafajshem-te-akuzuarit-per-pervetesim-detyre/>)

¹⁷⁰ “Parashkruhet lënda ndaj dy doganierëve të akuzuar për korrupsion, nuk mbahet asnjë seancë që nga ngritja e aktakuzës më 2013”. Betimi për Drejtësi. 18 dhjetor 2018. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/parashkruhet-lenda-ndaj-dy-doganierëve-te-akuzuar-per-korrupsion-nuk-mbahet-asnje-seance-qe-nga-ngritja-e-aktakuzes-me-2013/>)

¹⁷¹ “Aktgjykim refuzues ndaj ish-kryetarit të Dragashit, shpallet i pafajshëm i akuzuari për uzurpim prone”. Betimi për Drejtësi. 9 tetor 2018. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-refuzues-ndaj-ish-kryetarit-te-dragashit-shpallet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-uzurpim-prone/>)

¹⁷² “Parashkruhet lënda penale ndaj ish-gjyqtarës Shemsije Sheholli”. Betimi për Drejtësi. 11 korrik 2017. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/parashkruhet-lenda-penale-ndaj-ish-gjyqtarës-shemsije-sheholli/>)

përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe medieve, në shumicën e rasteve përfundon me publikimin e raporteve të tyre, për shkak të neglizhencës së organeve ndjekëse, të cilat nuk ndjekin gjurmët për zbulimin e korrupsionit.

Me Vendim të Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, më 17 qershor 2015, ishte themeluar Komisioni për monitorimin dhe përcjelljen ditore dhe verifikimin e pretendimeve të rasteve të supozuara të krimit të organizuar e të korrupsionit, të publikuara përmes mjeteve elektronike e të shtypit, të parashtresave të qytetarëve dhe paraqitjeve publike të zyrtarëve të organeve e organizatave shtetërore e publike dhe të organizatave joqeveritare.

IKD ka monitoruar punën e këtij komisioni në aspektin e veprimeve të ndërmarra, duke paraqitur kërkesa për qasje në informacion lidhur me punën e Komisionit, në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. IKD vazhdimisht ka shtruar një varg pyetjesh për veprimtarinë dhe funksionimin e këtij Komisioni, të cilat kanë mbetur pa përgjigje. Mungesa e transparencës së këtij Komisioni, është tejet shqetësuese dhe krijon dyshime rreth funksionimit të këtij Komisioni, sipas vendimit të Kryeprokurorit. Për me tepër, mbyllja e këtij Komisioni, duke mos dhënë informacione lidhur me punën e tij, ngritë dyshime se ky Komision është themeluar vetëm në letër, përderisa realiteti dëshmon se ky Komision, nuk është duke përmbushur obligimet që dalin nga Vendimi i Kryeprokurorit të Shtetit.

j. Dosja e manipuluar e provimit të jurisprudencës së Kryeprokurorit të Shtetit

Dyshimet e ngritura në publik lidhur me falsifikimin e provimit të jurisprudencës së Kryeprokurorit të Shtetit (KSH), Aleksandër Lumezi, në bazë të legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë, hyn në kuadër të rasteve të profilit të lartë. Sipas këtij legjislacioni, rastet e profilit të lartë duhet të trajtohen nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), që në rastin konkret nuk ka ndodhur. PSRK gjatë tërë kohës sa janë zhvilluar procedurat në këtë rast ka qëndruar në heshtje të plotë. Një qasje e tillë në publik vë në dyshim pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin e kësaj prokurorie. Ky rast i hetuar dhe mbyllur për 21 ditë në mënyrë të kundërligjshme, duhet të hetohet nga PSRK. Ndryshe, ky rast është udhëhequr nga prokurori Kujtim Munishi, njëherësh Shef i Departamentit për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

I gjithë procesi i hetimeve parapenale të prokurorit Kujtim Munishi është i kundërligjshëm.¹⁷³ Ky prokuror prej ardhjes së Aleksandër Lumezit në krye të ZKPSH është privilegjuar, duke arritur për një kohë të shkurtër në krye të Departamentit të Krimeve të Rënda në PTh në Prishtinë.

Edhe pse kjo lëndë sipas kompetencave ligjore është dashur të hetohet nga PSRK-ja, Prokurori Kujtim Munishi ka vendosur ta hetojë dosjen e shefit të tij, Kryeprokurorit Lumezi.

¹⁷³ Miftaraj E. dhe Musliu B. “*Dosja e manipuluar e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi*”. Instituti i Kosovës për Drejtësi”. Prishtinë, nëntor 2017. (Shih linkun <https://kli-ks.org/dosja-e-manipuluar-e-kryeprokurorit-te-shtetit-aleksander-lumezi/>)

Por, çdo veprim i ndërmarrë nga Munishi është në kundërshtim me ligjin. Ai ka autorizuar hetuesit e policisë që në procedurë parapenale të grumbullojnë informata, të marrin në pyetje dëshmitarë brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës, si dhe të sekuestrojnë dosje pa vendim të gjykatës dhe gjithë kjo për një vepër penale, e cila sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë kishte kohë që ka arritur afatin e parashkrimit të ndjekjes penale. Kjo ndalohet me ligj të aplikueshëm në Kosovë, por Munishi ka bërë hetime parapenale për vepër të parashkruar, për të cilin veprim vetë ai duhet të bëhet pjesë e procedurave hetimore disiplinore.

Prokurori Kujtim Munishi, në rastin konkret asnjëherë nuk ka zhvilluar procedurë penale lidhur me dyshimet për falsifikim të dosjes së provimit të jurisprudencës së Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, respektivisht nuk ka ndërmarrë veprime hetimore lidhur me dyshimin e kryerjes së veprës penale të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 434, e cila si të dyshuar të denoncuar publikisht njëjste Kryeprokurorin e Shtetit, Aleksandër Lumezi. Pra, prokurori Munishi, kundërligjshëm ka hetuar një vepër penale të parashkruar, për çka vetë duhet të bëhet subjekt i hetimit, ndërsa ka amnistuar në tërësi çdo mundësi që ta hetojë shefin e tij, Kryeprokurorin Lumezi. Ky i fundit, ishte denoncuar publikisht si i dyshuar për falsifikimin e provimit të jurisprudencës, prandaj prokurori Munishi vërehet qartë se ka bërë amnistinë e shefit, për arsye të cilat vetëm ai mund t'i dijë, por të cilat bien në kundërshtim me ligjin.

Në hetimin parapenal, prokurori Munishi, apriori ka amnistuar dyshimet e ngritura se Aleksandër Lumezi e ka falsifikuar provimin e jurisprudencës. Tërë hetimin e ka bazuar përmes marrjes së dëshmimeve të dëshmitarëve në mënyrë të kundërligjshme, tërë hetimi i tij nuk ka pasur asnjë të dyshuar, dhe ka sekuestruar dosje pa urdhër të gjykatës dhe nuk e ka bërë asnjë ekspertizë grafologjike, si dhe ekspertizë tjetër të dokumenteve që do të vërtetonin dyshimet për falsifikim në dokumentet e manipuluar: Mbyllja e rastit është bazuar në tërësi në dëshmitë e ish-zyrtarëve serb të caktuar në pozita në kohën e masave të dhunshme në vitet e 90-ta, pas suprimimit të Autonomisë së Kosovës, kurse dëshmia e avokatit Betim Shala nuk vërteton asgjë sepse është një supozim, i cili në procedurë penale nuk konsiderohet provë..

Prokurori Munishi nuk ka bërë administrimin e provave të ofruara nga dëshmitari Adil Fetahu. Ai ka qenë anëtar i Komisionit Konsultativ Juridik, i cili e ka intervistuar Aleksandër Lumezin në vitin 2000 kur kishte konkurruar për gjykatës dhe prokuror. Në procesverbal shkruan se Aleksandër Lumezi nuk e ka pasur provimin e jurisprudencës. Një tjetër procesverbal i këtij Komisioni, nxjerr në pah se në vitin 2000, ish-Shefi i UNMIK-ut Bernard Kushner, kishte dekretuar 31 kandidatë jashtë propozimeve të Komisionit, kur edhe ishin dekretuar kandidatët pa provim të jurisprudencës, pra që nuk e kishin të dhënë provimin në fjalë. Asnjëra prej këtyre provave që janë procesverbale të vitit 2000 nuk janë administruar nga Prokuroria.

Për më tepër, mbetet e paqartë se si prokurori Munishi është ngutur për mbyllur rastin pa sigurimin e dosjeve të UNMIK-ut dhe OSBE-së, të cilat do të mund të qartësonin nëse Aleksandër Lumezi ka pasur provim të jurisprudencës në vitin 2000, si dhe nëse Aleksandër Lumezi është njëri nga 31 kandidatët e dekretuar pa provim të jurisprudencës apo nëse e ka pasur atë në atë kohë kritike. Kjo në praktikën gjyqësore është e paparë ndonjëherë, duke lënë

hapësirë për të ngritur dyshime se qëllimi në këtë rast ka qenë mbyllja e shpejtë e rastit dhe jo zbardhja e së vërtetës.

Në këtë proces hetimor parapenal Munishi nuk ka pasur asnjë person të dyshuar, por vetëm dëshmitarë. Në Kosovë, në cilësinë e dëshmitarit janë marrë në pyetje: Sahit Shala, Radislav Dimitrijevic, Aleksandër Lumezi, Riza Smaka, Adil Fetahu, Enver Hasani, Betim Shala dhe Zymer Krasniqi.

Ndërsa, pa pasur vendim për fillim të hetimeve dhe në kundërshtim me Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar ka marrë prova dhe dëshmitarë jashtë rrugës zyrtare ligjore. Në këtë drejtim, ka marrë si provë një akt të noterizuar të Djordje Aksic, i cili figuron si ish-anëtar i Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës në vitin 1991 dhe si ish-Sekretar Krahinor në kohën e masave të dhunshme në Kosovë. Ndërsa, ka marrë në pyetje Miladin Kostic, gjithashtu ish-anëtar i Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës në vitin 1991.

Asnjë prej këtyre dëshmive nuk vërteton dhënien e provimit të jurisprudencës, përderisa në tërësi dosja është e manipuluar me llak të bardhë, mbi dosjen e Zymer Krasniqit dhe nuk ka një ekspertizë grafologjike (*dhe ekspertizë tjetër relevante*) për të.

Dyshimet e ngritura në publik se Aleksandër Lumezi e ka të falsifikuar provimin e jurisprudencës dhe gjithë proces i hetimeve parapenale të zhvilluara nga prokurori Kujtim Munishi është përshkruar me paragjykime dhe ndërhyrje nga politika, qeveria dhe vetë sistemi prokurorial. Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë disa deklaratë, duke i paragjykuar hetimet e prokurorisë, se ato, do të përfundojnë për një kohë të shkurtër, duke bërë ndërhyrje politike dhe të ekzekutivit në hetimet që ishin duke u zhvilluar në këtë rast.

Në anën tjetër, KPK e ka paragjykuar në tërësi çdo dyshim të ngritur rreth dosjes së falsifikuar të provimit të jurisprudencës së Aleksandër Lumezit, duke kërkuar tërheqjen e akuzave dhe shkrimeve për këtë temë. Njëjtë i kanë dalë në mbrojtje eprorit të tyre edhe Shoqata e Prokurorëve të Kosovës (SHPK), e cila ka paragjykuar në tërësi pretendimet e ngritura rreth provimit të jurisprudencës së Lumezit.

Ky rast siç ka deklaruar EULEX-i ishte monitoruar nga prokurorja e këtij misioni, e cila ishte shprehur e kënaqur me hetimin e pavarur dhe të paanshëm. Por, Misioni i EULEX-it, nuk ishte deklaruar nëse ky ishte edhe qëndrim zyrtar i këtij misioni, apo vetëm qëndrim dhe opinion i prokurores monitoruese.

Hetimi i deritashëm në procedurë penale rezulton të jetë i pavlefshëm, *nul*. Në këtë drejtim, me qëllim të zbardhjes së të vërtetës dhe zhvillimit të një procesi hetimor të pavarur, të paanshëm, të drejtë dhe profesional, rekomandohet që në pajtim me obligimet kushtetuese dhe ligjore këto dyshime të ngritura në publik të hetohen nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRKS). Të gjitha kushtet ligjore për hetimin e këtij rasti nga PSRK janë të plotësuara dhe rekomandohet poashtu që hetimi të zhvillohet përmes krijimit të një ekipi të prokurorëve të EULEX-it me prokurorë amerikanë, britanikë dhe gjermanë.

IKD ka rekomanduar që PSRK-ja të kërkojë ekspertizë të të gjitha dokumenteve të manipuluar me llak dhe të tjerave që dyshohet se janë falsifikuar. KPK-ja deri në zbardhjen e këtij rasti, në pajtim me ligjin e aplikueshëm, duhet të marrë masa lidhur me suspendimin e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, ndërsa PSRK-ja dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor duhet të analizojnë aktvendimin për hudhjen e kallëzimit penal nga prokurori Munishi, si dhe të hetojnë nëse gjatë trajtimit të këtij rasti është zbatuar ligji dhe procedurat sipas legjislacionit në fuqi. Ende nuk ka asnjë veprim në drejtim të zbatimit të këtyre rekomandimeve, rrjedhimisht obligimeve ligjore.

k. Integriteti i kontestuar i prokurorëve dhe gjykatësve lidhur me përfitimin nga rritja e pagave

Vendimi i kundërligjshëm i pushtetit ekzekutiv për ngritjen e pagave, i cili ka ndikuar drejtpërdrejt në ngritjen e pagave të gjykatësve dhe prokurorëve është dëshmia më e fuqishme për integritetin e kontestuar të bartësve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Loja me pushtetin gjyqësor me pagat e gjykatësve dhe prokurorëve, ka një historik të gjatë, prej përfundimit të luftës në Kosovë. Ekzekutivi vazhdimisht ka krijuar varshmëri të gjykatësve dhe prokurorëve ndaj ekzekutivit, të cilët janë ndikuar në masë të madhe nga politika. Kjo e fundit, përmes Kuvendit të Kosovës në vitin 2010, kishte miratuar Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit, duke ndërtuar standardin e nivelizimit të pagave për gjykatës dhe prokurorë me pagat në ekzekutivin e vendit, respektivisht pagat e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurorit të Shtetit ishin barazuar me pagën e Kryeministrit të vendit, përderisa pagat e prokurorëve dhe gjykatësve ishin nivelizuar me pagat e ministrave në qeveri. Kjo ishte hera e parë që ishte krijuar një ekuivalencë në pagat bazë në mes të pushtetit ekzekutiv dhe pushtetit gjyqësor.

IKD e cila monitoron sistematikisht sistemin e drejtësisë, por edhe organizata të tjera vendore dhe ndërkombëtare, përmes raporteve, si Raporti i Progresit të Komisionit Evropian dhe Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit kanë ngritur shqetësimet për ndikimin politik në sistemin e drejtësisë.

Si rezultat i këtyre ndikimeve politike në pushtetin gjyqësor dhe prokurorial, nuk ka pasur asnjë reagim nga përfaqësuesit e këtyre pushteteve, në dhjetor të vitit 2017, kur Qeveria e Kosovës në mënyrë të kundërligjshme përmes një vendimi ka ngritur pagat për vete, rrjedhimisht edhe për gjykatësit dhe prokurorët.

Për dallim prej pushtetit gjyqësor e prokurorial, të cilët kanë qenë përfitues të rritjes së pagave, IKD ka reaguar publikisht ndaj Vendimit Nr. 4/20, të Qeverisë Haradinaj të miratuar më 20 dhjetor 2017 për rritjen e pagave të pushtetarëve, gjykatësve dhe prokurorëve. Ndaj këtij vendimi kanë reaguar edhe Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë dhe organizatat e tjera.

Përmes këtij vendimi, pothuajse janë dyfishuar pagat e pozitive të lart përmendura. Paga e Kryeministrit të Kosovës, është ngritur në 2950 euro, përderisa paga e Zëvendëskryeminstre është ngritur në 2500 euro. Pagat e Ministrave me këtë vendim janë ngritur në 2000 euro. Po ashtu pagat e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurorit të Shtetit, ishin ngritur në 2950 euro.

Vendimi i Qeverisë, sipas analizës ligjore të IKD-së, kishte tejkaluar kompetencat e përcaktuara me Ligj dhe me Rregulloren e Punës së Qeverisë, e cila në asnjë dispozitë të saj nuk përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Qeverisë për caktimin e pagave apo kompensimit për Kryeministrin apo ministrat. Në bazë të Kushtetutës dhe ligjit të aplikueshëm në Kosovë, kompetente për të vendosur lidhur me pagat e funksionarëve të lartë publik në Kosovë, veçanërisht për pozitën e Kryeministrit dhe ministrave është Kuvendi i Kosovës. Prandaj, ky vendim nga IKD është konsideruar i kundërligjshëm dhe ndërhyrje arbitrare e drejtpërdrejtë në kompetencat e Kuvendit të Kosovës. Vendimi i miratuar nga Qeveria Haradinaj, përveç që është bërë në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm, i njëjti është bërë pa analizë ligjore adekuate dhe pa vlerësim apo konsultim lidhur me ndikimin financiar që ky vendim ngërthen në vete për buxhetin e pushtetit ekzekutiv dhe pushtetin gjyqësor.

Edhe pse ky vendim ka qenë i kundërligjshëm, nuk ka pasur asnjë reagim nga organi ndjekës – Prokurori i Shtetit. Ndryshe prej Prokurorit të Shtetit, ka pasur një reagim nga Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK). Sipas AKK-së, vendimi lidhur me ngritjen e pagave bie në kundërshtim me Kodin Penal të Kosovës, respektivisht nenin 424, i cili përcakton situatat e konfliktit të interesit në rastet kur zyrtarët e lartë shtetërorë marrin pjesë personalisht në ndonjë çështje zyrtare në të cilën ai apo ndonjë anëtar i familjes ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të ka interes financiar. Për këtë gjendje të konfliktit të interesit, ka zbatuar mandatin edhe AKK, e cila ka njoftuar Qeverinë se vendimi për pagat paraqet konflikt të interesit dhe se i njëjti nuk mund të zbatohet, ndryshe kjo përbën vepër penale. Tash për tash, AKK është e duke hetuar rastin e konfliktit të interesit për pagat, ndërsa për të njëjtin vendim Lëvizja Vetëvendosje ka parashtruar një kallëzim penal, i cili gjendet në PSRK. Ende nuk dihet se cilat janë veprimet e ndërmarra për hetimin e këtij rasti nga kjo prokurori. Edhe pse rasti duket të jetë shumë i qartë, sidomos pas opinionit të shprehur nga AKK, si agjencion i speciaizuar për konfliktin e interesit, prokuroria nuk ka dhënë shenja në publik se është duke vepruar në ndjekje të këtij rasti.

Mosveprimi deri në këtë fazë, dëshmon se integriteti i sistemit prokurorial dhe gjyqësor është i kontestuar sepse të gjithë këta bartës të funksioneve prokuroriale dhe gjyqësore janë juristë me përvojë dhe pas opinionit të AKK-së dhe deponimit të kallëzimit penal për këtë vendim, nuk do duhej të përfitonin nga ky vendim i kontestuar në rrugën penale. Përfitimi nga një vendim i kundërligjshëm, për të cilin nesër mund të ketë një precedent penal, dëshmon integritetin e kontestuar të bartësve të funksioneve prokuroriale dhe gjyqësore, të cilët përkujdesen për interesin personal por jo edhe për zbatimin e ligjshmërisë.

XI. Llogaridhënia e prokurorëve dhe gjykatësve pas raportimeve të IKD-së

Gjatë këtyre tri viteve (2016, 2017, 2018) Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD) ka angazhuar në mënyrë të veçantë stafin e inspektorëve në trajtimin e gjetjeve të raporteve periodike të IKD-së. Si rezultat i gjetjeve të IKD-së të publikuara në shtatë raporte, ZPD deri më tash ka përfshirë mbi 850 raste në hetime preliminare ndaj prokurorëve dhe gjykatësve. Rreth trajtimit të këtyre rasteve, ZPD më nuk ka sistemuar të dhëna të veçanta për të parë progresin e trajtimit të këtyre lëndëve. Sidoqoftë, për herë të fundit, ZPD ka njoftuar se prej raporteve të IKD-së, prej këtyre rasteve të hetimeve preliminare, në hetime disiplinore janë përfshirë 25 lëndë të prokurorëve, ku përfshihen 17 raste. Prej tyre 9 raste me shkelje të vërtetuara disiplinore nga ZPD janë dërguar në Komisionin Disiplinor të KPK-së. Nga rastet e iniciuara nga gjetjet e IKD-së, 4 hetime disiplinore janë mbyllur me gjetje, 4 hetime disiplinore janë në procedurë të hetimit, 39 lëndë janë refuzuar, 246 lëndë janë refuzuar pas hetimit preliminar.¹⁷⁴ Vetëm për raportin e publikuar nga IKD në mars 2017, ZPD ka iniciuar hetime preliminare në 178 lëndë të korrupsionit të trajtuara nga prokurorët dhe gjykatësit.¹⁷⁵

Sa i përket gjetjeve nga raporti i IKD-së “Luftimi i korrupsionit, prioritet në letër” i publikuar më 10 dhjetor 2015, ZPD ka kryer hetime preliminare për të gjitha rastet e evidentuara (56 lëndë) dhe ka marr një numër të madh të deklaratave nga prokurorët të cilët kanë qenë të ngarkuar me lëndët e përshkruara si në raport. Është kërkuar nga prokurorët të deklarohen lidhur me gjetjet e IKD-së, përkatësisht ZPD-së. Pas grumbullimit të informacioneve, shqyrtimit dhe analizimit të tyre, ZPD ka konsideruar se, të gjeturat duhet dërguar për vlerësim në Komisionin për Shqyrtimin e Performacës së Prokurorëve në KPK. Veprimi i tillë është bërë nga ZPD sepse gjetjet pretendohet se, kanë të bëjnë me performancën e prokurorëve në punë. Pasi që raporti me gjetje është dërguar në Komisionin për Shqyrtimin e Performacës së Prokurorëve në KPK, ZPD është informuar nga Kryesuesi i KPK-së se raportin e ka dërguar për vlerësim në Komisionin e lartë cekur.

Sa i përket gjetjeve nga raporti i IKD-së “Korrupsioni në Kosovë: Luftimi apo promovimi i korrupsionit” i publikuar më 27 prill 2016, ZPD ka kryer hetime preliminare (grumbullimi i informacioneve të 111 lëndëve) për të gjitha rastet e evidentuara dhe ka marr një numër të madh të deklaratave nga prokurorët (22 deklarata) të cilët kanë qenë të ngarkuar me lëndët e përshkruara si në raport. Është kërkuar nga prokurorët të deklarohen lidhur me gjetjet e IKD-

¹⁷⁴ *Burimi:* Të dhënat zyrtare të ZPD-së të ofruara përmes postës elektronike për IKD. Dhjetor 2017.

¹⁷⁵ *Burimi:* Ish-Drejtori i ZPD-së, z. Zef Prendrecaj në një përgjigje me shkrim përmes postës elektronike ka njoftuar se vetëm për dy raportet e fundit të IKD-së, janë iniciuar 257 hetime preliminare në lëndët e korrupsionit të trajtuara nga prokurorët. “Raporti i VI – Korrupsioni në Kosovë: Luftimi apo promovimi i korrupsionit (27.04.2016) Në lidhje me të gjeturat nga ky raport, ZPD ka kryer hetime preliminare (grumbullimi i informacioneve të 111 lëndëve) për të gjitha rastet e evidentuara dhe ka marr një numër të madh të deklaratave nga prokurorët (22 deklarata) të cilët kanë qenë të ngarkuar me lëndët e përshkruara si në raport. Është kërkuar nga prokurorët të deklarohen me të gjeturat e IKD-së, përkatësisht ZPD-së. Raporti i VII – Korrupsioni në Kosovë: Retorika në luftimin e Korrupsionit (27.10.2016) Në lidhje me të gjeturat nga ky raport, ZPD është duke ndërmarr hetime preliminare (grumbullimi i informacioneve të 146 lëndëve). Pas grumbullimit të informacioneve, shqyrtimit dhe analizimit të tyre, ZPD, do t’ju mbajë të informuar me epilogun e rasteve dhe të gjeturat.” IKD intervistë me z. Zef Prendrecaj, Ish-Drejtor i ZPD-së. Mars 2017.

së përkatësisht ZPD-së. Njëjtë edhe këto raste janë dërguar për vlerësim në Komisionin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve në KPK.

Sa i përket gjetjeve nga raporti i IKD-së, “Korrupsioni në Kosovë: Retorika në luftimin e Korrupsionit” i publikuar më 27 tetor 2016, ZPD është duke ndërmarrë hetime preliminare (grumbullimi i informacioneve të 146 lëndëve). ZPD ka bërë grumbullimin e gjitha informacioneve relevante, ka bërë shqyrtimin dhe analizimin e tyre dhe njëjtë i ka dërguar për vlerësim në Komisionin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve në KPK.

Sa i përket gjetjeve nga raporti i IKD-së, “Korrupsioni në Kosovë: Deti i Korrupsionit në Kosovë” i publikuar më 28 mars 2017, ZPD është duke ndërmarrë hetime preliminare (grumbullimi i informacioneve të 178 lëndëve).

Sa i përket gjetjeve nga raporti i IKD-së, “Luftë, persekutim apo amnisti në emër të luftës kundër korrupsionit?” i publikuar më 21 dhjetor 2017, ZPD është duke ndërmarrë hetime preliminare (grumbullimi i informacioneve të 283 lëndëve).

RASTET E HETIMEVE NGA ZYRA E PROKURORIT DISIPLINOR TË INICUARA PREJ RAPORTEVE TË IKD-SË									
Raportet e publikuara të IKD-së	Lëndë të përfshira në hetime preliminare	Lëndë të përfshira në hetime disiplinore	Raste të përfshira në hetime disiplinore	Hetime disiplinore të dërguara në Komisionin Disiplinor	Hetime disiplinore të mbyllura me gjetje	Hetime disiplinore në procedurë të hetimit	Lëndë të përfshira në refuzim	Refuzim pas hetimit preliminar	Rastet në fazën e vendosjes
Korrupsioni në Kosovë - I –	26	21	14	6	4	4	5	1	
Korrupsioni në Kosovë - II –	16	1	1	1			15	1	
Korrupsioni në Kosovë - III -	29							29	
Korrupsioni në Kosovë-IV -	22	3	2	2			19	2	
Luftimi i korrupsionit në Kosovë, prioritet në letër (10.12.2015)	56							56	
Luftimi apo promovimi i korrupsionit (27.04.2016)	111							111	
Retorika në luftimin e korrupsionit (27.10.2016)	146							146	
“Deti” i Korrupsioni në Kosovë (28.03.2017)	178								178
Luftë, persekutim apo amnisti në emër të luftës kundër korrupsionit? (21.12.2017)	283								283
Total:	867	25	17	9	4	4	39	246	461

Tabela 19 – Rastet e hetimeve të iniciuara nga ZPD prej gjetjeve të raporteve të IKD-së.

ZPD vazhdimisht është sfiduar në punën e saj për zhvillimin e hetimeve në rastet e gjetjeve nga raportet e IKD-së. Drejtuesit e ZPD-së vazhdimisht kanë vlerësuar se pas grumbullimit të shkresave, informacioneve dhe veprimeve të tjera që ka ndërmarrë bazuar në gjetjet e raporteve të IKD-së kanë vërejtur se ka filluar të përmirësohet puna për rastet e ngjashme

(gjetjet në raporte) përkatësisht të ngritet llogaridhënia e prokurorëve dhe gjykatësve. Tash për tash, ZPD është në proces të shuarjes për shkak të ndryshimit të kornizës ligjore për disiplinimin e gjykatësve dhe prokurorëve. Zyrtarët që janë duke udhëhequr aktualisht këtë zyrë kanë thënë nuk kanë informacione të selektuara për rastet e iniciuara të hetimeve,¹⁷⁶ duke pamundësuar përcjelljen e progresit të rasteve të iniciuara nga raportet e IKD-së.

¹⁷⁶ IKD ka pranuar një përgjigje zyrtare përmes postës elektronike nga Ushtruesi i Detyrës së ZPD-së, z. Arianit Salihu. “Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD), Ju njofton se aktualisht nuk kemi ndonjë raport të Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) në punë. Edhe për kundër se raportet e IKD-së, kanë përmbajt një numër të madh të lëndëve gjyqësore dhe prokuroriale, ZPD të njëjtat i ka iniciuar sipas detyrës zyrtare, ka zhvilluar hetimet preliminare disiplinore duke i siguruar kopjet e shkresave relevante të lëndëve dhe aty ku ka konsideruar të nevojshme, ka siguruar edhe deklaratë nga bartësit e funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale. Po ashtu, Ju njoftojmë se ZPD ka përcjell emisionet e “Betimi për Drejtësi” apo edhe publikimet në ëeb faqen e Juaj (portalin Betimi për Drejtësi) dhe aty ku ka konsideruar se ekziston dyshimi i arsyeshëm se një gjyqtar apo prokuror, mund të jetë përfshirë në sjellje të mundshme të pahijshme, ka iniciuar rastet sipas detyrës zyrtare. Në raste të caktuara, ZPD ka filluar edhe hetimet disiplinore ndaj bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale në bazë të informacioneve të siguruara nga platforma Juaj. ZPD, nuk mund të Ju sigurojë të dhëna statistikore lidhur me këtë çështje, pasi kur rastet i iniciojmë sipas detyrës zyrtare, në databzë nuk e kemi një prerje të tillë të të dhënave të siguruara nga e IKD-së dhe jo vetëm.” Shkurt 2019.

XII. Rekomandimet e IKD-së

IKD në bazë të gjetjeve gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit të trajtimit të luftës kundër korrupsionit, në vazhdimësi në këto tri vite, në kuadër të projektit tre vjeçar “Fuqizimi i sundimit të ligjit” të mbështetur nga Ambasada Britanike në Kosovë ka ofruar rekomandime konkrete se si të zbatohen obligimet ligjore dhe politikat në trajtimin e luftës kundër korrupsionit. Në vazhdim janë paraqitur rekomandimet kryesore të adresuara për institucionet e drejtësisë në këto tri vite (*janë larguar rekomandimet e njëjta të përsëritura, të cilat nuk janë zbatuar*). Në këtë tabelë janë paraqitur 117 rekomandime, prej të cilave 37 janë zbatuar, 49 janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 31 rekomandime nuk janë zbatuar fare. Për më tepër, shihni tabelën në vazhdim.

Nr.	REKOMANDIMET PËR VITIN 2019	Z	P	X
1	Qeveria e Kosovës të fillojë me zbatimin e programit qeveritar për inicimin e ndryshimeve kushtetuese lidhur me procesin e vetingut në sistemin gjyqësor, prokurorial dhe Policinë e Kosovës.			X
2	Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatat, të fillojë pa vonesë në themelimin e Departamentit të veçantë pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, për trajtimin e lëndëve që paraqiten nga PSRK.		P	
3	Caktimi i gjykatësve në këtë departament të bëhet në mënyrë transparente, duke respektuar dhe zbatuar kriteret e përcaktuara me ligj.		P	
4	KGJK të ushtrojë kompetencat kushtetuese dhe ligjore në mbrojtjen e pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe pavarësisë individuale të gjykatësve nga ndërhyrjet e jashtme, veçanërisht nga vendimet e pushtetit ekzekutiv lidhur me sistemin gjyqësor në Kosovë.			X
5	KGJK dhe KPK të fillojnë me hartimin e legjislacionit sekondar lidhur me zbatimin e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjykatës dhe Prokurorë. Procesi i hartimit të legjislacionit sekondar të bëhet në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim me shoqërinë civile në Kosovë. Legjislacioni sekondar të mos devijojë nga qëllimi dhe fryma e ligjit.		P	
6	KGJK në bashkëpunim me KPK dhe Akademinë e Drejtësisë të fillojnë me trajnimin e të gjithë Kryetarëve të Gjykatave dhe Kryeprokurorëve lidhur me zbatimin e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjykatës dhe Prokurorë.		P	
7	KGJK dhe KPK të ndërtojnë praktika dhe standarde unike lidhur me zbatimin e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjykatës dhe Prokurorë.		P	
8	KPK të ushtrojë kompetencat kushtetuese dhe ligjore në mbrojtjen e pavarësisë së sistemit prokurorial dhe pavarësisë individuale të prokurorëve nga ndërhyrjet e jashtme, veçanërisht nga vendimet e pushtetit ekzekutiv lidhur me sistemin prokurorial në Kosovë.			X
9	KPK të ushtrojë kompetencat kushtetuese dhe ligjore ndaj Kryeprokurorit të Shtetit, lidhur me ndërhyrjet e jashtëligjshme në cenimin e pavarësisë së prokurorëve në trajtimin e lëndëve penale, me theks të veçantë në trajtimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë.			X
10	KPK të shqyrtojë dhe anulojë të gjitha vendimet e kundërligjshme të Kryeprokurorit të Shtetit lidhur me ndërtimin e mekanizmave të kundërligjshëm të kontrollit dhe mbikqyrjes së rasteve të profilit të lartë në Kosovë.			X
REKOMANDIMET PËR VITIN 2018:				
11	Ministri i Drejtësisë duhet që bashkëpunimin me KGJK dhe KPK ta zhvillojë deri në atë fushë sa kompetencat e tij kërkojnë bashkëpunim me këta dy këshilla. Ministri i Drejtësisë, pavarësisht qëllimeve që mund të ketë, duhet ta kuptojë që KGJK dhe KPK janë institucione të pavarura dhe të ndjeshme sidomos në raport me pushtetin ekzekutiv, prandaj si të tilla duhet t’i trajtojë dhe respektojë në mënyrë që mos të krijohen situata kur paraqitet e përbashkëta në publik krijojnë opinion se politika po ndërhyr në pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.			X
12	KGJK dhe KPK, veçanërisht kryesuesit e tyre, duhet t’i shmangen takimeve pa shkas me Ministrin e			X

	Drejtësisë dhe secilin zyrtarë të lartë të pushteteve tjera, në mënyrë që ta ruajnë kredibilitetin dhe pavarësinë e tyre, si dhe të mos zbehin edhe më tutje besimin e publikut në këto dy institucione.			
13	KGJK dhe KPK të ndalin akuzat dhe kundërakuzat për dështimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në luftën kundër korrupsionit, por të kryejnë obligimet e tyre kushtetuese dhe ligjore në kuptim të kontrollit dhe mbikqyrjes së gjykatave dhe prokurorive përmes mekanizmave të brendshëm.			X
14	KGJK dhe KPK, të ndërmarin masa të evitimit të konfliktit të interesit në pajtim me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.			X
15	KGJK të tregojë efikasitet të shtuar në përmbushjen e obligimeve ligjore, sidomos miratimin e legjislationit sekondar. Po ashtu, IKD rekomandon që pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për KGJK-në dhe Ligjit të ri për Gjykatat, KGJK të miratojë plan të veprimit dhe të përcaktoj afate për miratimin e legjislationit sekondar.		P	
16	IKD i rekomandon KGJK-së që me një përkushtim maksimal të adresoj rekomandimet e dala nga raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit.			X
17	IKD i rekomandon KGJK-së që me rastin e nxjerrjes së akteve nënligjore, është e mjaftueshme që t'i referohet vetëm bazës ligjore dhe vetëm në ato raste kur me ligj i është bartur një autoritet i tillë dhe jo të referohet në dispozita Kushtetuese nëse për një gjë të tillë nuk ka bazë ligjore.	Z		
18	KGJK ta rishqyrtojë Rregulloren për Sistemin Qendror të Evidencës Penale të Kosovës në kuptimin e përputhjes së tij me KPRK dhe fushës për qasje në statistikat e Sistemit Qendror të Evidencës Penale të Republikës së Kosovës.	Z		
19	KGJK të publikojë Rregulloren për Shfrytëzimin e Teknologjisë Informative në Sistemin Gjyqësor.	Z		
20	KGJK të publikojë të gjitha vendimet e nxjerra nga KGJK. Po ashtu, KGJK duhet ta respektojë dy gjuhësinë, dhe të gjitha vendimet të publikohen edhe në Gjuhën Serbe.		P	
21	KGJK të rrisë transparencën në përgjithësi, përkatësisht të respektojë Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike, të ftojë mediat dhe shoqërinë civile në çdo takim publik.	Z		
22	KGJK, përkatësisht Komisioni për Vlerësimin e Performancës së KGJK-së, t'i kushtoj rëndësi të veçantë procesit të vlerësimit të performancës, në atë mënyrë që me anë të këtij procesi të arrihet qëllimi i tij, dhe jo që ky proces të kryhet vetëm formalisht.		P	
23	Pas miratimit të Ligjit të ri për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, KGJK të kujdeset që të gjitha masat disiplinore që kërkon me ligj të bëhen publike.		P	
24	IKD i rekomandon KGJK-së që të përmbush obligimin ligjor dhe të ftojë Kryetarët e Gjykatave për të raportuar para KGJK-së lidhur me administrimin dhe menaxhimin e gjykatave respektive.		P	
25	KGJK ta bëjë të qartë dallimin në mes transferimit dhe avancimit, dhe mos të avancojë gjyqtarë të ndryshëm në emër të transferimit.		P	
26	IKD i rekomandon KGJK-së që në afatin e përcaktuar ligjor të themelojë degët e reja që parashihen me Ligjin e ri për Gjykatat, dhe jo të ndjek praktikën e deritanishme ku tanimë është shfuqizuar Ligji për Gjykatat, por që asnjëherë nuk janë themeluar degët e reja të gjykatave në Fushë Kosovë dhe Obiliq.			X
27	IKD i rekomandon anëtarëve të KGJK-së që të luajnë rol aktiv në takime të Këshillit gjatë procesit të politik bërjes dhe vendim marrjes në Këshill.		P	
28	IKD i rekomandon KPK-së që të tregojë efikasitet të shtuar në përmbushjen e obligimeve ligjore, përfshirë edhe miratimin e legjislationit sekondar.	Z		
29	IKD i rekomandon KPK-së dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit që raportin vjetor të Prokurorit të Shtetit ta shqyrtojë dhe miratojë brenda afatit ligjor.	Z		
30	IKD i rekomandon KPK-së që me një përkushtim maksimal të adresoj rekomandimet e dala nga raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit.		P	
31	IKD i rekomandon KPK-së zbatimin në praktikë të Rregullores për Komunikim Publik dhe të mbajë përgjegjësi të gjithë zyrtarët që nuk e zbatojnë.		P	
32	KPK të publikojë të gjitha aktet nënligjore të KPK-së, duke respektuar edhe dygjuhësinë.			X
33	IKD i rekomandon KPK-së që me rastin e hartimit të raportit vjetor të KPK-së për vitin 2018, mos ta bëjë një raport ekskluzivisht përrshkruar, por ai të jetë një raport analitik i cili i adreson problemet dhe sfidat që ka pasur KPK gjatë vitit 2018.		P	
34	KPK, përkatësisht Komisioni për Vlerësimin e Performancës në KPK, që këtë proces ta kryej me një kujdes, profesionalizëm dhe përkushtim maksimal, në mënyrë që ky proces ta arrijë qëllimin e tij, dhe jo që ky proces		P	

	të përfundohet vetëm formalisht.			
35	IKD i rekomandon KPK-së të raportoj para publikut për zbatimin e objektivave të saj të përcaktuara në mënyrë specifike dhe të bazuar në indikator të matshëm çdo gjashtë (6) muaj.		P	
36	IKD i rekomandon KPK-së të thërras Kryeprokurorët e të gjitha prokurorive për të raportuar lidhur me menaxhimin dhe administrimin e prokurorive përkatëse.	Z		
37	IKD i rekomandon anëtarëve të KPK-së që gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre të kenë rol aktiv, përmes pjesëmarrjes në diskutim dhe debat gjatë procesit të politikëbërjës dhe vendimmarrjes në KPK.		P	
38	KPK ta bëjë të qartë dallimin në mes të avancimit dhe transferimit, dhe mos të bëjë avancime të kundërligjshme në emër të transferimit.			X
39	Ministria e Drejtësisë gjatë procesit të plotësim ndryshimit të Kodit të Procedurës Penale të adresoj të drejtën e mjetit juridik dhe qasjes në gjykatë në rastet e hudhjes së kallëzimeve penale dhe vendimet lidhur me pushimin e hetimeve nga ana e parashtruesve të kallëzimeve penale, viktimave të krimit dhe palëve të dëmtuara.		P	
40	Ministria e Drejtësisë gjatë procesit të plotësim ndryshimit të Kodit të Procedurës Penale të adresojë afatet ligjore lidhur me trajtimin e rasteve në procedurën parapenale, dhe trajtimin e këtyre rasteve brenda afateve ligjore nga Prokurori i Shtetit, duke ndërtuar praktikë të njëjtë si tek kallëzimet penale ashtu edhe tek raportet e veçanta.		P	
41	Ministria e Drejtësisë përmes plotësim ndryshimit të Kodit të Procedurës Penale të ngritë transparencën e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në ofrimin e qasjes në dokumente publike në rastet, të cilat mbyllen në fazat e hershme të procedurës penale qoftë përmes vendimit për hudhje të kallëzimit penal, qoftë përmes vendimit mbi pushimin e hetimit.			X
42	Ministria e Drejtësisë gjatë procesit të plotësim ndryshimit të Kodit të Procedurës Penale të ri-shikojë kthimin e Paditësit privat dhe Paditësit subsidiar.			X
43	Ministria e Drejtësisë gjatë trajtimit të temave të lartpërmendura të marr për bazë obligimet që dalin nga Kushtetuta e Kosovës dhe praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.		P	
44	Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Gjykata Supreme qoftë përmes Akademisë së Drejtësisë apo mekanizmave të tjerë në dispozicion të organizoj trajnime për gjykatës lidhur me politikën ndëshkimore, duke marrë për bazë si dokument orientues Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore të miratuar nga Gjykata Supreme me 15 shkurt 2018.	Z		
45	Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial të adresojnë urgjentisht praktikën e ndërtuar në gjykata dhe prokurori lidhur me shtyrjen e seancave gjyqësore në rastet e korrupsionit për shkak të mungesës së gjykatësve dhe prokurorëve.		P	
46	Kryetarët e gjykatave dhe Kryeprokurorët e Prokurorive Themelore dhe Prokurorisë Speciale të ngrisin nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit dhe të evitojnë situatat e shtyrjes së seancave gjyqësore për shkak të mungesës së gjykatësve dhe prokurorëve.		P	
47	Kryetarët e gjykatave të udhëzojnë gjykatësit që të ndërmarrin masa që i lejon Kodi i Procedurës Penale, ndaj palëve në procedurë penale, përfshirë prokurorët, dëshmitarët, avokatët, ekspertët të cilët pa arsye nuk marrin pjesë në seancat gjyqësore të korrupsionit.			
48	Këshilli Prokurorial i Kosovës, të ndërmerr masa dhe të obligojë Kryeprokurorin e Shtetit dhe Kryeprokurorët e Prokurorive Themelore, Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale dhe prokurorët e shtetit për të ofruar qasje në dokumente publike dhe bashkëpunuar me publikun dhe median në pajtim me obligimet ligjore.		P	
49	Këshilli Prokurorial i Kosovës të themeloj grup punues dhe të vlerësoj punën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Prokurorisë Themelore në Gjilan, për shkak të mungesës së rezultateve në luftën kundër korrupsionit.			X
REKOMANDIMET PËR VITIN 2017				
50	KGJK të shqyrtojë mundësinë që numri i gjykatësve në Departamentin për Krime të Rënda në Gjykatën Themelore në Prishtinë të rritet në pajtim me numrin e lëndëve të grumbulluara në këtë gjykatë, veçanërisht lidhur me lëndët e korrupsionit.	Z		

51	KPK rekomandohet të vazhdojë me plotësimin e pozitave të lira për prokurorë në PSRK.	Z		
52	Ministria e Drejtësisë rekomandohet të fillojë me plotësim ndryshimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë e kësaj prokurorie, përfshirë ri-shikimin e kriterëve dhe procedurave për procesin e rekrutimit dhe emërimit të prokurorëve në këtë Prokurori.	Z		
53	Ministria e Drejtësisë rekomandohet të fillojë me hartimin e Ligjit të veçantë për Zyrën e Prokurorit Disiplinor. Përmes këtij ligji duhet të ngritet llogaridhënia e ZPD, mënyra e menaxhimit dhe administrimit të kësaj zyre, si dhe fakti se Drejtori i kësaj zyre duhet të këtë karakter menaxherial dhe jo ekzekutiv. Të shqyrtohet mundësia që ZPD të hyjë nën ombrellën e Ministrisë së Drejtësisë, përderisa, duhet të garantohet pavarësia e KGJK-së dhe KPK-së në trajtimin e rasteve të paraqitura nga ZPD ndaj gjykatësve dhe prokurorëve.	Z		
54	KGJK rekomandohet të përshpejtojë dhe finalizojë procesin e rekrutimit dhe propozimit për emërim të 14 pozitave të shpallura për gjykatës dhe pozitave të lira për gjykatës.	Z		
55	KPK rekomandohet që të përshpejtojë dhe finalizojë procesin e rekrutimit dhe propozimit për emërim të pozitave të shpallura për prokurorë të rinj.	Z		
56	Hapja e debatit publik lidhur me fillimin e procesit të vetingut në Polici, Prokurori dhe Gjykata. Procesi i vetingut duhet të përfshijë verifikimin e detajuar të së kaluarës së policëve, prokurorëve dhe gjykatësve aktual në Kosovë. Verifikimi duhet të përfshijë debat gjithpërfshirës të të gjitha partive politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, me kërkesë që zbatimi i procesit të verifikimit në praktikë të udhëhiqet nga SHBA, Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania.	Z		
57	Hapja e debatit publik lidhur me themelimin e Prokurorisë dhe Gjykatës Speciale me kompetenca në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Prokuroria duhet të ketë të drejtën të merr nën kompetencën e saj në çdo fazë të procedurës, lëndët që kanë filluar apo që janë në punë nga Prokuroritë Themelore apo PSRK. Prokuroria do të ketë policinë gjyqësore, e cila do të veprojë ekskluzivisht nën urdhrat e Prokurorisë dhe nuk do të ketë asnjë obligim ligjor ndaj strukturës apo menaxhmentit të Policisë së Kosovës. Rekrutimi i policëve, prokurorëve dhe gjykatësve që do të jenë vendorë, me integritet personal dhe profesional të pakontestuar, të realizohet nga SHBA, Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania. Kuvendi të ndajë mjete financiare të mjaftueshme për funksionalizimin e këtyre mekanizmave, në mënyrë të pavarur.		P	
REKOMANDIMET PËR VITIN 2016				
58	Procesi i ri-shikimit të drejtësisë penale në Kosovë, të përfshijë vlerësimin dhe analizimin e së paku 200 rasteve të korrupsionit të përfunduara (<i>kallëzime penale të hudhura, aktvendime për pushimin e hetimeve, hudhjen e aktakuzave, aktgjykime liruese, aktgjykime refuzuese</i>), nga ana e ekspertëve të grupit punues të themeluar nga MD. Qëllimi i vlerësimit dhe analizimit të këtyre rasteve të përfunduara duhet të shërbejë për të identifikuar arsyet e dështimit të një numri enorm të rasteve të korrupsionit në polici, prokurori dhe gjykata, në mënyrë që të ofrohen zgjidhje adekuate që do të rekomandohen për ndryshimin e legjisllacionit apo praktikave të zbatimit të ligjit nga këto institucione.	Z		
59	Gjatë procesit të ri-shikimit të sektorit të drejtësisë penale, MD të ri-shqyrtojë kthimin e paditësit subsidiar dhe të instalojë kontrollin gjyqësor në të gjitha fazat e procedurës penale. Numri jashtëzakonisht i madh i rasteve të hetimeve parapenale të iniciuara pa bazë juridike apo të mbyllura në mënyrë jo transparente nga prokuroria dhe pa kontroll gjyqësor dëmton rëndë sigurinë juridike dhe shkel të drejtat dhe liritë e njeriut. (<i>Rekomandim i vitit 2017</i>).		P	
60	Ministria e Drejtësisë është në proces të plotësim ndryshimit të Kodit të Procedurës Penale. Grupi punues në kuadër të ndryshimeve që janë duke u diskutuar lidhur me këtë rekomandim, ka propozuar të drejtën e ankesës brenda sistemit prokurorial duke anashkaluar kontrollin gjyqësor sipas propozimit të IKD-së.		P	
61	KGJK të shqyrtojë mundësinë që numri i gjykatësve në Departamentin për Krime të Rënda në Gjykatën Themelore në Prishtinë të rritet në pajtim me numrin e lëndëve të grumbulluara në këtë gjykatë, veçanërisht lëndët e korrupsionit.	Z		
62	KPK rekomandohet të vazhdojë me plotësimin e pozitave të lira për prokurorë në PSRK.	Z		
63	Ministria e Drejtësisë rekomandohet të fillojë me plotësim ndryshimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë e kësaj prokurorie, përfshirë ri-shikimin e		P	

	kritereve dhe procedurave për procesin e rekrutimit dhe emërimit të prokurorëve në këtë Prokurori.			
64	KGJK të ri shikojë planin e veprimit lidhur me trajtimin e rasteve të korrupsionit nëpër gjykata. KGJK të bëjë një ri-vlerësim të numrit të rasteve të korrupsionit në gjykata, dhe të caktojë afate lidhur me trajtimin e tyre në pajtim me obligimet ligjore.		P	
65	KGJK të kërkojë nga Gjykata e Apelit të zbatoj në praktikë unifikimin e praktikave gjyqësore lidhur me politikën ndëshkimore në rastet e korrupsionit.		P	
66	KGJK të obligojë kryetarët e gjykatave që të inicojnë procedura disiplinore ndaj prokurorëve të cilët pa arsye mungojnë në seancat gjyqësore të korrupsionit.			X
67	KGJK të kërkojë nga Kryetarët e gjykatave dhe gjykatësit të ofrojnë qasje në dokumentet publike lidhur me rastet e korrupsionit në pajtim me ligjin në fuqi.		P	
68	KPK në pajtim me obligimet që dalin nga ligji i aplikueshëm të ndryshoj, plotësoj dhe të publikoj për ta bërë të qasshëm për publikun Planin Strategjik (2016-2018) dhe Planin e Veprimit për Ngritjen e Efektivitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, përfshirë Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme të miratuar nga KPK më 1 dhjetor 2015.			X
69	KPK të ofrojë qasje në statistikat lidhur me trajtimin e lëndëve të shënjestruara dhe informatat të cilat nuk pengojnë procesin e hetimeve në këto raste, përfshirë rezultatet në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme në lëndët e shënjestruara.		P	
70	KPK të trajtojë urgjentisht fenomenin e numrit të madh të vendimeve të hudhjes së kallëzimeve penale dhe vendimeve për pushimin e hetimeve në rastet e korrupsionit dhe dështimit të aktakuzave në gjykata për rastet e korrupsionit.			X
71	KPK të adresojë numrin e madh të seancave gjyqësore të korrupsionit të anuluar për shkak të mungesës së prokurorëve në seanca gjyqësore.			X
72	KPK të mbajë përgjegjës Kryeprokurorin e Shtetit për mungesën e transparencës dhe llogaridhënies në raport me mediat dhe shoqërinë civile lidhur me kërkesat për qasje në dokumente publike.			X
73	Kryeprokurori i Shtetit, Kryeprokurori i PSRK-së dhe Kryeprokurorët e PTh-ve të përmbushin obligimet ligjore lidhur me kërkesat për qasje në dokumente publike në sistemin prokurorial.		P	
74	Të shqyrtohet dhe zbatohet në praktikë, amandamenti i Kushtetutës lidhur me themelimin e një Prokurorie dhe Gjykate Speciale, duke marrë për bazë modalitetin e Maqedonisë. Një marrëveshje e tillë duhet të ketë konsensus dhe përkrahje të plotë të partive më të mëdha politike në Kosovë.		P	
75	Kompetencat dhe përgjegjësitë e kësaj Prokurorie dhe Gjykate Speciale nuk do të ndërhyjnë në asnjë rrethanë në kompetencat dhe përgjegjësitë e Gjykatës Speciale në Hagë të themeluar nga Kuvendi i Kosovës.		P	
76	Themelimi i Prokurorisë dhe Gjykatës Speciale duhet të kufizohet në një kohë të caktuar dhe për vepra penale të caktuara që janë me interes për Shtetin e Kosovës, dhe këto dy institucione duhet të kenë pavarësi të plotë nga institucionet aktuale, pra nga KGJK, KPK, PSh, si dhe supremaci ndaj PSRK.		P	
77	IKD i rekomandon KPK-së, që të ri vlerësojë vendimet, dhe të marrë vendime të bazuara në ligj dhe aktet e brendshme të Këshillit Prokurorial të Kosovës.		P	
78	KPK të trajtojë urgjentisht fenomenin e numrit të madh të vendimeve të hudhjes së kallëzimeve penale dhe vendimeve për pushimin e hetimeve në rastet e korrupsionit dhe dështimit të mbi 60% të aktakuzave në gjykata për rastet e korrupsionit.			X
79	PTh në Prishtinë, të trajtojë lëndët (informatat) e korrupsionit në regjistrin PPN me prioritet.	Z		
80	KPK urgjentisht përmes IGJK-së të organizojë trajnime për prokurorë lidhur me zbatimin e dispozitave ligjore për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale.		P	
REKOMANDIMET PËR VITIN 2016				
81	Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial gjatë procesit të hartimit të politikave lidhur me zbatimin e pakos së ligjeve për KGJK-në dhe KPK-në të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet në proceset që ndërliken me emërimin, ri-emërimin, transferimin, avancimin e gjykatësve dhe prokurorëve, si dhe proceset që ndërliken me emërimin e anëtarëve të KGJK-së, KPK-së dhe komisioneve përkatëse të të dy Këshillave. KGJK dhe KPK të aplikojnë praktika dhe standard unike dhe të harmonizuara lidhur me çështjet e lartpërmendura gjithnjë duke marrë për bazë specifikat dhe fushëveprimtarinë që zhvillojnë dy Këshillat.		P	

82	KGJK para miratimit të rregulloreve dhe akteve të brendshme të KGJK-së të planifikojë dhe vlerësoj rrezikun eventual para procesit të vendim marrjes, në mënyrë që praktika e deri tanishme e plotësimit dhe ndryshimit të rregullave dhe procedurave lidhur me procese të rëndësishme në sistemin gjyqësor.		P	
83	KGJK të përmbush obligimet ligjore që dalin nga ligjet bazike mbi sistemin gjyqësor, duke përfshirë miratimin e legjislacionit sekondar.	Z		
84	IKD i rekomandon KGJK-së që të shfrytëzoj mekanizmat aktual për të luajtur një rol proaktiv në monitorimin dhe mbikëqyrjen e komisioneve të Këshillit, Sekretariatit dhe Njësitit për Vlerësimin e Performancës.		P	
85	IKD i rekomandon KGJK-së që të përgatisë një plan të punës i cili duhet të ketë objektiva të qarta lidhur me vlerësimin e performancës së gjykatësve. KGJK duhet të përcaktoj një afat kohor prej tre apo katër viteve për vlerësimin e performancës të gjithë gjykatësve në Kosovë.		P	
86	IKD i rekomandon KPK-së për të ri shqyrtuar Rregullorën për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit	Z		
87	IKD i rekomandon KPK-së anulimin e Rregullorës për Bashkëpunim Institucional.			X
88	IKD i rekomandon KPK-së zbatimin në praktikë të Rregullorës për Komunikim Publik.		P	
89	IKD i rekomandon KPK-së në shqyrtimin e raportet e punës së Prokurorit të Shtetit për vitet 2015 dhe 2016.	Z		
90	IKD i rekomandon Sekretariatit dhe KPK-së të hartojnë, respektivisht KPK-së miratojnë raportet e punës së Këshillit për vitet 2015 dhe 2016.	Z		
91	IKD i rekomandon KPK-së të përmbush obligimet ligjore lidhur me vlerësimin e Performancës së prokurorëve.	Z		
92	IKD i rekomandon Drejtorit të Sekretariatit të përmbush obligimet ligjore ndaj KPK-së;		P	
93	IKD i rekomandon KPK-së fillimin e procesit të rekrutimit të Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve.	Z		
94	IKD i rekomandon KPK-së dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit në miratimin e planit të punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2016.	Z		
95	IKD i rekomandon KPK-së të raportoj para publikut për zbatimin e objektivave të saj të përcaktuara në mënyrë specifike dhe të bazuar në indikator të matshëm çdo gjashtë (6) muaj.	Z		
96	IKD i rekomandon KPK-së të thërras Kryeprokurorët e të gjitha prokurorive për të raportuar lidhur me menaxhimin dhe administrimin e prokurorive përkatëse.	Z		
97	IKD i rekomandon anëtarëve të KPK-së të ushtrorjnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre në pajtim me ligjin, duke u siguruar që të kthehet ligjshmëria dhe legjitimiteti në Këshill;			X
98	IKD i rekomandon KPK-së të vlerësoj dhe anuloj të gjitha vendimet e kundërligjshme të miratuara në Këshill.			X
99	IKD i rekomandon anëtarëve të KPK-së që gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre të kenë rol aktiv, përmes pjesëmarrjes në diskutim dhe debat gjatë procesit të politikbërjes dhe vendimmarrjes në KPK.		P	
100	KGJK ka zbatuar rekomandimin e IKD-së lidhur me shpalljen e pozitave për gjykatës në të gjitha nivelet e gjykatave. KGJK nga 14 pozita të shpallura për gjykatës, për GTh në Prishtinë ka shpallur vetëm tre pozita.	Z		
101	KGJK ka zbatuar pjesërisht rekomandimin e IKD-së lidhur me monitorimin e Gjykatave Themelore në zbatimin e obligimeve që dalin nga Plani i Veprimt.		P	
102	Gjykata Themelore në Prishtinë rekomandohet të vazhdojë trajtojë lëndët e korrupsionit me prioritet, duke përfshirë rastet e paraqitura nga PSRK si lëndë me prioritet absolut.	Z		
103	Gjykatat Themelore rekomandohet që gjatë trajtimit të rasteve të korrupsionit të zbatojnë në përpikëri afatet e përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale lidhur me caktimin e shqyrtimit të parë, shqyrtimit të dytë dhe shqyrtimit kryesor.		P	
104	KPK rekomandohet që të përshpejtoj dhe finalizoj procesin e rekrutimit dhe propozimit për emërim të pozitave të shpallura për prokurorë të rinj.	Z		
105	KPK rekomandohet urgjentisht të bëjë plotësimin e pozitave të lira për prokurorë në PSRK. Kjo Prokurori vepron me 50% të kapaciteteve të lejuara.	Z		
106	KPK duhet të rishikojë dhe anulojë urgjentisht Udhëzimin e kundërligjshëm të Kryeprokurorit të Shtetit me numër A.nr.258/2016, i datës 29 prill 2016, për trajtimin e kallëzimeve penale.			X
107	Ministria e Drejtësisë dhe Kuvendi i Kosovës kanë zbatuar rekomandimin e IKD-së, lidhur me zgjedhjen e shumicës së anëtarëve të KGJK-së nga gjyqësori, me qëllim të ngritjes së pavarësisë së sistemit gjyqësor nga	Z		

	ndërhyrjet e pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ. Ky rekomandim është zbatuar përmes amendamentit 25 të Kushtetutës, miratuar në muajin shkurt 2016.			
108	KGJK ka zbatuar rekomandimin e IKD-së, lidhur me hartimin e Planit të Veprimit për zgjidhjen e rasteve të korrupsionit në gjykata me prioritet.	Z		
109	KGJK ka zbatuar pjesërisht rekomandimin e IKD-së lidhur me monitorimin e Gjykatave Themelore në zbatimin e obligimeve që dalin nga Plani i Veprimit.		P	
110	Gjykatat Themelore pjesërisht kanë zbatuar rekomandimin e IKD-së lidhur me ngritjen e transparencës me publikun, mediet dhe shoqërinë civile që monitorojnë rastet e korrupsionit.		P	
111	Prokuroria Themelore në Prishtinë ka zbatuar rekomandimin e IKD-së për hartimin e Planit të Veprimit për Ngritjen e Efikasitetit të kësaj prokurorie në trajtimin e rasteve të korrupsionit. IKD në bashkëpunim me Kryeprokurorin e PTh në Prishtinë kanë hartuar Planin e Veprimit, i cili është miratuar në kolegjiunet e kësaj prokurorie në gusht 2015. Si rezultat i këtij Plani të Veprimit dhe zbatimit në praktikë, në tremujorin e fundit të vitit 2015, është rritur performanca e kësaj prokurorie në trajtimin e rasteve të korrupsionit ka prodhuar rezultate konkrete.	Z		
112	Gjykata e Apelit rekomandohet të krijojë politika adekuatë ndëshkimore dhe t'i unifikojë ato lidhur me veprat penale të korrupsionit.		P	
113	KPK rekomandohet të bëjë rishikimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit lidhur me Ngritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit, Krimeve Ekonomike si dhe Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Dobisë Pasurore të Fituar me Vepër Penale. Ri-shikimi i këtij plani duhet të evitohet dispozitat, të cilat janë në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm, standardet dhe praktikat ndërkombëtare.			X
114	KPK rekomandohet që gjatë ri-shikimit të këtij plani, rëndësi të veçantë t'i kushtojë obligimeve të PSRK-së lidhur me luftimin e korrupsionit të profilit të lartë.			X
115	KPK rekomandohet urgjentisht të bëjë plotësimin e pozitave të lira për prokurorë në PSRK. KPK rekomandohet në bashkëpunim me PSRK, partnerët ndërkombëtarë që mbështesin sistemin prokurorial që të hartojnë rregulla të brendshme për organizimin e kësaj prokurorie. Ndarja aktuale faktike e PSRK-së në Departamente të Specializuara duhet të rregullohet me akte të brendshme të KPK-së.	Z		
116	PSRK rekomandohet që prokurorët e caktuar në Departamentet e kësaj Prokurorie të kryejnë vetëm rastet që hyjnë në kuadër të kompetencave të Departamentit, dhe të mos zbatohet praktika e deritanishme që të njëjtit prokurorë në të njëjtën kohë të trajtojnë raste të korrupsionit, krimeve të luftës, krimin të organizuar, shpërlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit. PSRK duhet të ketë prokurorë të specializuar në fushën e luftimit të korrupsionit dhe prokurimit publik.			X
117	KPK rekomandohet të ketë trajtim të veçantë për PTh në Prishtinë lidhur me plotësimin e pozitave dhe nevojave shtesë për prokurorë dhe personel mbështetës.	Z		

Tabela 20 – Tabela e rekomandimeve të IKD-së për tri vite dhe zbatimi i tyre nga institucionet e drejtësisë.

ANEX I

NGRITJA E AKTAKUZAVE PËR KORRUPSION DHE PROFILI I TË AKUZUARVE SIPAS NJOFTIMEVE TË PSH-SË					
<u>Data</u>	<u>Pozita/Funksioni</u>	<u>Vlera e dëmit të shkaktuar</u>	<u>Kërkesa për sekuestrim/konfiskim</u>	<u>Numri i personave</u>	<u>Prokuroria</u>
13.01.2016	Ish Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>1</u>	PSRK
1.02.2016	Persona zyrtar në KEDS	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>2</u>	PTh Gjilan
5.02.2016	Inspektor Ndërtimor	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>4</u>	PTh Gjilan
8.02.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>2</u>	PTh Pejë
15.02.2016	Qytetar	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>5</u>	PTh Prizren
25.02.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>1</u>	PTh Prizren
1.03.2016	Kryetar i Komunës, Mitrovicë Drejtor i Prokurimit, Komuna Mitrovicë Drejtor i Operatorit Ekonomik	767,940.00 €	S'ka informacion	<u>3</u>	PSRK
3.03.2016	Ska informacion	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>23</u>	PSRK/EULEX
3.03.2016	Ska informacion	20,310.56€; 2,958€; 1,607.47€ 589.00€	S'ka informacion	<u>4</u>	PTh Prizren
21.03.2016	S'ka informacion	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>1</u>	Pth Prizren
14.04.2016	Zyrtar	150,00	S'ka informacion	<u>1</u>	PTh Pejë
18.05.2016	1 ish Deputetë 1 ish Ministër	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>20</u>	PSRK-EULEX
19.05.2016	Mjek	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>3</u>	PTh Gjilan
20.05.2016	Udhëheqës Divizioni, MPB	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>1</u>	PTh Prishtinë
27.05.2016 2	Kryetar Bordi-ART, ish-anëtar i Bordit të ART-së	S'ka informacion	S'ka informacion	<u>2</u>	PTh Prishtinë
31.05.2016	Kryetar, Gjykata e Apelit	S'ka informacion	S'ka informacion	4	PSRK
14.06.2016	Drejtor i Shërbimeve Publike, Emergjencës - Komuna Drenas Zyrtar certifikues në Kuvendin Komunal në Drenas Zyrtar në Kuvendin Komunal në Drenas	S'ka informacion	S'ka informacion	4	PTh Prishtinë

	Pronar i një firme				
15.06.2016.	Aktakuza përfshinë 60 persona fizik dhe 4 persona juridik. Ata janë: një ministër, një sekretar I përgjithshëm I një ministrie, 44 mjekë, një infermierë, 13 punonjës në sektorin privat shëndetësor	S'ka informacion		64	ZKPSH
21.06.2016	S'ka Informacion	35,000.00	S'ka informacion	4	PTh Prizren
01.07.2016	Zyrtar	3,306	S'ka informacion	1	PTh Prizren
01.07.2016	Qytetarë	2,051.644	S'ka informacion	3	PSRK
08.07.1016	Zyrtarë	S'ka informacion	S'ka informacion	2	PTh Prizren
28.07.2016	Shtetas malazes	S'ka informacion	S'ka informacion	1	PSRK
02.08.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	4	PTh Pejë
04.08.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	4	PSRK
09.08.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	1	PTh Prizren
14.08.2016	3 Zyrtar 1 qytetar	S'ka informacion	S'ka informacion	4	PTh Prizren
26.08.2016	1 zyrtar në 2 qytetarë	S'ka informacion	S'ka informacion	3	PSRK
30.08.2016	Kryetar i Komunës	168.000	S'ka informacion	1	PSRK
16.09.2016	Kryetar Komune dhe 38 personave tjerë	S'ka informacion	S'ka informacion	39	PSRK
26.09.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	2	PTh Gjilan
18.10.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	1	PTh Prizren
25.10.2016	1 ish Deputet i kuvendit të Kosovës dhe 38 të tjerë	S'ka informacion	S'ka informacion	39	PSRK
31.10.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	2	PTh Prizren
01.11.2016	Zyrtar	S'ka informacion	S'ka informacion	1	PTh Prizren
17.11.2016	11 zyrtarë të Shërbimit korrektues 1 mjek	S'ka informacion	S'ka informacion	24	PSRK
12.12.2016	1 Deputet 1 tjetër	25.646	S'ka informacion	2	PSRK
12 janar 2017	Zyrtar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë	S'ka informacion	S'ka informacion	2	PSRK

	Pronar në kompaninë MDA				
23 janar 2017	Kryeinspektor në Regjionin e Prishtinës pranë Inspektoriatit të Punës dhe Mirëqenies Sociale	S'ka informacion	S'ka informacion	1	PSRK
13 shkurt 2017	Ish-kryetar komune	S'ka informacion	S'ka informacion	10	PSRK
	8 zyrtarë komunalë				
	Ndërtues				
14 shkurt 2017	Ish- Kryetar komune	S'ka informacion	S'ka informacion	3	PSRK
	Ish-drejtor për buxhet dhe financa				
	Ish- menaxher për prokurim				
24 shkurt 2017	Zyrtarë policor të trafikut regional në Prizren	S'ka informacion	S'ka informacion	4	PTh Prizren
1 mars 2017	Zyrtar policor në Stacionin Policor në Suharekë	S'ka informacion	S'ka informacion	1	PTh Prizren
2 mars 2017	Zyrtarë policor në njësinë e kontrollit të autostradave	S'ka informacion	S'ka informacion	20	PTh Prizren
18 mars 2017	Ministër	S'ka informacion	S'ka informacion	3	PSRK
	Sekretar i Përgjithshëm				
	Drejtor i Departamentit të Administratës dhe Financave				
16 qershor 2017	Koordinator i vëzhguesve të njërit nga subjektet politike pjesëmarrëse në zgjedhje	S'ka informacion	S'ka informacion	1	PTh Pejë
31 korrik 2017	Autoriteti komandues në Stacionin Policor në Dragash	S'ka informacion	S'ka informacion	1	PTh Prizren
4 shtator 2017	Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Prizrenit	S'ka informacion	S'ka informacion	2	PTh Prizren
	Inspektor i ndërtimit në Komunën e Prizrenit				
11 tetor 2017	S'ka informacion	S'ka informacion	S'ka informacion	3	PTh Pejë
29 shtator	Drejtor i inspeksionit	S'ka	S'ka informacion	2	PTh Prizren

2017	në Komunën e Suharekës	informacion			
	Asambleist në Asambleshë Komunale në Prizren				
24 tetor 2017	Instruktor dhe pronar i autoshkollës	S'ka informacion	S'ka informacion	2	PTh Prizren
	S'ka informacion				
10 nëntor 2017	Person përgjegjës për komunitete në Komunën e Pejës	30.000 euro	S'ka informacion	1	PTh Pejë
21 nëntor 2017	Drejtor i Administratës Publike pranë Komunës së Prizreni	S'ka informacion	S'ka informacion	1	PTh Prizren
23 nëntor 2017	Drejtoresë e SHFMU "Musafa Bakiu"	S'ka informacion	S'ka informacion	1	PTh Prizren
28 shkurt 2018	Zyrtar policor	S'ka informacion	S'ka informacion	2	PTh Prizren
17 prill 2018	S'ka informacion	S'ka informacion	S'ka informacion	6	EULEX
5 maj 2018	Ish-drejtor i krimeve ekonomike në Policinë e Kosovës	S'ka informacion	S'ka informacion	2	PSRK
	Biznesmen	S'ka informacion	S'ka informacion		
20 qershor 2018	Zyrtar i Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Pejës	440.000 euro	S'ka informacion	2	PTh Pejë
	Pronar i një kompanie private		S'ka informacion		
17 gusht 2018	S'ka informacion	S'ka informacion	S'ka informacion	3	PSRK
14 shtator 2018	Anëtar i Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së UÇK-së	68.153.533.14 euro.	S'ka informacion	12	PSRK
6 nëntor 2018	Zyrtar ligjor i Agjencisë Kadastrale të Kosovës	Dëm në vlerën e sipërfaqes së lokaleve prej 978,96 m2, si dhe objektet, depot dhe tregjet në sipërfaqe prej 220 m2.	S'ka informacion	2	PTh Prizren
	Qytetar		S'ka informacion		
5 nëntor	Kryetari i Komunës	10.556.00 euro	S'ka informacion	3	PTh Prizren

2018	së Suharekës				
	Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit në Suharekë		S'ka informacion		
	Drejtor i SHFMU "Bajram Curri" në fshatin Nishor, Komuna e Suharekë		S'ka informacion		
1 nëntor 2018	Ish - drejtor i Drejtorisë Komunale të Inspektorateve në Prizren	36,143.00 euro	S'ka informacion	1	PTh Prizren
6 dhjetor 2018	Pylltar i terrenit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	S'ka informacion	S'ka informacion	1	PTh Pejë
11 dhjetor 2018	Kryetari i Komunës së Novobërdës	12.200,00 euro	S'ka informacion	1	PTh Gjilan
		Mbi 71,000,000		376	

Tabela 21 – Profili i të akuzuarve për korrupsion dhe vlera e sekuestrimeve dhe konfiskimeve për vitet 2016, 2017 dhe 2018.

ANEX 2

Gjykata Themelore	Numri i lëndës	Vlera
Ferizaj	PKR.nr.1503/12	Karta identifikuese të qytetarëve, certifikata të lëshuara nga Kryqi i Kuq;
Ferizaj	PKR.nr.96/16	Kartëmonedha në vlerë 100 euro;
Ferizaj	PKR.nr.12/15:	Pasaportë kosovare, pasaportë jugosllave, fletore xhepi, numra të telefonit, kontrata dhe autorizime mes kompanisë “El–Abrar”, etj.;
Ferizaj	PKR.nr.150/17	Telefoni;
Ferizaj	PKR.nr.42/17	Të hollat në vlerë 12,570 euro, 100 dollarë, 100 franga zvicerane, dy pistoleta, dy karikator dhe katër fishekë, dhe një granat dore;
Ferizaj	PKR.nr.22/17	Një bankënotë në vlerë 50 euro, dy bankënota në vlerë 20 euro dhe një bankënotë në vlerë 10 euro;
Ferizaj	PKR.nr.194/17	Dy bidonë me nga 25 litër naftë;
Ferizaj	PKR.nr.193/17	Mall tekstil;
Gjilan	PKR.nr.252/17	Armë zjarri;
Gjilan	PKR.nr.27/15	Konfiskimi i provave materiale - kartëmonedhat e konfiskuara (200 euro), urdhëresa për ç’kyçje nga rrjeti elektrik lëshuar nga KEDS në Viti, si dhe foto dokumentacioni i kartëmonedhave;
Gjilan	PKR.nr.496/13	Ka pasur dënim plotësues për konfiskim të sendeve: Vërtetim mbi sekuestrimin e mallrave-akcizor të dt.17.04.2013 ndaj M.M, vërtetim mbi sekuestrimin e mallrave akcizor të dt.16.04.2013 ndaj S.M, vërtetim për sekuestrimin e mallrave akcizor të dt.17.04.2013 ndaj I.S;
Gjilan	PKR.nr.114/15	Sekuestrimi i e sendeve- telefoni “Samsung” PSC 5. Konfiskimi i kartës së identitetit e Policisë së Kosovës në emër të të akuzuarit A.A.;
Gjilan	PKR.nr.47/14	Kartëmonedha në vlerë 50 euro;
Gjilan	PKR.nr.185/16	Kartëmonedha në vlerë 20 euro;
Gjilan	PKR.nr.215/2017	Të hollat në vlerë 500 euro;
Gjilan	PKR.nr.10/17	Të hollat në vlerë 500 euro;
Gjilan	PKR.nr.157/16	Kërkesë për sekuestrim të dy veturave;

Gjilan	PKR.nr.111/16	Kartëmonedha 1x20 €,2x10 € dhe 1x5 €;
Gjilan	PKR.nr.34/17	Kartëmonedha në vlerë 50 euro;
Gjilan	PKR.nr.46/2017	20 Frang;
Gjilan	PKR.nr.52/2017	15 krerë gjedhe të sekuestruar nga i pandehuri Zenun Zejnullahu, në mungesë të gjedheve për shkak të tjetërsimit të tyre të bëjë kompensimin në vlerën 5.400 euro, 9 krerë në vlerë 1.638 euro, 26 krerë në vlerë 6.240 euro, 14 krerë në vlerë 3.055 euro, revole, pushkë të gjuetisë, numrat e martikulave të gjetura dhe pasaportat e gjedheve të gjetura të disa nga të pandehurit;
Prishtinë	PKR.nr.160/17	Konfiskimin e aseteve dhe dokumenteve të falsifikuara;
Prishtinë	PKR.nr.341/15	Automjete dhe banesë;
Prishtinë	PKR.nr.24/17	Sekuestrim të përkohshëm të sendeve;
Prishtinë	PKR.nr.411/16	Konfiskimi i një revole e tipi "Beretta" së bashku me një karikator dhe 14 fishekë;
Prishtinë	PKR.nr.755/15	Para;
Prishtinë	PKR.nr.41/18	Kompjuteri, fletore;
Prishtinë	PKR.nr.600/15	Shtëpi banimi, ngastër kadastrale, veturë;
Prishtinë	PKR.nr.338/16	Konfiskimi 31 bankënotave nga 500,00 euro; konfiskimi i gjësendeve nga shtëpitë e të pandehurve;
Prishtinë	PKR.nr.610/16	Parcela tokësore;
Prishtinë	PKR.nr.392/17	2.200 euro, telefon, sim kartel, 2.000 euro, telefon Nokia E52, telefon "Samsung" E10;
Prishtinë	PKR.nr.352/16	Sekuestrim të përkohshëm të sendeve; Konfiskim i automjetit (kamionit);
Prishtinë	PKR.nr.376/16	Tre vetura;
Prishtinë	PKR.nr.194/15	Armë;
Prishtinë	PKR.nr.27/17	Sekuestrim të përkohshëm të sendeve;
Prishtinë	PKR.nr.688/15	Konfiskimi i bidonëve me derivate të naftës;
Prishtinë	PKR.nr.722/14	Sekuestrim të përkohshëm të sendeve;

Prishtinë	PKR.nr.94/17	Kartëmonedha në vlerë prej 50 euro;
Prishtinë	PKR.nr. 612/14	Makina private e të akuzuarit e tipit "Mercedes";
Prishtinë	PKR.nr. 344/15	Marrja e përkohshme e gjësendeve;
Prishtinë	PKR.nr. 341/15	<p>Kundër të pandehurit I.H PSRK ka propozuar:-KONFISKIMI i automjetit të markës Audi Q7, me targa 01-900FG, prodhuar në vitin 2008 në vlerë prej 37.000,00€, veturën e markës Vë Golf me targa 01-326-FP, prodhuar në vitin 2009 në vlerë prej 12.500€ dhe një veturë tjetër e markës Vë Golf me targa 01-421-FL, e prodhuar në viti 2009, në vlerë prej 16.800,00€ dhe parat në shumë prej 11.000,00€,si dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprave penale;</p> <p>- Kundër të pandehurit Skender Canolli KONFISKIMI i automjetit e markës VËPassat, me targa 01-714-FL, prodhuar në vitin 2008, në vlerë prej 20.000,00€, parat në shumë prej 10.560,00 Franga zvicerane, 2.600,00\$ amerikan dhe 1.880,00€, si dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprave penale; - Kundër të pandehurit Mërgim Shala KONFISKIMI i banesës në lagjen “Kalbria” Lamela 2, kati II, banesa nr. 07 me sipërfaqe prej 76.3m2, në shumë prej 38.150,00€; si dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprave penale; si dhe ARMËT: nga i pandehuri Ismet Haliti-Pistoleta e markës CZ.99 e kalibrit 9mm me nr.121623 më një karikatorë pa fishek dhe nga i pandehuri Skender Canolli-Pistoletë e markës Broving e kalibrit 9mm, me një karikator me tetë fishekë dhe një Pushkë Karabinë me nr. serik 85269,prodhim Crvena Zastava- Kragujevc, e kalibrit 8x57mm, si dhe njëzet e dy fishek të kësaj pushke.</p> <p>Sendet e sekuestruara:</p> <p>Sendet e sekuestruara nga i pandehuri I.H: a. 11.000.00€ (njëmbëdhjetë mijë euro), 22 kartëmonedha 500€; Vetura Vë “Golf”, i prodhuar në vitin 2009, me ngjyrë të zeze metalike, me tabela të regjistrimit 01-326-FP, ID nr. ËVËZZZ1KZP453134, i regjistruar në emër të I.H; Vetura VË “Golf”, e prodhuar në vitin 2009, ngjyrë hiri, metalike, me tabela të regjistrimit 01-421-FL, ID nr. ËVËZZZ1KZ9Ë578466, e regjistruar në emër të F.H (i biri i të pandehurit I.H); Vetura Audi Q7, me ngjyrë të zeze, me tabela të regjistrimit 01-900-FG, numri i identifikimit ËAUZZZ4L69D025641, i prodhuar në vitin 2008, i regjistruar në emër A.P, ku hetimi ka zbuluar se pronar faktik i këtij automjeti është i pandehuri I.H.</p> <p>Sendet e sekuestruara nga i pandehuri S.C – 10,560CHF (dhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë franga zvicerane) – 1,880€ (një mijë e tetëdhjetë euro), – 2,600\$ USD (dy mijë e gjashtëqind dollar amerikan); Vetura Vë “Passat”, me ngjyrë të zeze metalike, me numër të regjistrimit 01-714-FL, e prodhuar në vitin 2008, ID nr. ëVëZZZ3CZ9E520573, e regjistruar në emër të L.C (i biri i të pandehurit S.C)</p> <p>Prona e sekuestruar nga i pandehuri M.Sh. banesa nr. 8 me sipërfaqe prej 76.3m2, në lamelën 2, hyrja 1, kati 2 në lagjen Kalabria;</p>

Prishtinë	PKR.nr.642/15	Konfiskimi i: banesës në Klinë në sipërfaqe prej 36 m2, shtëpisë dy katëshe në sipërfaqe prej 209 m2, tokës bujqësore në sipërfaqe prej 1182 m2 + toka me dy parcela, lokali afarist në sipërfaqe prej 39.86 m2, banesa në sipërfaqe prej 97.30 m2, parcelë toke në Ulqin në sipërfaqe prej 308 m2, parcelë tjetër në sipërfaqen prej 171 m2 në Ulqin, veturës së markës AUDI A6, mjetet financiare në emër të shitjes së dy lokaleve afariste të blera nga Kolë Puka sipas kontratave të deponuara në shkresat e lëndës në vlerë prej 63 mijë euro;
Prishtinë	PKR.nr. 161/14	Letra në të cilën shihet pagesa e të hollave;
Prishtinë	PKR.nr. 652/15	Sekuestrim i 5000 eurove nga të akuzuarit;
Prishtinë	PKR.nr. 190/14	Faturë 4.200 euro; Faturë 3000 euro; Faturë 3000 euro; 09.04.2013 - Vërtetim mbi marrjen e përkohshme të gjësendeve: Vendim i MAPD – OJQ; Autorizimi 02.04.2010; 06.01.2010 - Vërtetim mbi marrjen e përkohshme të gjësendeve: Licenca e OJQ-së; Certifikatë e NRF; Statuti; Paragona; 02.05.2013 - Vërtetim mbi marrjen e përkohshme të gjësendeve: Libri i arkës 2010; Libri i arkës 2010; 28.12.11 – Vërtetim mbi konfiskimin e gjësendeve: Një bllok (Dëftesë pagese); Një fasikëll prej 14 fletëve;
Prishtinë	PKR.nr.305/16	Kompjuterë;
Prishtinë	PKR.nr.214/13	Konfiskimi i parave në vlerë prej 100 euro;
Prishtinë	PKR.nr.243/13	Konfiskimi i kartëmonedhës në shumën prej 10 euro;
Prishtinë	PKR.nr.222/15	Konfiskimi i kartëmonedhës në shumën prej 50 euro;
Prishtinë	PKR.nr.201/14	Konfiskimin e sendeve të cekura në aktakuzën e Prokurorisë Themelore të Prishtinës;
Prishtinë	PKR.nr.303/16	Marrja e përkohshme e: Kontratës VR.nr.5687/1997 e dt.28.01.1990, kontratës së shitblerjes së paluajtshmërisë e dt.20.03.2012;
Prishtinë	PKR.nr.932/13	Shtëpiza kompjuterike;
Prishtinë	PKR.nr.178/16	Konfiskimi i kartëmonedhës në shumën prej 50 euro;
Prizren	P.nr.149/14	Pleh artificial në sasi prej 28 ton dhe 125 thasë të peshës prej 50 kg;
Prizren	P.nr.192/16	Dy kartëmonedha në vlerë nga 50 euro;
Prizren	P.nr.12/18	Kartëmonedha në vlerë 10 euro;
Prizren	P.nr.23/18	Kartëmonedha në vlerë 20 euro dhe kartëmonedha në vlerë 20 euro;
Gjakovë	PKR.nr. 10/14	Propozim për të konfiskuar 7.800 dhe 134.753.71 euro për njërin të akuzuar H.B., ndërsa për të akuzuarin tjetër Z.K., 1.835.36 euro;
Gjakovë	PKR.nr. 193/15	Shuma në vlerë prej 6,620 euro;

Gjakovë	P.nr.60/16	Konfiskimi i diplomës dhe konfiskimi i certifikatës së diplomës;
Gjakovë	PKR.nr.100/17	7.800 dhe 134.753.71 euro dhe 1,835.36 euro.
Gjakovë	PKR.nr.73/17	Kartëmonedha në vlerë 20 euro;
Mitrovicë	P.nr.60/16	Konfiskimi i parave që kapin vlerën 250 euro;
Mitrovicë	P.nr.17/2016	Plumb;
Mitrovicë	P.nr.23/17	Kartëmonedha në vlerë 100 euro;
Mitrovicë	P.nr.937/2013	Sasia narkotike e llojit marihuanë ne sasi 1.200 kg;
Mitrovicë	P.nr 328/13	Kërkesë për konfiskim: Plumb 17.428 kg./ 9465 pllaka x 37,479 kg;
Pejë	PKR.nr.64/17	Kartëmonedha në vlerë 10 euro;
Pejë	PKR.nr.106/17	Llaptopi dhe telefoni;

Tabela 22 – Lista e pasurive të sekuestruara/konfiskuara në rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD.